



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 19 NËNTOR 2009**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
19 NOVEMBRA 2009. GODINE**

**NËNTOR – NOVEMBAR
2009**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Hap punimet e seancës së sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në bazë të rregullave 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Gjithashtu, ju njoftoj se deri në fillim të seancës plenare nuk kemi marrë asnjë propozim për amendamentimin e rendit të ditës ose propozim për shqyrtim të ndonjë çështjeje urgjente në pajtim me rregullat procedurale.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, e ndjej për obligim që ta falënderojmë kompaninë Mabeteks dhe Behgjet Pacollin për renovimin e shtesës, si donacion.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 29 tetor dhe 2 nëntor 2009

Pyes, nëse keni vërejtje në procesverbal. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Besoj se në procesverbal është një lëshim teknik, sepse mungon pjesa e pyetjeve parlamentare. Konkretisht, pyetja ime parlamentare drejtuar ministrit të Ekonomisë dhe Financave, gjë që mund të vërtetohet edhe në transkriptin e seancës plenare të 29 tetorit, në faqen 7 dhe 8. Prandaj, kërkoj që të plotësohet procesverbali. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka tjetër? Nuk ka.

Konstatoj se Kuvendi me vërejtjen e deputetes Syla miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 29 tetor dhe 2 nëntor 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Vazhdojmë me procedimin e pyetjeve. Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministren Justina Shiroka Pula, apo zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Deputete, e keni fjalën!

MYRVETE PANTINA: Ministria nuk është prezentë. Herën e kaluar unë e kam lexuar këtë pyetje, zëvendëskryeministri nuk ishte në gjendje të përgjigjej, prandaj nuk do ta parashtroj pyetjen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi, ose zëvendëskryeministrin, Hajredin Kuçi ose Ramë Manaj. Deputet, e ke fjalën!

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër Thaçi,

Shteti fqinj verior hegjemon, shtetit tonë edhe popullit tonë i ka shkaktuar dëme morale materiale përafërsisht 25 miliardë euro. Po ai shtet, shtetin tonë po thuhet se për asgjësend, për një çështje suptile procedurore e ka paditur shtetin tonë. Pse shteti ynë nuk e ka bërë kërkesën për rimbursimin e dëmit moral dhe material të popullit të dëmtuar, të shtetit tonë të dëmtuar të pafajshëm? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër Hajredin Kuçi, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kryeministër, të nderuar deputetë,

Faleminderit, zoti Smaka, për pyetjen!

Ju e dini që një çështje e tillë është diskutuar edhe në kohën e bisedimeve të Vjenës, por gjithmonë për dëmet e luftës kur është fjala, sikurse edhe për të ndodhura tjera gjatë luftës, nuk parashkruhen dhe vjen momenti kur do të bëhet një gjë e tillë. Sot ka raste kur në Kosovë individ të caktuar bëjnë veprime të tilla, por si shtet ekzistojnë dy kushte. Kushti i parë, duhet të jemi anëtarë i OKB-së ose i dyti, në ... të statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Besoj që kjo do të vijë edhe me kohë do ta bëjmë edhe një padi të tillë, por kjo në asnjë moment nuk nënkupton që do të parashkruhen ato.

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Është parim juridik civil ndërkombëtarisht valid i aplikueshëm që entiteti legal apo natyral, ama do të thotë që aty hynë edhe ndonjë organizatë, si të them kështu, apo ndërmarrje e dëmtuar, ka kurdoherë të drejtë të padiskutuar për ta paditur dëmtuesin fajtor. Kjo është një. Dy, ju lutem, ndërkohë disa organizata jashtë qeveritare të Skenderajt, që unë i përgëzoj, e kanë ngritur këtë çështje, por ato nuk kanë kapacitet kadrovik, as financiar, as profesional. Po, ndoshta, do të ishte mirë të meditohej që t'u ndihmohet, sepse kjo do të ishte tepër një aktivitet i dobishëm, sidomos në këtë etapë kur ne jemi të paditur si shtet për një çështje suptile apo, si të them kështu, formale procedurore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Konsideroj që përgjigja është dhënë. Deputetja Kaqusha Jashati, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, e ke fjalën!

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit!

Të nderuar të gjithë prezentë,

Në seancën e kaluar ministri i Financave, zoti Ahmet Shala ka dhënë përgjigje në dy pyetje të njëjta parlamentare lidhur me Projektligjin për sigurimin pensional dhe

invalidor. Pasi pyetja ime është njësoj, e kam marrë këtë përgjigje, por edhe pyetja edhe përgjigja kanë qenë në kohën e fushatës. Prandaj, po ju pyes a keni për njëmend të na procedoni Projektligjin deri në fund të vitit, sikur që ka deklaruar zoti Ahmet Shala, në emër të Qeverisë. Këtë e pyes, sepse në planin e Qeverisë të jurisprudencës për 2009, nuk është përfshirë ky ligj. Po ju përkujtoj që Qeveria nuk ka dhënë përgjigje në mocion të cilën e kemi dërguar më 8 janar, sivjet, lidhur me këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përgjigjet zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit, zonja Jashari!

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të kompetencave të veta ka përcaktuar me akte ligjore dhe nënligjore prioritet të veçantë krijimin dhe aplikimin e skemave pensionale në Kosovë. Skemat pensionale të krijuara në periudhën e menjëhershme të pasluftës, të cilat për momentin janë të aplikueshme, janë të përkohshme dhe kanë pasur parasysh si qëllim themelor uljen e varfërisë së thellë në vendin tonë. Duke pasur parasysh karakterin e përkohshëm të këtyre skemave dhe mos krijimin e sistemit të sigurimit pensional dhe invalidorë të Kosovës, këto skema jemi munduar në vazhdimësi dhe kemi insistuar që të krijojmë një sistem të qëndrueshëm funksional të sigurimit pensional dhe invalidor në Kosovë. Qëllimi kryesor i nxjerrjes së këtij projektligji ka qenë dhe mbetet krijimi i infrastrukturës së mirëfilltë ligjore nga fusha e sigurimit pensional dhe invalidor me qëllim të krijimit të fondit pensional në bazë të solidaritetit të Republikës së Kosovës.

Fillimisht, kjo Ministri ka filluar punën me analizën e funksionimit të sistemit pensional dhe invalidor në vendet e rajonit. Pastaj kemi angazhuar disa përgjegjës nga ministrinë e ndryshme duke bërë një draft fillestar të Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor, i cili është dërguar dhe shqyrtuar edhe në mbledhjen e Qeverisë më herët. Natyrisht që ne kemi bërë edhe kemi marrë parasysh edhe rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, të Bankës Botërore, të cilat në vazhdimësi kanë rekomanduar që ky projektligj të mos miratohet ashtu për shkak të kostos së lartë të zbatimit.

Përkundër këtij fakti, me propozimin e Ministrisë së Punës, në vitin 2008 Projektligji për sigurimin pensional dhe invalidor përsëri është përfshirë në strategjinë legislative. Pas përfundimit të të gjitha procedurave, projektligji i përmendur është proceduar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe në Agjencinë Evropiane për Zhvillim për të siguruar, në radhë të parë, deklaratën financiare dhe pastaj pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së.

Javën që shkoi kemi pasur një takim me Shoqatën e Pensionistëve të Kosovës, kemi pajtuar për ndryshime që duhet të bëhen në kuadër të këtij ligji dhe ky ligj në vitin 2009 do të shqyrtohet në kuadër të Qeverisë së Kosovës dhe në vitin 2010 do të procedohet në Kuvend dhe do të finalizohet.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

Fjala deputetes Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Nuk është pyetje, po për herë të parë po ndijë atë çka kam insistua moti për Fondin në bazë të solidaritetit dhe jam e kënaqur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e radhës, deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, Kryetar!

Ligji i punës është me rëndësi të veçantë për sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Mungesa e tij ka shkaktuar një vakum juridik që ka për pasojë shkeljen sistematike të të drejtave të punëtorëve në vendin e punës nga punëdhënësit. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe nevojën e madhe që të mbrohen liritë e të drejtat themelore të njeriut në Kosovë, në këtë fushë që garantohen edhe me deklaratën universale për të drejtat e njeriut, si dhe duke marrë parasysh mungesën e mbrojtjes së interesave të punëtorëve që rezultojnë nga puna e tyre, shkelja e të cilëve është rrjedhojë e mungesës së Ligjit të punës, për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale e bëjë këtë pyetje: - Ku qëndron arsyeja e vonesës së procedimit të këtij ligji për miratim në Kuvendin e Kosovës?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI NENAD RASHIĆ: Hvala, gospodine predsendiće!

Poštovani premijeru,

Poštovani zamenici prejimera,

Kolege minsitri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Gospodjo poslanice,

Znam da je jedan mukotrpan period bio i za nas što se tiče Zakona o radu. Ja sam juče i na sednici Socio-ekonomskog saveta koji smo imali u zgradi Ministarstva, rekao i zvanično pokazao taj dokumenat koji imamo sada kompletiran, dokumenat koji je u svim saglasnostima sa svim relevantnim faktorima, znači i sa Svetskom bankom, i sa Evropskom komisijom, sa svim ostalim međunarodnim faktorima na Kosovu, tako da tehnički je zakon pripremljen. Ja mislim da će Zakon stvarno da bude vrlo brzo usvojen i da će ići na odobravanje svih vas zbog toga što jeste bazični zakon. Naravno da trebamo da budemo svesni da i naše društvo nije toliko ekonomski jako da bi jedan zakon o radu mogao da bude toliko snažan i da toliko snažno favorizuje radnike, ali naravno u daljem radu ćemo moći da ga popravimo, da ga modifikujemo i da ga usavaršimo onako kako mi budemo smatrali da imamo mogućnosti za to.

Sa zakonom se kasnilo iz tehničkih razloga. Ja moram da kažem da sam i onaj postojeći zakon pripremili još na početku ove godine sa nekim blagim modifikacijama, ali to jednostavno nije bio u skladu sa nekim međunarodnim normama, sa evropskim standardima, pa smo bili prinudjeni da zajedno sa Svetskom bankom odradimo još jedan tehnički deo i Svetska banka je poslala svog stručnjaka koji je bio kod nas nekih tri nedelje da na one njegove predloge koje smo pre toga dobili, napravimo jednu kompletnu modifikaciju projekta, modifikaciju zakona, tako da smo jedno tri meseca izgubili možda zbog toga što je Svetska banka kasnila sa tim ekspertom zbog toga što je gospodin Jakobs, kako se zove, bio zauzet drugim poslovima. Uglavnom nije naša, da kažem uslovno rečeno, nije naša toliko krivica što se tim zakonom kasnilo, nego je malo i krivica međunarodnog faktora, u ovom slučaju Svetske banke, koja ima jednu vrlo važnu ulogu u donošenju ovog zakona, ali je najbitnije da sada konačno imamo zakon pripremljen. Ja sam ga juče imao na stolu, znači biće dostupan i vama vrlo brzo. Tehnička satvar je samo kada bude prošao u Vladi, tako da čete i vi imati mogućnosti... Mislim da će svi biti...

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?

NERXHIVANE DAUTI: Unë e përshëndes punën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për punën e bërë rreth përgatitjes së ligjit dhe dëshiroj që ky ligj të na procedohet sa më shpejtë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Diriton Tali, pyetje për Kryeministrin ose zëvendëskryeministrin apo ministrin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Faleminderit!
Zoti Kryeministër, për shkak se këtë pyetje pak e kam modifikuar që nga 7 tetori, nuk kam pasur shans t'ua bëjë, por është e njëjta. Çështja është kjo, zoti Kryeministër, Qeveria e juaj tash të hënë, më 9 nëntor, vendosi që kapacitetet e "Kosovës C" të zvogëlohen nga 2000 në maksimum 1000 megavat ose tri herë nga 330 apo dy herë nga 500 megavat. A na tregoni se cilat janë arsyet të cilat bënë që Qeveria të ndërrojë këtë mendim? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, i nderuari deputet për pyetjen tuaj të zgjuar! Besoj që i keni përcjellë edhe zhvillimet globale edhe qasjen e re globale për rrethanat e reja ambientaliste dhe në kuadër të këtyre edhe shteti i Kosovës i përgjigjet këtyre rrethanave, kushteve të cilat janë të nevojshme, të domosdoshme për shtetin dhe qytetarët tanë në konsultim të ngushtë me të gjitha autoritetet ndërkombëtare në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Paraprakisht më lejoni që t'ju përgëzoj për këtë vendim të marrë. Shumë mirë që më në fund jeni kthyer kah kibla, me shpresë se nuk i bini pishman edhe një herë, se PDK-ja sa ishte në opozitë ka qenë goxha e zëshme kundër këtij projekti, e kur erdhi në Qeveri, u bë avokati më i madh i projektit 2000 megavatësh.

Po ashtu, zoti Kryeministër, kriza globale nuk është e para dy muajve, është që dy vite e gjysmë dhe të gjitha ato arsyet që i dhe ti, unë i kam dhënë këtu, por nuk i ke përfillur, madje edhe më ke akuzuar për ultra majtistë që me të vërtetë ka qenë një akuzë e rëndë, krejt familjen ma ke traumatizuar, unë edhe sot nuk po ndihem mirë. Kërkoj falje, të më kërkosh falje në seancën e 24 korrikut! Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, e doni fjalën? Regjia, fjalën Kryeministrit.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: A po ma përsërit edhe një herë këtë komentin e fundit, se...

DRITON TALI: Po citoj, e kam këtu transkriptin, zoti Kryeministër. Është seanca e 24 korrikut, mbase ke qenë i irrituar, pikërisht çështjet ambientaliste i pata ngritur. Ti the

se këto qëndrime janë mentalitet i së kaluarës apo ultra majtiste, e tjera, e tjera. Unë ultra majtist, komunist kurrë në jetën time nuk kama qenë, e lëre më ultra majtist.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari deputet! Unë besoj që ke filluar të kuptosh çështjen globale energjetike dhe ambientaliste. Më vjen tepër mirë që ke filluar ta kuptosh se ne kemi qenë nga kibla që nga fillimi kur ka filluar ai projekt dhe tani e keni kuptuar. Në anën tjetër, unë përsëri falënderoj që ke filluar të kthehesh nga e djathta, sepse unë përsëri nuk pajtohem me askënd, megjithëse kjo nuk është çështje ideologjike, që është kundër procesit të privatizimit. Ai proces do të vazhdojë, do të thotë, e para, me fillimin e ndërtimit të termocentralit të ri, me procesin e privatizimit edhe të PTK-së, edhe të gjitha atyre projekteve të cilat i kemi prezantuar këtu në Parlamentin e Kosovës, e për shumë çështje tjera do të vendos edhe vet Kuvendi, do ta jap fjalën e vet të fundit. Kështu që ju faleminderit dhe përgëzime për mirëkuptimin që po tregoni, më në fund. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Urdhëroni, deputete!

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje, kolegë të nderuar!

Sa i përket çështjes së të pagjeturve, i nderuari zoti Kryeministër Hashim Thaçi, po shihet se kjo Qeveri është totalisht e dështuar. Nisemi nga fakti, që edhe çështja e Ligjit të familjarëve të të pagjeturve po prolongohet edhe më tutje edhe pse në planin strategjik të Kuvendit ka qenë e paraparë që të miratohet në muajin tetor, kjo edhe më tutje po prolongohet. Atëherë, i nderuari zoti Kryeministër, sa ka mundësi Qeveria e Republikës, gjegjësisht Komisioni Qeveritar për Personat e Pagjetur, të blejë aparaturat për identifikimin e mbetjeve mortore.

Njashtu, kam edhe një propozim, i nderuari zoti Kryeministër, kërkoj të dërgohen në specializim 10 persona, të cilët do të aftësoheshin për të punuar me ato aparaturat dhe, në fund, edhe një herë kërkoj nga ju, i nderuari zoti Kryeministër edhe Qeveri e respektuar, ta zbardhni një herë e përgjithmonë fatin e 1887 të pagjeturve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E para, e nderuara dhe e respektuara deputete, ju ftoj që me fatin e të pagjeturve të mos luhet, të mos keqpërdoret kjo çështje, të mos politizohet kjo çështje. Për aq sa është shqetësim i juaj, është edhe shqetësim dhe përgjegjësi edhe e imja. Ju i dini raportet e shtetit të Kosovës me shtetin e Serbisë. Nuk është mirë të provokohen emocionet e familjeve të të zhdukurve. Ne i kemi kryer dhe punojmë çdo ditë për këtë çështje dhe është i ngarkuar zëvendëskryeministri Manaj, që gjithashtu ka rastin e vet familjar të të zhdukurve, kështu që kjo është një prej prioritetëve kryesorë të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe gjithçka shkon në një bashkëpunim shumë të ngushtë me autoritetet ndërkombëtare, që mund të jenë ndikuese te autoritetet e Beogradit. Ne ndikimin tonë sa i përket kësaj çështjeje, e dimë secili nga ne, duke u nisur nga presidenti, kryeministri, kryetari i Parlamentit, deputetët, ministrat. Prandaj, të gjitha që kemi pasur mundësi të bëjmë, i kemi bërë të gjitha qeveritë, jo vetëm Qeveria që e udhëheq unë. Kjo nuk është çështje politike, por është çështje edhe

humanitare, edhe përgjegjësi shtetërore dhe gjithçka që do të bëjmë, do ta bëjmë bashkërisht me komunitetin ndërkombëtar ndikues në Beograd.

Prandaj, është duke u punuar maksimalisht në këtë çështje. Sa i përket formulimit tuaj tjetër, mendoj se përsëri është mirë që të fokusohemi në pikat të cilat janë në agjendë dhe assesi të mos pretendojmë përsëri të lëshohemi në rrafshin e kampanjës elektorale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër! Deputete, ke pyetje shtesë? Ia jap fjalën deputetes Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryeministër, fushatë elektorale keni bërë ju dhe po shihet se jeni lodhur shumë, nuk po mundeni as të ngriheni në këmbë, kështu po më vjen shumë keq për këtë çështje shumë të rëndësishme që është, ka qenë shumë aktuale para fushatës dhe kjo pyetje është bërë shumë më herët, ju lutem, por ju asnjëherë nuk keni qenë këtu prezent t'i përgjigjeni. Kështu që, kjo dhimbje, mos bëni lojë, ju jeni kah bëni lojë, jo ne, i nderuar. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Fjala, Kryeministrit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Pasi që kërkoje të ngritem në këmbë, u ngrita dhe si fitues, bile, i zgjedhjeve. E para, zgjedhjet kanë qenë shumë fer, të lira, demokratike të standardit më të lartë evropian. Zgjedhjet kanë qenë referendum dhe besim i qytetarëve të Republikës së Kosovës për Qeverinë e Kosovës, institucionet e Kosovës.

Në anën tjetër, unë vetëm kam respektuar të drejtën time kushtetuese dhe ligjore. Votën dhe besimin e sovranit askush nuk mund ta kontestojë. Falënderoj komunitetin ndërkombëtar për mbështetje dhe vlerësimin se në Kosovë po lulëzon demokracia dhe është instaluar standardi më i lartë ndërkombëtar i organizimit të zgjedhjeve të lira, fer, demokratike. Falënderoj për pjesëmarrje të gjitha partitë dhe të gjitha komunitetet dhe mendoj se është arritur objektiva e shteti të Kosovës dhe objektiva e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Tash kemi objektivin kryesor integrimin e Kosovës në Bashkim Evropian dhe në NATO. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Shkojmë tutje. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kryeministër, kanë kaluar 21 muaj nga shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe ende në shtetin e Kosovës veprojnë strukturat paralele në fushën e sigurisë, të gjyqësisë, të arsimit, të shëndetësisë, të energjetikës dhe të tjera, të cilat funksionojnë jashtë autoritetit të shtetit të Kosovës.

Qeveria e Kosovës nuk ka arritur ta shtrijë autoritetin e vet në gjithë vendin. Grupet kriminale terrorizojnë qytetarët e Kosovës. Qeveria nuk po e trajton këtë problem serioz si prioritet. Prandaj, ju pyes: - Pse nuk keni ndërmarrë veprimet për shuarjen e strukturave paralele, përkundër premtimeve? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete Sylja!

Unë besoj, besoj që edhe ju jeni tepër e kënaqur me procesin të cilin e kemi kaluar të dielën dhe këto ditë, procesin elektoral të shumë përfshirjes dhe të participimit të të gjithë spektrit politik dhe etnik të qytetarëve. Ne kemi dëshmuar se po ndërtojmë vend demokratik dhe shumë etnik. Kemi dëshmuar se po e respektojmë në përpikëri dokumentin e presidentit Ahtisari. Serbët, qytetarët e Kosovës kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe tash po formohen komunat e reja. I falënderoj dhe i përgëzoj për këtë guxim qytetar dhe shtetëror. Ishte një sukses i shtetit të Kosovës dhe i të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe unë pres me padurim që të punoj me të gjithë këta kryetarë legjitim të komunave të reja, të autoriteteve të reja, kështu që gjithashtu në pajtueshmëri me gjithë faktorin politik shtetëror të Kosovës dhe komunitetin ndërkombëtar do të kemi zgjedhje në dy komuna edhe në pranverë, ku gjithashtu do të kemi adresa legjitime të autoriteteve lokale. Në Kosovë nuk ka struktura paralele, ka individë që thirren si jo legjitim dhe kjo nuk do të vazhdojë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputete, keni pyetje shtesë?

GJYLNAZE SYLA: Kryeministër, do t'isha e kënaqur që ju si Kryeministër i vendit të merreshit me punët e shtetit, në vend që të shkonit në fushatë, të merreshit me shpërbërjen e strukturave paralele, në vend që të ishit në fushatë. Sa i përket asaj se nuk ekzistojnë strukturat paralele, unë ju citoj Raportin e progresit të Komisionit Evropian mbi Kosovën, i cili konstaton se Serbia po administron institucione paralele në vendin e ri dhe se Qeveria nuk e kontrollon territorin e saj. Cilat veprime do t'i merrni si Qeveri në përgjigje të këtij raporti? Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete, edhe ju e dini se nuk është ashtu siç po parashtroni pyetjen, edhe subjekti i juaj. Ndoshta dikush do të dëshironte që unë mos të merresha fare edhe me politikë, por për aq sa do të më besoj populli i Kosovës dhe Zoti të më japë ymër, këtui jam.

Unë kam zhvilluar fushatë dhe kam vizituar serbët në të gjitha lokalitetet edhe vetëm, personalisht, si kryeministër i Kosovës, edhe bashkërisht me kolegë, edhe nga ICO, edhe me ambasadorë të shteteve mike. Vizitat e mia, qofshin në Klllokot, qofshin në Ranillugë, qofshin në Novobërdë, qofshin në Shtërpçë, qofshin në Lipjan kanë qenë vizita për t'i inkurajuar qytetarët e të gjitha etnive të dalin në zgjedhje dhe ndihem shumë krenar që i kam vizituar dhe kanë mbajtur premtimin për të dalë në zgjedhje. Ndihem shumë krenar që jam kryeministri i një Qeverie që ka arritur bashkërisht me të gjithë të organizohen zgjedhje shumë të lira, fer, demokratike me pjesëmarrje edhe më të theksuar se në vitin 2007, por edhe me pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhje. Ky është sukses i të gjithëve dhe duhet të ndihemi mirë dhe krenar të gjithë që kemi përfshirjen e gjitha komuniteteve, etnive në procesin demokratik dhe tash kemi autoritetet komunale legjitime, dhe unë do të, jo vetëm fushatë që kam inkurajuar, por do të punoj tash edhe më tepër për të ndryshuar jetën për të mirë për gjithë qytetarë kudo qoftë, në Graçanicë, qoftë në Shtërpçë, qoftë në Ranillugë, qoftë në Klllokot apo kudo. Unë do të ushtroj autoritetin në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Para se të vazhdojmë, ju sugjeroj që bëni pyetje, që të keni durim dhe t'i dëgjoni përgjigjet. Pyetja e radhës është, deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

NAIM RRUSTEMI: I nderuar ministër!

Postë- Telekomunikacioni i Kosovës – PTK, si ndërmarrje publike qendrore në vazhdimësi bën derdhjen e parasë publike në sponsorizime dhe donacione. Pyetja është- Sa ka shpenzuar PTK në sponsorim dhe donacione deri tash gjatë vitit 2009 dhe cilat janë kriteret për shpërndarje të parasë publike?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar, zoti Kryetar i Parlamentit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet, Rustemi,

Në bazë të informacioneve të cilat i kam marrë nga Bordi dhe menaxhmenti i Postë-Telekomunikacioni i Kosovës, unë i kam të dhënat në detaje për donacionet të cilat i ka dhënë ndërmarrja, ndërsa më lejoni që t'i shpjegoj bazat në bazë të cilave dhe kriteret të cilat i kam dhënë.

Postë-Telekomunikacioni i Kosovës, si ndërmarrje publike komerciale, funksionon mbi bazën e Ligjit për ndërmarrjet publike, ku në veprimtarinë e vet aplikon parimet e qeverisjes korporative dhe besoj praktikat më të mira të menaxhimit të qeverisjes korporative.

Shpërndarja e donacioneve nga menaxhmenti i PTK-së bëhet duke u bazuar edhe në praktikat e mëhershme të Postë-Telekomunikacionit të Kosovës për vite me radhë në Rregulloren e brendshme dhe kriteret që ndihmojnë dhe avancojnë vlerat e shoqërisë kosovare.

Në bazë të Rregullores së brendshme, janë të përcaktuar edhe kufijtë dhe përgjegjësitë e kompetencave për lejimin e sponsorizimeve dhe donacioneve të menaxhmentit dhe bordit të drejtorëve, andaj, deri në vlerën 10.000 euro kryeshefi ekzekutiv në bazë të Rregullores së brendshme të PTK-së, të miratuara nga Bordi i ndërmarrjes ka të drejtë të miratojë shuma të caktuara në bazë të vlerësimeve dhe kriterëve që do t'i lexoj më poshtë. Kështu, nga fillimi i vitit 2009 e deri më sot PTK ka sponsorizuar dhe dhënë donacione në vlerë prej 1,7 milionë euro. Kriteriumet janë sa vijon:

Për vitin 2009 PTK ka ndarë një mori donacionesh në bazë të këtyre kriterëve:

- Kriterit humanitar dhe social, ndërtimin e 45 shtëpive për të pastrehët në gjendje të rëndë ekonomike për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës;
- Ndihmë për Shoqatën e Pensionistëve të Kosovës; ndihmë për Shoqatën e të Verbërve të Kosovës;
- Ndihmë për Lidhjen e Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës në Kosovë;
- Ndihmë për themelimin e kuzhinës popullore, e cila menaxhohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për luftimin e varfërisë;

- Ndihmë projektit humanitar të transmetuar në Radiotelevizionin e Kosovës “Një zë për ty”, ndërtimi i shtëpive të pastrehëve;
- Ndihmë disa kërkesave për raste të rënda me qëllim të kurimit me sëmundje të rënda dhe në kushte ekstreme të rënda ekonomike të familjeve të varfra të Kosovës;
- Ndihmë motrave të Shën Kryqit të Kishës në Prishtinë.

Në bazë të kriterit shkencor:

- Përkrahjen e 58 studentëve të Universitetit të Prishtinës me bursa për vitin akademik 2009-2010;
- Sponzorizimin e disa botimeve dhe publikimeve ku nga menaxhmenti i PTK-së dhe Bordi janë aprovuar si të dobishme për shoqërinë kosovare;

Kriteri artistik:

- Serinë Spitali KS të transmetuar në KTV;
- Projektin “Shpija” të transmetuar në TV 21;
- Projektin “Nine Eleven”, festivali i filmit për hir të 11 shtatorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës;

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, edhe 1 minutë ia vazhdoni ministrit.

MINISTRI AHMET SHALA:

Kriterin sportiv, përkatësisht rekreativ:

- Pjesëmarrjen e sportistëve të Kosovës në garat ndërkombëtare, si është ” balford”, Kampionati i Parë Botëror, olimpiada e të tjera, dhe duhet theksuar se PTK, si çdo ndërmarrje tjetër profitabile- komerciale përmes shpërndarjes së donacioneve dhe sponzorizimeve përfiton marketing duke ngritur kështu imazhin e kompanisë dhe duke avancuar vlerat e PTK-së për mbështetjen e të gjitha kategorive shoqërore.

Të gjitha detajet i keni të shkruara dhe në qoftë se dëshironi unë mund t’ua dorëzoj.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

NAIM RRUSTEMI: Ia përkujtoj ministrit se ka mundësi që nuk i ka të dhënat e sakta dhe se mos raportimi adekuat i figurave financiare mund të jetë krim financiar. Dhe, me kërkesën e Qeverisë së Kosovës, me kërkesën e Presidentit, EULEX-i ka ardhur në Kosovë që ta luftojë edhe krimin financiar, kështu që u bëj ftesë publike Prokurorisë së Kosovës dhe EULEX-it të bëjnë auditimin në linjën donacione dhe sponzorizim, sepse të dhënat tregojnë se vetëm në këto dy linja shpenzimet tejkalojnë 2.5 milionë. Me fjalë të tjera, të dhënat tuaja si ministër, mund të mos jenë të sakta. Nëse raportimi financiar tregon shenja manipulimi, atëherë kjo nuk është as në harmoni me qeverisjen e korporatave, sepse përgjegjësia e organizatave publike është që t’i raportojnë ndershëm dhe saktë raportet financiare dhe t’ia bëjnë publik edhe opinionit publik, kurse sa për kriteret do të ishte mirë të bëhen publike që edhe të tjerët të bëjnë kërkesë për ndonjë donacion të mundshëm çfarë mund ta ketë. Por, të dhënat që i prezantoi ministri nuk janë të dhëna të sakta që dalin nga Postë-Telekomunikacioni i Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Ia përkujtoj regjisë se pyetja shtesë është 1 minutë. Ministër, a keni përgjigje?

MINISTRI AHMET SHALA: Unë vetëm desha të shtoj që të gjitha të dhënat i marr të verifikuara nga Bordi i PTK-së dhe janë organet e tjera të cilat merren me raportimet dhe auditimet, kështu që unë kam reflektuar raportimet të cilat i ka bërë menaxhmenti i PTK-së dhe Bordi i PTK-së ndaj përgjigjes në pyetjen tuaj. Unë dua të besoj se këto janë të dhëna të sakta që janë verifikuar në PTK, në qoftë se janë të kundërta është auditori gjeneral i cili i vërteton dhe unë nuk kisha dashur të bëj spekulime të tilla. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja e radhës- deputeti Driton Tali pyetje për ministrin Ahmet Shala. Mundësisht, mos i ngatërroni pyetjet.

DRITON TALI: Unë kam këtu numrin rendor 1804, më parë e pata 1803, sa për sqarim, sidoqoftë dhe pyetja tjetër që është dashur të jetë më në fundit ka qenë 1805 për Kryeministrin, zëvendëskryeministrin ose ministrin. Unë jam shumë mirë me letra këtu. Si do qoftë, zoti ministër- Pse deri më tani ende nuk ka filluar së zbatuari plani për vendosjen e arkave fiskale bizneseve kosovare? T'ua rikujtoj se këtë premtim PDK-ja e ka pasur që nga koha e qeverisjes së mirë sa ekzistonte ajo e mos të flasim për fushatën elektorale që e patëm në vitin 2007. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar deputet Tali, Qeveria e Republikës së Kosovës, më 18 shkurt të vitit 2009 ka marrë vendim që të gjitha bizneset ose në faza të caktuara, shumica e bizneseve t'i kenë arkat fiskale, të cilat kanë qenë projekt në programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Në muajin qershor është nënshkruar udhëzimi administrativ, që përcakton mënyrat se si të bëhet aplikimi dhe pajisja me arka fiskale. Në muajin korrik është formuar Komisioni për pajisje, përkatësisht për të detajizuar çdo element të praktikave më të mira regjionale dhe botërore në lidhje me arkat fiskale, në muajin shtator është finalizuar udhëzimi me karakteristikat funksionale dhe teknike, pra një udhëzim tjetër. Në muajin tetor është publikuar shpallja publike për shprehje të interesit për operatorët ekonomik, për pjesëmarrje në këtë tender publik dhe aktualisht jemi në proces të vlerësimit të ofertave. Unë besoj që brenda kësaj jave, besoj që, sot është e enjte, mbase edhe nesër, mund të shpallen fituesit e parë dhe ashtu siç kemi planifikuar do të fillojë procesi i fillimit të zbatimit të arkave fiskale. Ne kemi pasur diku mbi 15 kompani të cilat kanë konkurruar. Vitin e kaluar si pilot-program kanë qenë diku mbi 15 kompani të cilat kanë sprovuar mënyrën e testimit të arkave fiskale, prej të cilave kanë qenë të zgjedhura kryesisht kompani tregtare, kompani prodhuese, kompani shërbyese dhe në bazë të reagimeve, Komisioni ka vlerësuar edhe proceset teknike. Unë jam shumë i bindur se ky do të jetë një proces shumë i dobishëm për shoqërinë kosovare... dhe ne jemi për çdo iniciativë nga ana e qytetarëve të Kosovës dhe nga ana e biznesit kosovar që t'i marrim të gjitha sugjerimet profesionale. Faleminderit!

KRYETARI: A keni pyetje shtesë, deputet?

DRITON TALI: Unë nuk kuptova se kur do të fillojë apo kur do të mbarojë ky... kur do ta zbatoni këtë premtim të kamotshëm? Sidoqoftë për shkak se shumë deklarata

kundërthënëse janë dhënë nga institucionet gjegjëse, unë po e citoj sa për ta ilustruar edhe një deklaratë të 23 tetorit. Ju përmendët disa afate të planeve, ku u deklarua se deri më tani, pra deri më 23 tetor ende nuk ka filluar së zbatuari plani për vendosjen e arkave fiskale as për një biznes të vetëm. Kjo është deklaratë juaja, e Qeverisë, po mendoj dhe ende ky premtim sikurse edhe shumë premtime tjera ka gjasa do të mbesin sa për marketing kështu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, a ke përgjigje shtesë?

MINISTRI AHMET SHALA: Unë po ju kuptoj zoti Tali që shpeshherë ju përpiqeni që të neglizhoni, të demantoni apo të gjeni një apo arsye tjetër për të neglizhuar çfarëdo suksesi që është arritur, unë të siguroj, po them të siguroj se çdo gjë është sipas planit dhe ne, brenda kësaj jave, do të fillojmë shpalljen e kompanive të cilat kanë marrë pjesë në proces. Procesi i zbatimit të arkave fiskale në gjithë territorin e Kosovës do të jetë një proces i gjatë. Ka shtete që kanë filluar para viteve 90-ta. Turqia ka filluar në vitin 1986 dhe ende nuk e ka zbatuar, Maqedonia ka filluar në vitin 2000 dhe ende se ka përmbyllur, Shqipëria ka filluar, ka dështuar pastaj ka filluar prapë. Domethënë do të jetë një proces jo i lehtë, prandaj ne, me shumë kujdes iu kemi qasur kësaj çështjeje që atë që e fillojmë do ta realizojmë në mënyrën më të mirë të mundshme. Dhe, e kemi skemën e plotë e cila do të jetë e gatshme për kompaninë e cila do të përzgjidhet tani. Pra, ne vazhdimisht do të licencojmë kompani, varësisht se a i plotësojnë standardet e kërkuara apo jo? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ministër!

Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputete, e keni fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, Kryetar!

Ligji për pengimin e pastrimit të parave krijon bazë juridike për pengimin dhe zbulimin e të gjitha formave të pastrimit të parave dhe të aktiviteteve të ngjashme në Kosovë. Është e ditur se mungesa e këtij ligji lë hapësirë për pastrimin e parave, që kërcënon zhvillimin ekonomik, sundimin e së drejtës, sigurinë, stabilitetin dhe kontributon në krijimin e një klime të përshtatshme për krim të organizuar, korrupsion dhe terrorizëm. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji për pengimin e shfaqjes së dukurive të theksuara për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, e bëj këtë pyetje: Kur do të procedohet ky ligj për miratim në Kuvendin e Kosovës?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: E nderuara deputete Dauti, falënderoj për ngritjen e kësaj çështjeje e cila vërtet është një temë që ka qenë në Kuvend në vitin 2006 këtu, mbase nuk e di deputetët që kanë qenë në atë kohë, e kanë pasur këtë ligj, këtë projektligj në agjendë i cili është kthyer me të 7.2.2006 mbrapa në Qeveri, e kemi sjell prapë, më duket në maj të vitit 2008 dhe ne jemi në përfundim të këtij ligji. Ka pasur debate të shumta, ka pasur opinione të ndryshme, ka pasur mendime të ngërthyera nëse mund të them se çfarë duhet të përmbajë ky ligj. Më vjen keq që ka zgjat kaq shumë, faktorët të cilët janë përpjekur që të mbajnë, mund të them, struktura të UNMIK-ut ende në fuqi në Kosovë ose sisteme të tilla, kanë bërë që ky ligj të vonohet. Fatmirësisht, opinioni i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave kanë mbizotëruar në mënyrën e organizimit të Njesisë për Inteligjencën Financiare. Ne, javën e kaluar e kemi përmbyllur me sukses së bashku me ekspertët e EULEX-it, të Thesarit amerikan dhe të ekspertëve të tjerë kosovarë dhe jemi

pajtuar për strukturën, për mënyrën e funksionimit të kësaj njësie dhe të këtij ligji. Fatkeqësisht, vonesën e kanë shkaktuar mungesa edhe mungesa e dy ligjeve, Ligji mbi procedurën penale dhe për Kodin Penal, sa di unë, të cilat në mënyrë provizore do të futen disa segmente deri sa të vijjnë këto dy ligje në Parlament dhe të fuqizohen. Në momentin kur fuqizohen ato dy ligje, segmentet e tilla do të dalin nga ai ligj së funksionuari dhe ne në javën e ardhshme do ta procedojmë në Qeveri. Mund të them se ka dalë një ligj shumë i mirë, i cili do të bëjë të mundur që institucionet e shtetit të Kosovës të jenë më të fuqishme në luftën kundër shpëlarjes së parasë dhe makinacioneve të tjera antiterroriste. Kështu që, them ka qenë një punë e mundimshme, por fatmirësisht opinioni dhe vizioni i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave kanë mbisunduar në fund. Ligji do të jetë i gatshëm për ta shqyrtuar këtu dhe do të jemi të gatshëm për çfarëdo sugjerimi tjetër në mënyrë që ky ligj të jetë sa më i përshtatshëm për nevojat e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, a keni pyetje shtesë?

NERXHIVANE DAUTI:... E Ekonomisë, për përkushtimin e bërë, veçmas për ministrin, cili është mjaft i aktivizuar në këto çështje, që ligjet thelbësore për ekonominë e tregut në Kosovë të jenë të prezantuara në mënyrën më të mirë të mundshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit zoti Kryetar!
Unë dëshiroj të shtroj me këtë pyetje një çështje shumë të rëndësishme për jetën, siç është uji. Meqenëse qytetarët e Kosovës ballafaqohen me vështirësi të shumta lidhur me ujin, atëherë shfrytëzimi racional, ruajtja dhe mbrojtja e resurseve të ujit është shumë e rëndësishme. Kjo gjithashtu kërkon administrimin e qëndrueshëm të ujit nga organet kompetente, ashtu siç është definuar në Ligjin për ujërat, do të thotë, nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Prandaj, meqenëse me ligj është paraparë që politikat zhvillimore i bën Ministria, por edhe strategjinë ose planin strategjik të ujërave, pyes ministrin Mahir Yagcilar, pse deri më sot Ministria nuk e ka hartuar planin strategjik të ujërave dhe kur do të hartohet ky plan? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuari Kryetar,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministër,
Të nderuar deputetë, ministra,
E nderuara deputete Gjylnaze Syla,
Së pari dëshiroj t'ju falënderoj për pyetjen, por gjithashtu dëshiroj t'ju informoj se edhe ne si Ministri jemi shumë të interesuar për hartimin sa më parë të planit strategjik të ujërave, pasi që është në interes të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Duke ditur se resurset ujore si të tilla kanë disa specifika më të veçanta, në kuptimin administrativ, financiar e po ashtu edhe në atë planifikuar, por gjithashtu këto çështje nuk kuptohen drejt nga ata gjithë herë. E nderuara deputete mundet edhe... se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me përgjegjësitë që ka për administrimin dhe

menaxhimin e resurseve ujore në vend ka punuar dhe është duke punuar intensivisht për hartimin e të gjitha ligjeve, akteve nënligjore dhe dokumenteve tjera planifikuese, që rregullojnë çështjen e ujërave. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor viteve paraprake rëndësi më të madhe i ka kushtuar kompletimit të infrastrukturës ligjore e cila është mekanizëm i implementimit të politikave zhvillimore në fushën e resurseve ujore. Gjithashtu në periudhën e hartimit të planit strategjik dhe zhvillimor të Kosovës në vitin 2007-2013 është hartuar strategjia sektoriale për ujëra, në të cilën janë planifikuar të gjitha objektivat dhe aktivitetet deri në vitin 2013. Pas rekomandimeve nga ekspertët vendorë dhe të huaj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujëra, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor gjatë këtij viti ka propozuar ndryshime dhe plotësime në ligj, kështu që edhe në kapitullin IV të Ligjit, ku përfshihen dokumentet planifikuese, ka pësuar ndryshime dhe tani sipas Ligjit me plotësime dhe ndryshime parashihen vetëm dy dokumente planifikuese – strategjia për ujërat dhe planin për menaxhimin e pellgjeve lumore. Gjithashtu, dëshiroj t'ju informoj se për projektet IPA ose në projektet IPA ndër prioritetet e para për vitin 2010 është edhe plani strategjik për ujëra. Gjatë këtij viti kemi pasur shumë biseda dhe diskutime me donatorë, si Bankën Botërore, USAID-in, KPB-ën dhe kemi përkrahjen e tyre që në fillim të vitit 2010 do të fillojmë hartimin e strategjisë së ujërave, ngase aspektet financiare në shumicën e rasteve ka qenë pengesa deri tani e mosrealizimit të këtyre dokumenteve madhore për vendin, problemet buxhetore ose financiare. Kështu, besojmë se në vitin 2010 do të përfundojë strategjia e ujërave dhe në vazhdimësi edhe master-plani i ujërave. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtarin e Kryesisë, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonjusha, deputete Sylja, a ke pyetje plotësuese?

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër, autoritet me rëndësi për administrimin e ujërave, sipas Ligjit për ujërat, neni 17, është edhe Këshilli i Kosovës për Ujëra. A është i funksionalizuar ky këshill dhe a keni ju bashkëpunim me këshillin? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, edhe një herë, faleminderit! Deri tani prej implementimit të Ligjit, ndoshta nuk ka qenë një bashkëpunim i mirë me Këshillin për Ujërat, por para dy muaj ose tre muaj, prapë përmes Komisionit Parlamentar për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor këto çështje i kemi ngritur dhe ka filluar të bashkëpunohet edhe me Këshillin për Ujëra. Por, besojmë me ligjin e ri edhe këto çështje do të qartësohen dhe do të bëhet koordinimi, por gjithashtu edhe saktësimi i kompetencave dhe buxheti i Këshillit për Ujëra.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Ne e harxhuam kohën prej 50 minutash për pyetje, bile e shtymë edhe pak. Pyetjet e mbetura do të marrin përgjigje në seancat e ardhshme.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për borxhet publike

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotëri Ahmet Shala që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë Projektligjin.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar, zoti kryesues,

Të nderuar kolegë, ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Kam nderin dhe kënaqësinë që sot para jush të ofroj një nga ligjet shumë të rëndësishme për Republikën e Kosovës, përkatësisht Projektligjin për borxhin publik ose huan publike, i cili ofron një kornizë gjithëpërfshirëse dhe i mundëson Kosovës të marrë hua dhe të tërheqë fonde në arenën ndërkombëtare dhe vendore.

Deri më sot, fatkeqësisht, shteti i Kosovës nuk ka mund t'i mbulojë deficitet e veta buxhetore apo nevojat e veta zhvillimore përmes huamarrjes për hir të mungesës së këtij ligji. Fatmirësisht, këtë vakum e kanë mbuluar kryesisht donacionet apo politikat fiskale, të vetmet instrumente të cilat i kemi në dorë. Ndërsa, pothuaj se të gjitha vendet e botës marrin hua publike për t'i rregulluar borxhet apo skemat e veta investuese e që është pjesë e natyrshme dhe e domosdoshme e procesit të krijimit të një ekonomie të qëndrueshme.

Huamarrja, përkatësisht përmes ligjit Kosovës do t'i mundësojë një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe një dinamikë më të zhvilluar dhe të avancuar e përmbushjes së objektivave të veta zhvillimore.

Një shumë e arsyeshme e borxhit është një mjet i rëndësishëm për stimulimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës, natyrisht kur ajo përdoret për qëllime të mirëfillta, siç janë investimet kapitale dhe investimet tjera të nevojshme, të cilat shkojnë në përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme të shoqërisë kosovare.

Jemi shumë të vetëdijshëm se borxhi mund të krijojë edhe vartësi, bile vartësi të rrezikshme, prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm me shumën e huamarrjes në mënyrë që të mos e rëndojmë buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ligji për borxhet publike do t'i mundësojë Republikës së Kosovës që të ndjekë, besoj, mënyra se si është hartuar një rrugë të mesme, të kujdesshme përmes të cilës përcaktohen kufijtë e arsyeshëm të nivelit të borxhit dhe qëllimet për të cilat mund të merret një borxh publik.

Përmes këtij ligji për borxhet, pra Ligji për hua ose borxhin publik, Kosova do të bëhet pjesë e komunitetit financiar ndërkombëtar. Tani, sidomos, meqë jemi anëtar të barabartë dhe të plotfuqishëm në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore ne kemi një qasje në fondet e këtyre institucioneve financiare, por prapë po e theksoj duhet të jemi të kujdesshëm në marrjen e huave. Duhet ta marrim në dorë me kujdes të ardhmen e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe të bëjmë hapa të kujdesshëm në mënyrë që të evitojmë gabimet e shteteve tjera që i kanë bërë. Ju e dini që shumë shtete tani pothuaj se janë në fazën e bankrotimit për shkak të futjes në borxh shumë të madh.

Ligji për borxhet publike na ndihmon për të rregulluar në mënyrë të qartë marrjen dhe menaxhimin e borxhit publik. Këtë ligj besoj që do ta miratojmë gjithnjë me qëllim që të rregullojmë rrugën e qartë të nivelit të marrjes së kredive, mënyrës së marrjes së kredive, mënyrës së menaxhimit të borxhit dhe prioriteteve që ka zgjedhur Qeveria e Kosovës për nevojat e veta zhvillimore.

Ky ligj po ashtu është kërkesa e parë që duhet përmbushur dhe hap i normalizimit në krijimin e relacioneve tona me botën financiare moderne.

Duhet të theksoj se ky ligj do t'i realizojë së shpejti këto gjëra, ndër të tjera:

Në momentin kur miratohet ky ligj, Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka marrë të gjitha hapat që të bëjë kreditimin, klasifikimin kreditor ose kredit rating, që i thonë në mënyrë që klasifikimi kreditor i shtetit të Kosovës të ndihmojë në tërheqjen e një numri sa më të madh, me një bazë më të gjerë të investitorëve të huaj duke matur rrezikun e saktë të bërit biznes në Kosovë e që konsideroj se është një parakusht që investitorët e kategorive të caktuara A, B, C e tjera, të kenë mundësi që të dinë se në cilën shkallë Kosova gjendet.

Si pjesë e përpjekjeve tona për të zgjeruar ekonominë e vendit, ne duhet natyrisht të fillojmë dhe të zhvillojmë tregun vendor të borxhit. Shumë deputetë e kanë ngritur këtë, shumë qytetarë e presin këtë. Nuk mund të bëhet kjo pa këtë ligj. Kur Kosova mund të emitojë instrumente pagese dhe letra me vlerë me investitorët institucional dhe bankat komerciale dhe bankat komerciale do të kenë në një mënyrë që të investojnë drejtpërdrejt në të ardhmen e zhvillimit të tyre dhe në të ardhmen e zhvillimit ekonomik. Ne nuk mund dot të arrijmë këtë çështje pa realizimin e këtij ligji, andaj uroj dhe kërkoj që ta mbështesim sa më fuqishëm në mënyrë që të jetë, nëse mund të them, një konsensus gjithë politik që ky ligj të marrë rrugën e vet sa më të shpejtë në miratimin e vet.

Më lejoni tani që të shkoj në disa pika kyçe se çka përmban ky ligj.

Shuma e borxhit të ri shtetëror dhe mjetet për ta paguar kryegjënë dhe interesin e borxheve ekzistuese, duhet të përfshihen në secilin buxhet vjetor dhe ekziston kufiri absolut për shumë e përgjithshme të borxhit shtetëror. Është e definuar me ligj.

Shuma e përgjithshme e borxhit shtetëror, e cila përfshin borxhin shtetëror, borxhin komunal si dhe të gjitha garancitë, nuk mund të kalojë më shumë se 40% të GJIDIPI-së. Ka praktika të shumta, e shihni, shtetet e ndryshme të botës janë futur në borxhe të shumta, ne nuk kemi monedhën tonë dhe duhet të jemi tepër të kujdesshëm, ndërsa konsideroj se prapë 40% të GDP-së është e mjaftueshme për të dhënë një impuls të fuqishëm në zhvillimin ekonomik.

Borxhi shtetëror ndërkombëtar duhet të negociohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe i nënshtrohet miratimit nga Kuvendi me 2/3, ashtu siç është përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ky ligj po ashtu kërkon që Ministria e Ekonomisë dhe Financave në baza vjetore të raportojë dhe të dorëzojë në Kuvend një program për borxhet shtetërore, një politikë kombëtare të borxheve dhe një strategji për menaxhimin e borxheve, të bazuara në analizat e qëndrueshmërisë së borxheve.

Ligji gjithashtu parasheh emetimin dhe menaxhimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zhvillimin e një tregu të brendshëm të letrave me vlerë.

Pjesa e dytë që ka qenë mbase më e vështira dhe më e debatuar, ka qenë pjesa e menaxhimit të borxhit publik për komunat. Komunave të Kosovës përmes këtij projektligji, përkatësisht përmes këtij ligji pas miratimit do t'u lejohet të huazojnë borxhe afatshkurtra dhe borxhe afatgjata. Duhet ndjekur procedura për huamarrje të cilat përfshijnë miratimin e një vendimi të Kuvendit komunal, që përmban demonstrimin e përputhshmërisë me kufijtë e borxheve dhe verifikimin e fondeve të buxhetit.

Në bazë të projekt propozimit asnjë komunë nuk do të mund të marrë borxh as afatshkurtër as afatgjatë në qoftë se raportet e auditimit në dy vjetët e fundit nuk kanë dhënë kualifikim përkatësisht shkallë të pakualifikuar, përkatësisht nuk është vërtetuar se menaxhimi i parasë publike në komunë nuk është bërë me standardet më të larta të menaxhimit të parasë publike. Dhe, konsideroj që kjo është një siguri, është po ashtu një nxitje që komunat ta përmirësojnë menaxhimin e parasë publike dhe procedurat e menaxhimit të aseteve të tyre.

Borxhet afatshkurtra duhet të jenë të pagueshme brenda një viti dhe mund të merren vetëm për financimin e përkohshëm të deficitit të rrjedhës së parasë së gatshme. Borxhet afatshkurtra nuk guxojnë të kalojnë 5% të hyrave të buxhetit të komunave dhe komuna është e detyruar që të mos ketë borxhe afatshkurtra të pa paguara për 30 ditë rresht për secilën vit fiskal.

Borxhet afatgjata mund të merren vetëm për investimet kapitale, që kanë kohën e dobisë më të gjatë se 3 vjet, maturimi i borxhit nuk mund të tejkalojë periudhën e dobisë së investimeve i cili financohet dhe duhet të përfshihet në buxhetin e komunave, në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe në planin e investimeve kapitale. Shërbimi i borxheve afatgjata, që duhet të paguhet për cilindo vi, nuk guxon të tejkalojë 10% të hyrave të buxhetit të komunave, ndërsa borxhet afatgjata komunale gjithashtu i nënshtrohen shqyrtimit dhe miratimit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Borxhi dhe garancitë komunale nuk mund të kalojnë më shumë sesa 40% të hyrave të përgjithshme të një komune.

Në fund më lejoni po ashtu t'ju informoj se nuk ka qenë e lehtë për ta negociuar këtë ligj me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Neve na është dashur dy misione të Fondit Monetar Ndërkombëtar të vijnë në Kosovë për të harmonizuar këtë pjesë, sidomos pjesën për borxhet komunale ku shpeshherë në shtetet në tranzicion është bërë skemë, mund të them, po thuaj se edhe piramidale. Ka pasur raste në shtetet në tranzicion kur komunat pothuaj se kanë bankrotuar dhe ne kemi qenë tepër të kujdesshëm që të mundësojmë, një, që ato komuna të cilat kanë një menaxhim të mirë të financave publike mund të marrin borxh, shtetet të cilat kanë projekt të saktë për investimin e

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër për paraqitjen!

Kërkoj deklarime te grupeve parlamentare.

Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në vazhden e përpjekjeve për të kompletuar bazën ligjore për rregullimin e çështjeve financiare dhe ekonomike, është edhe Ligji për borxhet publike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mirëpret dhe e përshëndet sjelljen në Kuvend të këtij ligji, me rëndësi të veçantë.

Ekziston një kërkesë ligjore e cila kërkohet nga të gjitha shtetet që të kenë një ligj për borxhet i cili në mënyrë specifike autorizon dhe rregullon: emetimin, menaxhimin dhe ri pagesën e borxhit dhe të garancive para hyrjes në çfarëdo huamarrje. Projektligji për borxhet publike është një kornizë gjithëpërfshirëse për emetimin dhe menaxhimin e të gjitha llojeve të borxheve qeveritare dhe të garancive ku po ashtu rregullohen edhe borxhet ndërkombëtare, siç janë borxhet midis Kosovës dhe institucioneve ndërkombëtare financiare si dhe borxhet e brendshme, që do të emetohen nga Kosova në formë të boneve të thesareve dhe të obligacioneve.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i bazës ligjore, krijimi i procedurave dhe kufizimeve për huamarrje dhe për garanci. Në të njëjtën kohë qëllimi i këtij ligji është që t'i japë Republikës së Kosovës të drejtën për të huazuar para, për të dhënë garanci për hua, për të paguar shpenzimet për marrjen e borxhit dhe për të paguar interesat e borxheve të saja shtetërore. Veç kësaj, synon edhe t'i japë Ministrisë së Ekonomisë të drejtën dhe përgjegjësinë për t'u kujdesur për tërë menaxhimin dhe administrimin e borxheve dhe të programeve të autorizuara për garancinë e huave të Republikës së Kosovës duke përfshirë kufizimet, zhvillimin e një programi dhe strategjie për menaxhimin e borxheve.

Sipas këtij ligji, Ministria e lartpërmendur është entiteti i vetëm i autorizuar për të hyrë në borxhe shtetërore për financimin e deficitit të buxhetit shtetëror kur shpenzimet e autorizuara me ligj tejkalojnë apo ka mundësi të tejkalojnë të hyrat e nevojshme për t'i paguar ato.

Në nenin 10 të këtij ligji të propozuar përcaktohen edhe prioritetet e borxhit shtetëror ku po ashtu në po të njëjtin nen precizohet se disa instrumente të veçanta të borxhit shtetëror mund të kenë siguri plotësues përmes kolateralit të specifikuar i cili bllokohet vetëm për pagesën e këtij lloji të borxhit. Shteti nuk mund të lë peng kolateral i cili është thelbësor për ofrimin e shërbimeve publike. Projektligji i propozuar marrë në përgjithësi përmban një teknikë juridike të mirë. Sa i përket gjuhës juridike propozoj që terminologjia juridike latine kudo që është, në disa nene, të zëvendësohet me terminologji juridike në gjuhën shqipe, që mundëson që ligji të jetë më i lehtë për t'u zbatuar në praktikë.

Ministri i Ekonomisë e përmendi çështjen e letrave me vlerë dhe unë konsideroj se ky ligj është i domosdoshëm për ta kompletuar kornizën gjithëpërfshirëse për të rregulluar edhe çështjet e borxheve publike dhe ligjit me vlerë që i rregullon në mënyrë më specifike çështjet e adresuara në këtë ligj. Po ashtu edhe Ligji për detyrimet i cili së shpejti do të procedohet në Kuvend edhe pse është miratuar në shqyrtimin e parë dhe të dytë në Kuvendin e Republikës së Kosovës do ta përbëjë dhe do ta plotësojë zbrazëtirën juridike që ka ekzistuar po ashtu në fushën e borxheve publike, marrë në tërësi.

Unë e përshëndes Ministrinë për punën e bërë, për intensitetin e shtuar në drejtim të miratimit të ligjeve funksionale, të ligjeve të cilat na nevojiten për ekonominë e lirë të tregut.

Në emrin tim personal dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike konsiderojmë se Ligji i propozuar duhet të miratohet në shqyrtim të parë, ndërkaq amendamentet e konsiderueshme që mendoj se do të parashtrohen do t'i parashtrojmë në Komisionin funksional. Ju falënderoj për vëmendjen.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Deklaratën për Grupin Parlamentar të LDK-ës e paraqet deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për borxhet publike. Së pari dëshiroj të them se ne i japim mbështetje në parim, por dëshiroj t'i them disa vërejtje të cilat mendoj se për ne janë dhe konsistojnë të arsyeshme. E kuptojmë pasi që është legjislacion i ri dhe deri tani nuk ka qenë e rregulluar kjo fushë specifike. Pra, ky ligj kërkon tretman më të veçantë ku duhet të fokusohemi në praktikën më të mira legjislative të vendeve perëndimore dhe duke iu përshtatur standardeve ndërkombëtare. E tha edhe kolegja që terminologjia juridike ka vërejtje, por këto ne duhet t'i eliminojmë, sepse janë të domosdoshme që nga qëllimi i këtij ligji, ku thuhet që ky ligj i jep të drejtë Republikës së Kosovës për të huazuar. Unë mendoj që me këtë ligj duhet të rregullohet forma – procedura, niveli dhe qeverisja me borxhin publik, prandaj nuk është e arsyeshme dhe kjo devijon edhe nga parimi kur thuhet veç kësaj synon edhe t'i japë ministrit të Ekonomisë dhe Financave. Nuk kemi adresë tjetër, jo të synojë, po ministri për Ekonomi e Financa është adresa e cila bëhet në menaxhimin dhe administrimin e borxhit publik.

E dyta, kufizimet me borxhin e përgjithshëm. Ajo çka është më se e domosdoshme, Ministria e di, dhe e dinë të gjithë ata që kanë dhe bashkëpunojnë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat tjera, ngarkimi vjetor i Qeverisë në vende të përparuara nuk mund të kalojë 10% të buxhetit të vitit paraprak dhe kjo domosdoshmëri, sidomos edhe ne si vend në tranzicion, duhet të jetë e përfshirë në ligj edhe për buxhetin e Kosovës. Kjo është te komunat, të buxhetit për ngarkimin vjetor të buxhetit komunal, por nuk është e përfshirë në buxhetin e përgjithshëm, domethënë, në buxhetin qendror.

E treta, rregullat e borxhit shtetëror, te neni 6. Emetimi i borxhit në formën e letrave me vlerë. Kjo do të thotë se është dashur dhe kemi obligim sa më shpejt që të jetë Ligji për letrat mbi vlerë, përndryshe kjo formë e emetimit nuk mund të zbatohet me rregullore apo nuk përshtatet në rregullat e institucioneve financiare ndërkombëtare.

Dhe, te neni 10 – prioriteti i borxhit shtetëror. Unë mendoj që hartuesit e këtij projektligji dhe kjo do të jetë edhe punë, është më shumë në formë eseje dhe devijon nga kuptimi i përgjithshëm se kemi edhe terminologji, do të jetë "pari passu", për shembull, që nuk kuptohet dhe nuk është as terminologji ekonomike.

Ajo çka e tha ministri, e tha te ngarkimi te GDP-ja, domethënë 50%, ky e tha 40%, domethënë, ajo duhet të ndryshohet se edhe ne e kemi pasur këtë vërejtje, që nuk mund të kalojë sepse, nëse i afrohet 50%-shit atëherë do të jetë problem shtetëror.

Dhe, më kryesorja, që mendoj se duhet të jetë strikt e definuar, edhe është edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e gjithë kjo duhet të shkojë përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh politikat e ngarkimit vjetor, duhet t'i nënshtrohet votës së Kuvendit në të gjitha format, edhe shlyerjes së borxheve edhe ngarkimit të ri, edhe kryegjësë, domethënë të gjitha këto duhet të jenë mirë të definuar, sepse mund të kalojmë në ndonjë krizë financiare ndërkombëtare.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim dhe mendoj që maksimalisht duhet të angazhohen edhe në nivel të ekspertëve, sepse është një ligj shumë i rëndësishëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, flet kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Fillimisht në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës duhet t'ju themi për hair ballkoni, se është goxha një send i rëndësishëm dhe mirë që ka ndodhur, do të thotë, ky ballkon, por duhet thënë edhe për hair "Rilindja" që ka ndodhur dhe, domethënë, ka ndodhur një send i madh. Edhe dëgjova se disa ministri kanë për të hyrë aty, do të ishte mirë të jetë ministri i Financave, të shkojë të hyjë brenda se i ka dhënë nga 1 milion e 300 mijë euro për një kat renovim dhe kur ta kap ligji të jetë në vend të ngjarjes.

Ky ishte një digresion i vogël. Faleminderit që më duruat, po tash dua t'ia nis të flas për ligjin.

Ne mendojmë se ky ligj nuk duhet të vijë hiq këtu, nuk duhet të ndodhë për shkak se për ta thjeshtësuar, ky është ligj për të marrë hua, Kosova për të marrë hua. Tani nuk do të kishte qenë keq hiq të marrë hua Kosova sikur mos të kishte dhënë hua. Domethënë Kosova ka dhënë hua dhe nuk ka nevojë të marrë, realisht. Dhe, çfarë huaje ka dhënë se? I ka dhënë 266 milionë euro që 2 vjet, nuk e dimë as kujt e nuk e dimë sa kemi interesin. Përpos kësaj që nuk e dimë askujt as sa është interesi, janë dhënë kundër ligjit se s'kemi ligj për letrat me vlerë, e thanë dy kolegët paraprak edhe të Partisë Demokratike të Kosovës edhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Thotë, është shkelur ligji, është dhënë hua dhe tash po lypim ligj për të marrë hua. Qysh ia kemi nisur ne, bën vaki i marrim parat tona hua dhe iu paguajmë kamatë. Nuk i dihet, çka s'bën vaki te ne. Bën edhe kjo. Por, kjo është arsyeja e parë pse ne mendojmë se ky ligj nuk duhet të vijë hiq në Parlament se nuk është drejt kështu për të bërë, nuk është drejt kështu të bëjmë me mjetet publike të popullit të Kosovës.

Çështja tjetër është, teknike, tipik e politikës së ligjit. Përmenden letrat me vlerë edhe shikoni ju te definicionet është njëfarë definicioni për letrat me vlerë. Për letrat me vlerë duhet të ketë ligj, jo definicion para ligjit, se edhe ai definicion dhe letrat me vlerë janë diçka të çuditshëm. Askush nuk e di çka janë. Qysh do të implementohet ligji? Pse vjen ligji para Ligjit për vlerat me vlerë, para nesh, pse ne duhet me votua këtë ligj? Pse duhet

Kuvendi i Kosovës ta votojë ligjin, pa e pasur një ligj tjetër i cili duhet të jetë element përmbajtësor i këtij ligji brenda? Kjo është e dyta.

Dhe, në fund të fundit, veç po kërkojmë edhe një herë ta dimë – qysh mund të vijë ligji në lexim të parë dhe fillimisht të gjithë të thonë që duhet t'i bëjmë shumë amendamente? Është një formë jo e mirë e punës së një legjislativi, për shembull. Të gjithë thonë, që po mirë, po e kalojmë ligjin në lexim të parë, por duhet shumë amendamente për t'i bërë. Kur ligji punohet qysh duhet, ministri duhet ta mbrojë ligjin dhe të tentojë që të mos ketë asnjë amendament, nëse ka pasur njerëz që kanë menduar saktë çka donë të bëjnë me këtë ligj? Qysh mund të vijnë e të thonë, që ligji, po hajt se i bëjmë amendamente hala pa kaluar në lexim të parë? Çfarë praktike legjislative është kjo, çfarë praktike e qeverisjes, në fund të fundit?

Për ta përfunduar, po them, a po ju duket edhe juve që është rritur Aleanca a jo?

Do me thënë, ju pak jeni kah më dukeni diçka. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet Gjini!

Për Aleancën Kosova e Re, flet deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANAI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Projektligji për borxhet publike, i sjellë sot në esencë plenare, është analizuar nga Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re dhe mund të them se është një infrastrukturë ligjore e cila i duhet Kosovës. Me të gjitha të metat teknike që janë në këtë ligj dhe me të metat juridike, që i potencuan dy parafolësit nga PDK-ja dhe LDK-ja se mungon Ligji për letrat me vlerë dhe ky projektligj, gjatë amendamentimit të vet duhet të pësojë disa ndryshime. U potencuan të gjitha ndryshimet deri më tani dhe formimi i një strategjie për menaxhimin e borxhit brenda kornizës së qëndrueshme, potencohet agjenti fiskal. Në shumë vende të rajonit, zotëri ministër, ju e dini mjaft mirë se rregullimi i huamarrjes vendore vendoset edhe në Ligjin për buxhetin, ndërsa huat afatshkurta dhe afatmesme vendosen në bazë të buxhetit total të shtetit, mirëpo në përgjithësi mund të them se Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e përkrah dhe të gjitha amendamentet e veta do t'i japë në komisionin parlamentar.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Për Lidhjen Demokratike të Dardanisë, Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë me kujdes e kemi shqyrtuar Projektligjin për borxhet publike dhe vërtet kemi pasur dilemën se a është i nevojshëm ky ligj apo a është momenti që ky ligj të vijë në këtë kohë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Fillimisht, përpara kësaj duhet ta shtrojmë një pyetje për Qeverinë dhe ndoshta është dashur të përgjigjet Qeveria se a ka, a ka krijuar Kosova parakushte për të hyrë në borxhe, sepse për të hyrë në borxhe është lehtë, por për të dalë nga ato borxhe është shumë vështirë dhe, vërtet, duke parë një zhvillim ekonomik kaq të zvogëluar, duke parë bruto produktin vendor në një masë kaq të vogël, mendoj se Kosova e ka pak sa vështirë të futet në borxhe dhe të marrë hua nga vendet e ndryshme.

Sido që të jetë, në vend të kësaj ne do t'ju sugjerojmë që t'i përkrahni koncesionet, ta përkrahni partneritetin publiko-privat dhe të përkrahni format e ndryshme të zhvillimit ekonomik, të cilat do ta çojnë dhe do ta avancojnë shtetin e Kosovës. Përndryshe, një Qeveri e cila nuk na sjell analiza për zhvillimet e mëtutjeshme dhe kërkon para nesh një ligj i cili do ta futë Kosovën në borxhe dhe nuk i dihet mandej se ku do të shkojë Kosova dhe në çfarë parametrash do të ecën shteti i Kosovës, ndoshta do të jetë vështirë e realizueshme.

Sido që të jetë, kjo është ndoshta puna më e mirë të cilën po e bën Qeveria dhe vërtet kërkon miratimin e këtij projektligji, në parim. Ligji, u tha edhe nga kolegët deputetë nga partitë e tjera, në fakt parasheh letrat me vlerë, kurse ne në Kosovë nuk kemi Ligjin për letrat me vlerë. Nuk di se si po mund t'i paraprijë një ligj atij ligji, ligjit të mëparshëm i cili nuk ekziston, por na vjen një ligj dhe kërkon që letrat me vlerë të jenë të parapara dhe të jenë kusht të hyrë në borxhe. Sido që të jetë, ne i kemi rezervat tona rreth këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!
Fjalën e merr deputeti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Yasa Tasarısının amacı, Kosova Cumhuriyetine, borçlanma, borç alma garantisinin sağlanması, borçlanabilmek için önkoşul olarak masrafların ödenmesi ve borç aslının ve faizlerin ödenmesi için esas prensiplerin belirlenmesidir.

Bundan başka bu Yasa, İktisadi ve Finans Bakanına, Kosova Cumhuriyeti'ne borçların iadesi yönünde garantinin sağlanmasına yönelik borç ve ilgili programların idare edilmesi ve yönetilmesi konusunda hak tanımaktadır.

Bu Yasa Tasarısı, devlet ve belediyelerden başka iç ve yabancı olmak üzere bütün kamu borçları ve garantilerinin düzenlenmesi ile ilgili faaliyetleri belirlemektedir.

Yasa Tasarısının hükümlerine göre Bakanlık, devlet adına borçlanabilen tek kurumdur. Dolayısıyla Bakanlık, devlet borçlarından sağlanmış olan gelirlerden, belediyeler dahil olmak üzere, kamu sektöründeki her kuruma borç verme hakkına sahiptir.

Borçlanma Sözleşmesinin süre ve koşulları ile ilgili kurallar, İktisadi ve Finans Bakanlığı tarafından saptanır. Devletin borçlanması durumunda finansman, değerli kağıtlar ve ikili sözleşmeler ile gerçekleşir. Kendisine düşen yasal yükümlülüğü yerine getirmesi gerektiğini göz önünde bulundurmakla birlikte Bakanlık tarafından gerekli bulunan ve borç olarak saptanmış tutar, Kosova Bütçesi tarafından göz önünde bulundurulacak ve takip edilecektir.

Bakan, borçların idaresi ve pratikte uygulanması ile ilgili kuralları saptar ve prosedürleri belirlerken, Bakanlıkların Hazine Dairesi ise borçların ve hazır paranın idare edilmesi ile sorumludur.

Dolayısıyla Bakan devlet garantilerine ait sözleşmeleri imzalamak ve bu Yasa Tasarısı ile borçlanma garantisine layık görülen bütün borçlanmaların finansi koşullarının denetimini yapmakla yükümlüdür.

Ancak Belediye ayarındaki finansi sözleşmeler sayesinde meydana gelen parasal borç ve finansi yükümlülükler, sözleşmeyle ilgisi olan bütün garantileri de barındırır. Belediyelerin bütün borçları, genel belediye yükümlülüğü şeklinde sağlanır ve hesaplanır.

7+ Parolmenter Grubu olarak biz bu Yasa Tasarısını prensipsel olarak kabul ediyor, bizden gelecek deęiştirgeleri ve katkımızı İşlevsel Komisyonlara sunacaęız
Teşekkür ederim

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Tani kemi tre deputetë që janë paraqitur. Unë i lus deputetë të tjerë të hynë në sallë, sepse besoj që së shpejti do të votojmë për Ligjin. Fjalën e merr deputeti Driton Tali.

DIRTON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Po, fillimisht më lejoni që të ankohe se jam anashkaluar gjatë pyetjeve. Në pyetje po ashtu zoti spiker i Parlamentit ma anashkaloi, po edhe një përgjigje të vogël t'ia jap zotit ministër në atë komentit që e bëri në fund. Unë për atë jam për ta demantuar Qeverinë dhe Qeveria duhet të jetë....

KRYESUESI: Zoti deputet, e ke fjalën për Ligjin. Të lutem shumë, bëni pyetje prapë. E ke fjalën për Ligjin, të lutem!

DRITON TALI:... mënyrë tjetër nuk kam, zoti kryesues. Me gjithë respektin për të reaguat, po të më jepnin mënyra tjera...

KRYESUESI: Reagove, tash kalo në ligj.

DRITON TALI... jo, edhe më tutje me zotin ministër, unë për atë e dhashë atë demantin e juaj që e keni bërë për arkat fiskale, t'i kemi deklaratat e juaja konstante, nuk do të ketë nevojë për demantim. Sidoqoftë, po kthehem tash në këtë pyetje, me lejen tënde, zoti kryesues!

Ky ligj, Ligji për borxhet e shtetit, mendoj se na vyen, megjithatë. Është një ligj i shkruar gjithçka në të, mendoj se duhet në dorën e dytë të përmirësohen shumë gjëra. Për të mos hyrë, se ka shumë, singërisht, do me thënë duke u nisur nga këto më të mëdhatë, do me thënë bëhen dallime ndaj borxheve ndërkombëtare, borxheve shtetërore, që nuk mendoj se duhet të jenë, ato janë borxhe. Borxhi shtetëror, nëse mendohet në borxhin e brendshëm, atëherë është huaja, huaja qeveritare, janë çështje që njerëzve të profesionit ua vrasin syrin. Unë pash këtu diçka që mendoj se, gjithmonë duke pasur parasysh situatën në të cilën jetojmë, te neni 7, kur flitet për letrat me vlerë, është një fjali këtu që për shumë lexues nuk çon peshë. Është letra me vlerë të Qeverisë, flas te pika 2.1, për shitje "me vendosje private". Kjo "me vendosje private" nuk jep kuptim në gjuhën shqipe, në anglishte jep, por është anglishte e vjetër, andaj edhe ka mbetur si term në vokabularin financiar. Do me thënë, pagën plejzment, nënkuptohet kur letrat me vlerë nuk i ofrohen publikut të gjerë, por në mënyrë private investitorëve të caktuar. Jo që nuk i besoj ministrit të Ekonomisë dhe Financave, se atë e kam treguar disa herë që nuk i besoj, por edhe ministrave të tjerë në këtë situatë mendoj se nuk duhet lënë ajo mundësi, do me thënë nuk duhet lënë mundësia që letrat me vlerë të Qeverisë të shiten, me ofertë private duhet të jetë në gjuhën shqipe, do me thënë me ofertë private, atëherë ia jep kuptimin për opinionin shqiptar apo shqipfolës.

Pastaj, kishte edhe gjëra tjera. Ishte një term këtu që është përkthyer në gjuhën shqipe “me interes bartje”. Jam i bindur që as ministri nuk e kupton. Në gjuhën angleze kuptohet ju interes bering bejzis, do me thënë kjo është shumë teknike dhe mendoj se për momentin po ashtu është dashur të kursehet ky ligj prej këtyre termave, duke pasur parasysh gjithmonë, po them, nivelin në të cilin jemi dhe nevojat që i kemi. Tash nëse do ministri, po ia shpjegoj çka është kjo, por mendoj se nuk e kupton edhe nëse ia shpjegoj, zoti kryesues, kështu që nuk po humbim kohë. Është mirë që të diskutohet edhe një herë mirë me komunitetin afarist, me njerëzit të cilët i dinë këto gjëra, zoti ministër, do të shihni sa sende do t’i hiqni nga këtu. Pajtohem me atë që duhet ta kemi një ligj për letrat me vlerë pak më të madh se këtu që e keni përmendur, por jo kaq voluminoz, nuk keni nevojë, nuk jemi kah e zbulojmë Amerikën, gjërat janë të zbuluara. Nuk kemi nevojë çdo gjë të kemi në ligj dhe asgjë mos të japë kuptim. Unë jam kështu në disponim tëndin, nëse ke nevojë për ndonjë shpjegim më të thuktë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri deputet! Ti e kritikove, por iu ofrova, mirë bëre! Deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, para se të flasim për këtë ligj, më befasuan disa kolegë për qasjen e tyre që, në të vërtetë, qasja e tyre është, tash mund të flasim për atë qasje neokomuniste që e patët në raport me ligjin.

Në qoftë se dikush mundet në këtë sallë të më argumentojë me fakte jo politike, se nuk i nevojitet Kosovës Ligji për huan publike, respektivisht për borxhet publike, unë kisha për të dhënë shumë shpjegime, respektivisht arsyeshmi shumë të mëdha. Andaj, më befasojnë disa kolegë të mi, sidomos këta të fundit që flasin në emër të ekspertizës për ekonomi, a në fakt nuk ia qëlluan hiq, mos më keqkuptoni, ju lutem.

Aspekti i mundësisë së investimeve dhe i financimit të një shteti në shekullin XXI nuk mund të paramendohet si shtet i mbyllur dhe me mundësi buxhetore vetanake. Këtë duhet ta kuptojmë. As shtetet më të zhvilluara të botës nuk mund ta realizojnë këtë. Në qoftë se e shikojmë raportin e pjesëmarrjes së borxhit të huaj, në raport me bruto produktin vendor, të shohim shumica e vendeve në zhvillim e kanë madje edhe mbi 50%, mos të flasim për borxhet tjera. Aspektet e mungesës së Ligjit mbi letrat me vlerë dhe aspektet e funksionalizimit të ligjit mbi Bankën Qendrore, padyshim janë kruciale në këtë proces. Në qoftë se dëshirojmë të kemi bankë qendrore dhe të sillemi si entitet ekonomik karshi vendeve dhe partnerëve tjerë, qoftë institucioneve tjera financiare, qoftë vendeve të tjera, ne duhet ta kemi Ligjin për huan publike, respektivisht për borxhin publik. Por, funksionaliteti i Bankës Qendrore nuk është në atë nivel që të na përgatitë një infrastrukturë të mjaftueshme për marrëdhëniet e tilla hua-marrëse dhe hua-dhënëse. Kosova në këtë nivel të zhvillimit ekonomik nuk mundet as të paramendohet pa hyrje në marrëdhënie hua-marrëse dhe hua-dhënëse në raporte të tilla, duke marrë parasysh edhe nivelin e GDP-së në Kosovë, duke marrë parasysh edhe nivelin e buxhetit që ka Kosova, duke marrë parasysh edhe mundësitë perspektive të zhvillimit të saj me mundësitë vetanake, nuk ka shans të zhvillohet pa hyrë në marrëdhënie të tilla.

Shkalla e pjesëmarrjes që këtu u bisedua në lidhje me raportin mbi bruto produktin vendor, në raport me huan apo me borxhet që do të hyjë shteti i Kosovës apo Republika e Kosovës, 40%, 50%, kjo mund të diskutohet duke marrë parasysh fuqinë ekonomike të Kosovës dhe mundësinë e buxhetit të Kosovës të inkasojë të hyra të mjaftueshme që do

të mbulojnë edhe shkallën e riskut që vjen si rezultat i këtyre borxheve, por padyshim edhe kryegjënë, respektivisht sasinë apo masën e mjeteve të huazuara.

Së fundi, krejt, nuk dua të lëshohem në dobësitë teknike dhe linguistike të draftit të propozuar, që ka mjaft, mirëpo shpresoj që do të gjejmë përkrahje te deputetët dhe ata të cilët mendojnë për një mjedis të caktuar ku mbretëron ekonomia e tregut dhe demokracia liberale, ky ligj është mjaft, mjaft i nevojshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Ramosaj! Diskutuesi i fundit është deputeti Riza Smaka. Unë i thërras, regjisë i them t'i thërras deputetët, se do të votojmë pas këtij diskutimi.

RIZA SMAKA: I nderuari, zoti kryesues!

Të nderuar ministra Shala, Gashi,

Deputetë e deputete të respektuara,

Do të orvatem t'i jap disa vërejtje të karakterit parimor me synimin më të mirë që ta bëjmë këtë dokument ashtu si duhet ta bëjmë, në mënyrë që të jetë aplikativ, të jetë eficient.

Natyrisht, në fillim do ta potencoj këtë se ky akt ligjor është i nevojshëm, e shpjegoj mirë kolegu Ramosaj. Ka shumë terma nebuloze të padefinuara, madje të definuara gabimisht. Natyrisht, në procedurë do të përpiqem që t'i bëjmë disa modifikime. Bie fjala, borxhi i konsoliduar e tjera, e tjera, ose letrat me vlerë, që është një term i tejkaluar. Në të vërtetë, këtu është fjala që e shprehë një përmbajtje tjetër fare ose kontrata për financim, thotë, është dokument ligjor. Kontrata nuk është dokument ligjor, kontrata është marrëveshje ndërmjet dy apo më shumë kontraktorëve për ta bërë një punë juridike, për ta ndryshuar një punë juridike, për ta plotësuar një punë juridike, për ta ndërprerë një punë juridike me qëllim të realizimit të një efekti të caktuar, pra nuk është, a tjetër është që ajo pacta sunt servanda që kontrata e ka karakterin e ligjit edhe të obligimeve ligjore për kontraktorët, ama nuk është dokument ligjor. Është fjala për gabim material, jo kështu formal.

Te neni 11, bie fjala, shprehja thotë: "Qeveria lëshon vendim". Qeveria nuk lëshon vendim, Qeveria vendos, si lëshon, ajo nuk është kurrfarë shprehje me të cilën do ta autorizonte ministrin për të nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare. Unë gjykoj se do të ishte një ngarkesë e madhe për ministrin, një, dhe nuk është në harmoni me praktikën e mira ndërkombëtare që u referohen konventave, kovenateve dhe traktateve. Do të thotë, duhet t'i harmonizojmë me praktikën ndërkombëtare të mira, se nuk është, ministri do të duhej të kishte autorizime të plota për, është shprehje tash menaxhim, administrimin, drejtimin, ekzekutimin e ligjshëm të dokumentit ndërkombëtar. Ajo është çështje që i referohet shtetit, ju lutem. Tregu financiar, primar, sekondar janë definuar gabimisht. Nuk po hyjë në detale. Nuk e kemi Ligjin për bursën, nuk e kemi Ligjin për letrat komerciale, se jo letrat me vlerë, letrat komerciale apo instrumente negociatore, ky është termi bashkëkohor që ka ndryshuar pak përmbajtja e letrave me vlerë. Natyrisht se këto do t'i bëjmë me siguri, unë do të isha angazhuar sa më parë që është e mundur, e këto janë të tipit lex specialis derogat legi generalli, do të thotë, kur do të hynin këto në fuqi, shumë dispozita të këtij ligji që do ta miratojmë do t'i shfuqizonte me të mirë të asaj që të kompletohej ky dokument.

Këtij dokumenti i mungon një kaptinë për masa ndëshkimore, se akti ligjor pa masa ndëshkimore s'ka kurrfarë kuptimi. Mbetet në nivelin e aktit moralizues, duhet kështu, duhet ashtu, por nëse nuk e përfillë, kurrgjë kurrkujt, e te akti ligjor është e kundërta. Duhet medoemos deshe s'deshe, nolens volens, se ndryshe pasojnë masat të përcaktuara me ligj, nëse s'ka të përcaktuara kurrfarë masash.

Unë, duke llogaritur se do ta japim një kontribut të konsideruar në procedurat që presim, kam dëshirë dhe kënaqësi ta përgëzojmë ministrin Shala për punën e bërë, për përkushtimin e bërë edhe për këtë dokument i cili është i nevojshëm për plotësimin e këtij vakuumi juridik dhe për ekonominë e tregut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Zoti ministër, nëse ke shkurt diçka, urdhëro!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ju faleminderit të gjithë deputetëve për kontributin e dhënë konform mundësive dhe kapaciteteve të tyre profesionale. Dua posaçërisht të falënderoj profesorin Berim Ramosaj për një shpjegim, konsideroj, të thuktë. Ndërsa, për opinionet se a i duhet ky ligj Kosovës apo jo, sinqerisht më besojnë me qëndrimet dhe opinionet të cilat kontestojnë edhe vetë shtetin e Kosovës. Nuk ka mund Kosova deri sot të ketë Ligj mbi huat dhe huat nuk do me thënë veç të marrim borxh, por huat përkatësisht imitimi i letrave me vlerë është kompetencë e një shteti. Ne nuk kemi mund ta bëjë këtë se s'kemi qenë shtet. Pra, ndoshta është një mungesë e të kuptuarit të këtij ligji ose është një përpjekje për të deformuar edhe aspektet të cilat janë të njohura botërisht, profesionalisht, por sido që të jetë, ky forum shpeshherë përdoret edhe për spekulime politike, le të shkojë në vlerat e tyre profesionale secili që i merr.

Unë mund t'ju them se ky ligj do t'i mundësojë dy gjëra fundamentale Kosovës.

Nën një, që paratë e investuara fatkeqësisht jashtë Kosovës, e them këtë dhe pajtohem me kritikuesit, mund dhe vetëm atëherë do mund të kthehen dhe të investohen në Kosovë, që shteti i Kosovës do mund të emitojë letra me vlerë dhe pajtohem që mënyra e emetimit të letrave me vlerë të përcaktohen me ligje të tjera, por ky është ligji organ, pa këtë ligj ne nuk mund të fillojmë ato t'i bëjmë.

Ndërsa sa iu përket sugjerimeve të kolegëve tjerë, profesorëve të nderuar, do të jem shumë i përkushtueshëm që bashkë me juve t'i inkorporojmë të gjitha gjatë shikimit. Mund të them që është harmonizuar plotësisht me Fondin Monetar Ndërkombëtar, sidomos disa aspekte të plafonit të marrjes së kredive, gjithnjë për të siguruar që Kosova mos të ketë rrezik të ndonjë marrjeje të pakalueshme ose të pamundshme të borxhit konform kapaciteteve dhe objektivave të veta. Gjithsesi, çdo marrje e borxhit do të jetë vendim i juaj, i Kuvendit, do me thënë me 2/3 bile. Ndërsa, emetimi i letrave me vlerë do të jetë konform procedurave dhe praktikave më të mira botërore që, natyrisht, do të jetë Banka Qendrore e Kosovës organ i cili do të bëjë menaxhimin dhe emetimin e tyre, ndërsa rregullat, rregullimin do ta bëjë Ministria e Ekonomisë dhe Financave, natyrisht, si pjesë e Qeverisë së Kosovës, në harmoni dhe në bashkëpunim me të gjithë ekspertët. Ju thërras të gjithëve dhe ju falënderoj, natyrisht edhe ata që shprehën vullnetin e tyre për të bashkëpunuar në këtë. Por, gjithsesi ky është një ligj që konfirmon shtetësinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ju informoj që në sallë kemi të pranishëm 79 deputetë. Unë e lus regjinë dhe deputetët të bëhemi gati që ta votojmë, në parim, projektligjin në fjalë.

Regjia, deputetët, të bëhemi gati të votojmë, votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, 9 vota “kundër” dhe 1 abstenim, kalon ligji në lexim të parë.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, dhe komisione të tjera të përhershme.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hetimin parlamentar

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi të Kuvendit, zotëri Bahri Hysenin, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë këtë projektligj.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në nenin 79, duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, në Rregullën 33, bazuar në Vendimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi të datës 23.02.2009, që ka marrë vendim për të hartuar Projektligjin për hetim parlamentar, sot para Kuvendit paraqet Projektligjin për hetim parlamentar, për lexim të parë.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke parë që Kuvendi i Kosovës ka nevojë në disa raste të formojë komisione hetimore parlamentare dhe duke pasur parasysh që baza juridike me të cilën kanë funksionuar këto komisione deri më tani nuk ka qenë e rregulluar me ligj, ka marrë vendim që të hartojë projektligjin në fjalë me qëllim që të rregullojë bazën ligjore për funksionimin e komisioneve parlamentare hetimore që do t'i kemi në Kuvendin e Kosovës.

Qëllimi i projektligjit është që në bazë të mjaftueshme t'u japë mundësi që komisionet hetimore parlamentare t'i kenë të qarta përgjegjësitë, funksionimin, organizimin, fushëveprimtarinë e komisioneve hetimore parlamentare.

Qërim tjetër dhe rëndësi e veçantë për komisionet hetimore parlamentare është që të jepet mundësia që Kuvendi i Kosovës përmes komisioneve hetimore parlamentare të debatojë në raste të caktuara kur paraqiten afëra korruptive, mandej keqmenaxhim në çështje të caktuara, shkelje të dispozitave ligjore, por edhe për çështje të tjera të cilat janë me interes të përgjithshëm jo vetëm për institucionet në Kosovës, por edhe për interesin publik të përgjithshëm.

Struktura e Projektligjit përmban gjashtë kapituj dhe ka gjithsej 25 nene.

Kapitulli i parë, flet për dispozitat e përgjithshme, ku natyrisht thashë që flet për qëllimin e ligjit, fushëveprimin e Komisionit Parlamentar Hetimor, përkufizimet e kështu me radhë.

Kapitulli i dytë, flet për dispozitat themelore, për themelimin e Komisionit Parlamentar Hetimor, pushimet e punës, mandatin e Komisionit Parlamentar Hetimor, si dhe detyrimet e organeve të Kuvendit të Kosovës për Komisionin Parlamentar Hetimor.

Kapitulli i tretë, rregullon përbërjen e komisionit, mënyrën se si mund të largohen dhe zëvendësohen anëtarët e komisionit, përbërja, emërimi dhe detyrat e kryesuesit të komisionit, organizimin e mbledhjeve të komisionit, procedura për vendimmarrjen dhe çështje tjera të cilat janë me interes për komisionet hetimore parlamentare.

Kapitulli katërt, rregullon të drejtat dhe detyrat e komisionit parlamentar gjatë fazës së hetimeve, sigurimin e provave, të drejtat dhe detyrimet e dëshmitarëve, të drejtat dhe detyrimet e ekspertëve dhe përfundimet e hetimit parlamentar.

Kapitulli i pestë, rregullon përgatitjen dhe përfundimin e raportit përfundimtar nga Komisioni Parlamentar Hetimor.

Kapitulli gjashtë, rregullon mënyrën e menaxhimit të mjeteve buxhetore nga komisioni parlamentar.

Gjatë punës së hartimit të projektligjit vlen të përmendet se kanë qenë të angazhuar të gjithë anëtarët e komisionit parlamentar dhe, natyrisht, kemi vepruar si komision parlamentar.

Vlen të përmendim faktin se gjatë kësaj pune janë angazhuar edhe shumë mekanizma apo shumë përfaqësues të mekanizmave ndërkombëtarë, vlen të përmendet se kanë qenë përfaqësuesit e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Lirive të Njeriut, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, institucionet gjyqësore, mandej KDI, NDI dhe shumë institucione tjera dhe, natyrisht, bashkërisht kemi arritur në përfundime që të kemi draftin e parë apo projektligjin sot para jush.

Projektligji ka implikime buxhetore, por implikimet buxhetore, sipas një deklarate që është bërë nga sektori i buxhetit në Kuvendin e Kosovës, janë të përballueshme, do me thënë, janë implikime buxhetore të cilat përafërsisht janë sa edhe për komisione të tjera të përhershme që i ka Kuvendi i Kosovës.

Natyrisht që ekziston edhe një opinion ligjor i Zyrës për Standardizim se çështja e projektligjit nuk është e rregulluar me ndonjë ligj mbi kombëtar, por të gjitha vendet individualisht e kanë të rregulluar çështjen e funksionimit të ligjeve për hetim parlamentar.

Sot kërkoj nga Kuvendi i Kosovës, nga deputetët që ta mbështesim Projektligjin, ta lexojmë në parim dhe ne do t'i presim edhe rekomandimet që dalin nga Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim me të gjitha komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme të Kuvendit të Kosovës, natyrisht edhe në mbështetje nga mekanizmat e tjerë që do të na ndihmojnë gjatë leximit të dytë, do të jemi në gjendje që brenda afatit të paraparë si komision ta procedojmë Ligjin për Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

Drejtimitin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Faleminderit!

Radha e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratikë, fjalën e ka Ramadan Gashi.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për hetimin parlamentar dhe ne si grup mendojmë se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka bërë një punë të mirë në hartimin e këtij ligji. Ne japim mbështetje në lexim të parë dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Kolë Berisha e ka fjalën.

KOLË BERISHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së në kuadër të përgatitjeve për këtë mbledhje plenare, ndër të tjera ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për hetim parlamentar dhe konsideron se me gjithë vërejtjet që mund t'i japim dhe këto janë të shumta, megjithatë i plotëson kriteret për miratim, në parim.

Prandaj, Grupi parlamentar e pranon në parim këtë projektligj dhe kontributin e tij do të japë në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Që në fillim, edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet Projektligjin, në parim. Unë do t'i bëj vetëm nja dy ose tri vërejtje të vogla, të cilat mund të përmirësohet, përndryshe është një ligj i mirë.

Te neni 4.1, thuhet që ngritjen e komisionit hetimor kanë të drejtë ta kërkojnë një komision i përhershëm parlamentar, atëherë thuhet 6 deputetë, dhe 1/3 e anëtarëve të Kuvendit. Mendoj që është pak problematike, se është e vetë kuptueshme që nëse thuhet 6 deputetë, mendohet 6 e më tepër, dhe nëse është 6 deputetë, atëherë kjo lihet, do të thotë çështja procedurale e 6 deputetëve dhe 1/3 të deputetëve të Kuvendit duhet të sqarohet në këtë nen.

Pika tjetër, thuhet te neni 13.1 se ky komision, do të thotë komisioni hetimor, ka të drejtë të kërkojë qasje të pakufizuar në dokumentet zyrtare. Mendoj se edhe deputetë kanë të drejtë në qasje të pakufizuar në dokumente zyrtare dhe duhet të thuhet – kanë të drejtë në qasje të pakufizuar në dokumente zyrtare, jo të kërkojnë si të tillë.

Edhe te pika 19.5, thuhet: “merr vendime me konsensus dhe nëse nuk ka konsensus, atëherë me shumicë”. Mendoj se edhe kjo është një çështje problematike për shkak se ky nen thotë që nuk është i domosdoshëm konsensusi, e nëse nuk është domosdoshëm,

atëherë duhet të thuhet shumë thjeshtë – merr vendim me shumicë, nëse ka konsensus është diçka tjetër. Janë krejt çështje procedurale që nuk e dëmtojnë në asnjë aspekt ligjin, por kishte për të qenë mirë të rregullohet. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar i AKR-së, kryetari i Grupit Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, i nderuari Kryetar!

Grupi parlamentar i AKR-së e vlerëson punën e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi në hartimin e këtij projektligji. Projektligji në fjalë ose ligji në fjalë ka qenë dhe është i nevojshëm për arsye se deri më tash komisionet hetimore parlamentare kanë vepruar në mbështetje të Rregullores së Punës. Ky draftligj e rregullon veprimtarinë e Komisionit Hetimor, përcakton strukturën organizative, përbërjen e komisionit, thirrjen e dëshmitarëve, administrimin e provave, vendimmarrjen, përcakton edhe procedurat e hetimit të konstatimit, të përshkrimit të ngjarjes e tjera. Duke e vlerësuar të një rëndësie të veçantë këtë projektligj, Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Adem Salihaj e ka kërkuar fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Dëshiroj të them që në fillim që komisioni ka punuar për një kohë shumë të gjatë në hartimin e këtij projektligji. Kemi pasur para vetes edhe përvojat e disa vendeve që kanë projektligje të tilla dhe mund të them që i kemi marrë përvojat më të mira. Shumë çështje na kanë marrë shumë kohë edhe përbërja e komisionit, edhe mënyra e inicimit të procedurave të formimit të komisionit, edhe mënyra e vendosjes, edhe mënyra e marrjes në pyetje ose intervistimi i dëshmitarëve, mënyra e sjelljes së tyre e të tjera, janë çështje shumë të ndjeshme dhe ne na kanë marrë shumë kohë, disa muaj, këto aspekte të këtij projektligji. Nuk pretendojmë që është një projektligj i përkryer dhe ndoshta ka nevojë që në debatet e më tutjeshme të jemi shumë aktiv. Është një projektligj që kap çështje të ndjeshme, kap çështje të korrupsionit, të shkeljes së ligjit, të keqpërdorimeve. Mund të ketë nisma të llojllojshme këtu në Kuvend për formimin e këtyre komisioneve dhe unë mendoj në përgjithësi do të jenë të dobishme nëse ne do ta kemi një projektligj sa më të mirë në këtë aspekt.

Shumë vende kanë ligje të tilla dhe mundohen t'i vejnë në shërbim të transparencës, të respektimit të ligjit, të luftës kundër dukurive negative, veçanërisht të korrupsionit e të tjera.

Në përgjithësi, mendoj se kemi pasur disa vështirësi, kemi gjetur disa formulime, megjithatë ka mundësi ndoshta të përsoset edhe më tutje, veçanërisht përbërja e këtyre komisioneve. Ne kemi gjetur një solucion kompromisi që komisionet të jenë të përbëra nga një përfaqësues i secilit grup parlamentar, megjithatë duhet të jemi të vetëdijshëm se pozita dominon në përbërjen e këtyre komisioneve, ndërsa është më shumë interes i opozitës që t'i formojë këto komisione dhe të hetojë çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me pozitën. Kur them opozitë dhe pozitë, aspak nuk e kam parasysh përbërjen e tashme të Kuvendit ose të Qeverisë. Kjo është një çështje afatgjate që mund të ndryshojë nesër dhe të ketë një formë krejt tjetër.

Sido që të jetë, ne si Grup Parlamentar e përkrahim, në parim, këtë Projektligj dhe konsiderojmë që do të jetë i dobishëm për shumë çështje të Parlamentit dhe të vetë institucioneve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Myfera Shinik e ka fjalën.

MÜFERA ŞINIK: Teşekkür ederim,

Sayın başkan, bakanlar, milletvekilleri,

Parlamento Denetim Yasasının getirilmesi, Kosova için özel önem taşımaktadır. Çünkü şimdiye kadar bu denetim, Yasayla belirlenmemiştir. Sadece Kosova Cumhuriyeti Meclisi Tüzüğü ile belirlenmiştir. Parlamento Denetim Yasasıyla, Parlamento Denetim Komisyonunun örgütlenme şekli, işlevselliği, strüktürü, yetkisini ve sorumluluğunu belirtmektedir.

6. maddede görüldüğü gibi bu Yasanın yürürlüğe geçebilmesi için bütçenin olması çok büyük önem taşımaktadır. Bu bütçe henüz belirlenmemiştir. Ancak Kosova Meclisi’nin belirlemesi gereken bütçenin hazırlanması için aciden çabaların sunulması gerektiğine inanmaktayız.

Öyleki 7+ Parlamenter Grubu Yasa Tasarısının ikinci okunuşunun hazırlanmasında, ilgili komisyona katkısını sunacaktır ve birinci okunuşunu da kabul ettiğimizi bildirmekteyiz.

Teşşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të SLS-së, e ka dikush fjalën? Nuk ka. Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Veç kisha kërkuar që të jeni sa më racional në kohë. Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në Kuvend, për evitimin e parregullsive dhe të problemeve, çështje ku janë të përfshirë përgjegjësitë shtetërore dhe qeveritare, shpeshherë lind nevoja për formimin e Komisionit Hetimor nga Kuvendi i Kosovës.

Rregullimi i kësaj fushëveprimtarie me ligj rritë transparencën, forcon demokracinë dhe iu ndal hovin dukurive antiligjore kudo që ato paraqiten. Prandaj, e përgëzoj Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi për hartimin e këtij projektligji.

Me këtë Projektligj rregullohet mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komisionit hetimor, si dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e tij gjatë fazës së hetimit të problemit të ngritur.

Në kreun II, dispozitat themelore, përkrahur procedurat për ngritjen e komisionit parlamentar, i cili themelohet me qëllim të konstatimit të problemit, përkrahur të

rrjedhës së ngjarjeve me qëllim të qartësimit të asaj se çfarë ka ndodhur dhe përcaktimit të përgjegjësisë së atyre që kanë qenë të involvuar në problemin e ngritur.

Në kreun IV të Projektligjit, neni 13, - të drejtat dhe detyrat e komisionit, Komisioni ka të drejtë të urdhërojë sjelljen e detyrueshme të bartësit të funksioneve si dhe personat fizikë dhe juridikë të dëgjohen para komisionit.

Me këtë rast, propozoj që të shtohet një nen apo paragraf se cili është mekanizmi veprues që e detyron bartësin e funksionit t'i përgjegjëset ftesës së komisionit, kur dihet që shpesh në komisionet funksionale na dështon rendi i ditës në mungesë të ardhjes së përfaqësuesit të institucioneve.

Neni 14, punën e komisionit e ndanë në tri faza: faza e hetimeve, faza e vlerësimit të hetimit dhe përgatitja e raportit final.

Me këtë rast propozoj që të shtohet edhe një neni që e definon se cili është rrugëtimi i mëtutjeshëm i raportit final pas shqyrtimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, apo mbetet në sirtarët e Kuvendit, siç na ka ndodhur më parë.

Edhe pse Projektligji për t'u zbatuar ka kosto bukur të madhe buxhetore, e përkrah, në parim, se vendos rregull dhe ngritë kontrollin parlamentar. Projektligji është i qartë dhe i mirë dhe në harmoni me standardet bashkëkohore. Mbesë me shpresë se në rrugëtimin e mëtutjeshëm të draftimit në komisionet funksionale projektligji do të bëhet më funksional dhe më i lehtë për t'u zbatuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe për kohën!
Radha është për deputeten Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Ju përsëndes të gjithëve!

Mendoj se ky Projektligj për hetime parlamentare ka një rëndësi shumë të madhe dhe më vjen mirë që është në procedim. Së pari, fuqizon rolin e Parlamentit të Kosovës si kontrollues i punës dhe efektivitetit të Qeverisë. E dyta, është një element i rëndësishëm në përpjekjet tona për të kompletuar legjislacionin në luftën kundër korrupsionit dhe keqpërdorimeve tjera.

Mirëpo, atë që desha të them në kuadër të ligjit, është që duhet theksi të bie në atë që komisioni të ketë një balancë të fuqisë midis pozitës dhe opozitës, sepse fundja ka nevojë gjithmonë të vendoset një sistem ku për këto situata, opozita pra të jetë e barabartë, jo e mbizotëruar, po flas për afatgjatë, sepse pushtetet ndërrohen. Dhe, po ashtu, dua edhe një propozim ta jap që deputetët që do të jenë në këtë komision, sigurisht do të ballafaqohen edhe me çështje të sigurisë dhe ndoshta është mirë të mendohen mekanizma të cilat i vihen në mbrojtje deputetëve në raste të caktuara. Dhe, në fund, zoti kryetar, dua t'ju pyes, çka po ndodh me Ligjin për deputetë, sepse pasi s'po kemi pyetje parlamentare për juve, desha t'ju pyes. Faleminderit!

KRYETARI: Pyeteni Komisionin, komisioni ta bëjë gati, pastaj vjen në Parlament.
Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Deputetë të nderuar,

Projektligji për hetimin parlamentar është një kontribut shumë i rëndësishëm për kompletimin e kornizës ligjore të punës së Kuvendit të Kosovës, sidomos në ushtrimin e funksionit të tij – mbikëqyrjen parlamentare të Qeverisë. Për më shumë, ashtu siç është propozuar Projektligji, është edhe një hap më tej për afrimit të praktikave të mira parlamentare të parlamenteve me demokraci të avancuar. Prandaj, unë e përgëzoj Komisionin për Gjyqësi, por besoj se e kanë pasur edhe një bazë të mirë me qenë se ky projektligj edhe në mandatin e kaluar, në vitin 2007 ka kaluar në leximin e parë, por për shkak se nuk ka pasur kohë të kalojë në leximin e dytë, do të thotë, ka mbetur aty.

Përvoja modeste në mandatin e kaluar lidhur me komisionet hetimore ka treguar se ka pasur një vështirësi të madhe në organizimin dhe funksionimin e komisionit me qenë se nuk ka ekzistua baza ligjore. Një vështirësi tjetër ka qenë sidomos sjellja e personave me funksione të larta.

Projektligji në përgjithësi është i hartuar mirë dhe përfshin procedurat duke filluar nga faza e themelimit komisionit deri në prezantimin e raportit përfundimtar të komisionit para Kuvendit.

Projektligji është preciz në përshkrimin e detyrave të Komisionit Parlamentar Hetimor dhe të detyrave të organeve tjera të Kuvendit lidhur me funksionimin e këtij komisioni.

Unë më tej do të përqendrohem në parimet e këtij projektligji.

Dispozitat e përgjithshme përkufizojnë parimet kryesore mbi të cilat funksionon Komisioni Hetimor. Është me rëndësi që precizohet se komisioni parlamentar mund të ngrihet vetëm për një çështje me interes publik. Kjo është me rëndësi se në këtë mënyrë evitohet mundësia e ngritjes së komisionit për një qëllim të vetëm për të diskredituar personat publikë, prandaj edhe ofrohet hapësira për zbardhjen e rasteve që janë në interes të qytetarëve të Kosovës.

Parimi themelor në këtë projektligj, të cilën e konsideroj shtyllë të komisionit, por edhe të vetë projektligjit, është e drejta e grupit opozitar ose e grupit minoritar që të ngritë çështjen e formimit të komisionit. Kjo e drejtë konsiderohet si një nga të drejtat më të rëndësishme të opozitës.

Nga ana tjetër, gjithashtu është arritur parimi i shumicës, që do të thotë se komisioni reflekton fuqinë e përfaqësuar në Kuvend, që është parimore në praktikën parlamentare. Kufizimi që pozita të ketë vetëm një anëtar më shumë në komision se sa opozita, është një zgjidhje politikisht e avancuar.

Në këtë projektligj në disa dispozita përcaktohet parimi i ndarjes së pushteteve, gjë që unë e përshëndes. Pra, Kuvendi nuk guxon të shndërrohet në një vend ku vendoset për përgjegjësitë penale të personave. Hetimi parlamentar fokusohet në zbardhjen e rasteve, pra zbardhet përgjegjësia politike e personave, por janë organet tjera që eventualisht vendosin për persona me përgjegjësi dhe jo komisioni.

Raporti mbi të gjeturat sipas projektligjit i dorëzohet Kuvendit, i cili mund të iniciojë procedura tjera, natyrisht jo të natyrës penale. Qasje në atë raport do të kenë edhe organet tjera publike.

Projektligji përend gjithashtu dispozitat e Kodit të procedurës penale, që janë të aplikueshme në mënyrë analoge në procedurat e thirrjes së dëshmitarëve dhe të marrjes në pyetje të dëshmitarëve.

Në fund, përshëndes faktin se në projektligj janë futur edhe mekanizmat detyrues për bashkëpunim me komisionin, që ka qenë mangësi në mandatin e kaluar. Pra, Qeveria, organet tjera publike dhe qytetari duhet t'i përgjigjen ftesës së komisionit për të dhënë dëshmi. Ata vetëm në raste të kufizuara kanë të drejtë të refuzojnë dëshminë, atëherë kur e ngarkojnë veten ose një anëtar të ngushtë të familjes për një vepër penale. Kjo është e drejtë fundamentale e individit dhe është e drejtë e mbrojtur me konventa ndërkombëtare që reflekton në Projektligj. Përndryshe, është e rëndësishme se projektligji parasheh edhe konsekuenca juridike për persona që nuk i përgjigjen ftesës, e njëjta gjë ndodh edhe me organet ekzekutive.

Sa i përket një vërejtjeje specifike, unë e kam një vërejtje lidhur me konsistencën e projektligjit, gjegjësisht me dy nene të cilat bie në kundërshtim dhe këto janë neni 7.3 dhe neni 8.3, sepse në nenin 7.3 theksohet se në qoftë se grupet parlamentare nuk i dërgojnë emrat e përfaqësuesve të vet për anëtarë të komisionit, atëherë Kryesia e Kuvendit do të propozojë përbërjen e nominimeve vetëm nga grupet parlamentare të cilat kanë propozuar, por jo edhe pozitat tjera që nuk janë propozuar. Me këtë, në një mënyrë jo vetëm që s'mund të formohet komisioni, por vihet në pyetje puna e komisionit.

Kurse nga ana tjetër, në pikën 8.3 theksohet se çdo grup parlamentar i Kuvendit duhet të përfaqësohet në komision me së paku një anëtarë. Do të thotë, këto dy dispozita duhet të korrigjohen.

Sa i përket kostos buxhetore, besoj se Kuvendi i Kosovës mund ta përballojë. Prandaj, në parim e mbështes këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjala është për deputetin Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Unë vetëm dëshiroj të theksoj disa çështje thelbësore për ligjin në projekt. Nën një, them se deri tash në Kosovë nuk ka pasur një përvojë as legjislative, me ndonjë përjashtim, as praktika të tilla hetimore dhe duke u nisur nga kjo, duke u nisur në anën tjetër nga fakti që hetimi parlamentar është një prej mekanizmave më të rëndësishëm për të shtuar rolin e Kuvendit të Kosovës në mbikëqyrjen, kontrollimin, hetimin e punës që bëjnë të gjitha institucionet me rëndësi publike në Kosovë, atëherë duke pasur parasysh këto dy fakte, vlerësoj se Kuvendi i Kosovës dhe Komisioni për Legjislacion po bën një punë të mirë që e ka sjellë këtë projektligj, e ka hartuar dhe e ka sjellë këtë projektligj në miratim në Kuvendin e Kosovës.

Çështja e dytë që dëshiroj të theksoj është natyra e perceptimit të ligjit, të një ligji, do të thotë, për Komisionin Hetimor Parlamentar dhe do të theksohet se ky hetim nuk është hetim penal, qysh mund të ketë perceptime, por është një hetim i punës së institucioneve publike, duke filluar nga Qeveria e Kosovës dhe gjithë mekanizmave tjerë publikë.

Hetohet, do të thotë, puna në të mirë të publikut, sa është realizuar dhe si realizohet. Përbërja e Komisionit Hetues Parlamentar është bërë një zgjedhje e mirë dhe duke qenë se edhe vetë kam qenë në grupin punues, kemi pasur debate të gjera për të gjetur formulën se si të funksionojë ky komision dhe në çfarë përbërje të jetë ky komision. Mendoj se është gjetur formula e mirë dhe kjo formulë nuk është përjashtuese në raport me partitë politike dhe me grupet politike në Kuvendin e Kosovës e njëkohësisht nuk është as paragjyquese. Ju e shihni te neni që rregullon formimin e komisionit dhe udhëheqjen e tij. Do të thotë, është një formulë që i ngërthen në vete të gjitha forcat politike brenda Kuvendit, por pa paragjykuar as atë që kërkon hetim parlamentar dhe as atë për të cilin kërkohet hetim parlamentar. Është një formulë e mirë që mendoj duhet të kalojë kështu siç është.

Kjo formulë e ka edhe një aspekt tjetër që ka të bëjë me perceptimin e ligjit. Do të thotë, formula e përbërjes së komisionit dhe e udhëheqjes së komisionit është një garanci se Komisioni Hetimor Parlamentar nuk është po ashtu as hetim politik. Kjo zakonisht ndodh, kjo ndodh edhe në vendet tjera në parlamente tjera, do të thotë gjithmonë iniciohen komisione hetimore nga një herë me motivacione të hakmarrjeve politike. Formula për formimin e këtij komisioni e pamundëson pak a shumë, e pamundëson formimin e komisioneve të tilla në Kuvendin e Kosovës për qerim hesapsh politike, do të thotë. Por, kjo mund të funksionojë, kjo mund të funksionojë kështu nëse vërtet Kuvendi i Kosovës do të jetë gjithmonë në përkrahje të cilitdo komision hetimor që formohet në Kuvendin e Kosovës, jo vetëm formalisht, por edhe substancialisht dhe politikisht qëndrojnë mbrapa çdo komisioni hetimor, në mënyrë që të pamundësohet prej fillimit e deri në fund formimi i këtyre komisioneve dhe përdorimi i këtij ligji për qëllime thjeshtë propagandistike ose për qëllime politike.

Po përfundoj diskutimin tim duke theksuar se ky është një prej ligjeve më të mira që rregullon një prej çështjeve, një prej mekanizmave më të rëndësishëm të Kuvendit të Kosovës dhe e ftoj Kuvendin e Kosovës që të mos lejojë asnjëherë që ky ligj të përdoret për qëllime jashtë ligjit që është përcaktuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është për deputetin Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar ministra, Bajrami, Mujota, Jagcilar, zonja Kelmendi,

Deputetë të respektuar,

Disa vërejtje në parim. Tek neni 4, paragrafi 1, konsideroj që do të duhej të inkludojë edhe grupi kuvendor, që të kishte autorizim, jo vetëm 6 deputetë apo jo sepse, fundi i fundit, grupi kuvendor është një formë e organizimit që ka më shumë ingerenca, pra kush mundet më shumë, mundet edhe më pak, ama edhe grupi, apo grupi edhe 6 deputetë të jetë alternativë e dytë.

Më pastaj, te 4.3, ku thuhet: “në rastet kur kërkesa për themelimin e komisionit parashtrohet nga 1/3”, nga së pakut, se nëse kështu, nëse do ta bënim interpretimin çfarë do të duhej e do të duhej ta bënim ashtu siç do të duhej, atëherë do të delte se do të duhej cikër më cikër 1/3, se nuk do të bënte më tepër as më pak, së paku apo jo. Kjo është një shprehje se gjithkund përdoret edhe në gjuhë të tjera.

Te 4.5, komisioni nuk mund të themelohet gjatë muajve të fundit të një mandati të Kuvendit. Por çfarë do të bënim ne, do të thotë, për hir të një formulimi të këtillë, nëse do të ndodhte një skandal i cili do të ishte, po e zëmë, me përmasa shqetësuese. Unë konsideroj që deri në ditën e fundit Kuvendi duhet të funksionojë pa marrë parasysh se i skadon mandati nesër apo jo. Prandaj, kjo është një dispozitë pak a shumë për diskutim.

Edhe te neni 5, paragrafi 1: “Kuvendi vendos për pushimin e punës së komisionit para përfundimit të mandatit të tij vetëm me kërkesën e propozuesve”. Me këtë po i jepet një autorizim propozuesit, që propozuesi mund të disponojë me kërkesën e vet, bie fjala ka propozuar, kjo nuk do të mund të ishte të mbetej kjo dispozitë, sepse këtu do të mund të ndodhin pa fije të dyshimit presionet të natyrave të ndryshme dhe propozuesi që e ka iniciua çështjen, ama Kuvendi e ka miratuar me shumicë apo jo. Prandaj, Kuvendi është diçka më tepër se sa edhe propozuesi. Nuk do të ishte mirë t’ia lëmë propozuesit autorizimin për disponim me këtë komision. Po e zëmë, u formua komisioni, punoi komisioni, bëri punë të mirë shumë serioze dhe tash del propozuesi, thotë, e tërheq. Nuk do të ishte zgjidhje e mirë.

Do të duhej të kishim edhe dispozita ndëshkimore, se mirë, çfarë po e zëmë komisioni kërkon, edhe u përgjigjet. Nuk përgjigjet funksionari publik apo përfaqësuesi ligjor i një organizate, nuk përgjigjet por e zhargitë çështjen. Duhet të ketë komisioni, të jetë i veshur me autorizime, ju lutem, ose së paku të thirremi në dispozitat e Ligjit për procedurën penale.

Dhe, përfundimisht, kam kënaqësi që ta përgëzoj punën e Komisionit për Legjislacion për këtë dokument që, nuk ka diskutim, ky është i nevojshëm edhe do të duhej të miratohej, natyrisht do të miratohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjala është për deputeten Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, Kryetar i Kuvendit!

Qeveritarë, deputetë të nderuar,

Projektligji hetimor parlamentar paraqet një hallkë të rëndësishme dhe mekanizëm në relacionin parlament dhe organe qeveritare. Kjo çështje është cekur edhe në Raportin e progresit evropian, ku është thënë se Parlamenti duhet të reagojë më fuqishëm ndaj organeve qeveritare dhe t’i kontrollojë në mënyrë më të fuqishme dhe më të drejtë.

Unë mora fjalën t’i paraqes dy çështje të rëndësishme në këtë projektligj. Projektligji hetimor parlamentar është i strukturuar mirë, i rëndësishëm dhe në dy çështje që do të përqendrohëm janë neni 13.2, ku thuhet ekspertiza e ekspertëve nuk e ka të vlerësuar se sa mjete financiare nevojiten për këtë ekspertizë që do të thotë që grupi që do ta punojë më tej këtë projektligj do ta përcaktojë se sa kushton kjo dhe sa do të ketë implikime buxhetore ekspertiza e ekspertëve që do të marrin pjesë në Komisionin Hetimor Parlamentar. Dhe, çështja tjetër, unë e kam këtu një tabelë që e ka paraqitur komisioni dhe e përgëzoj komisionin që e ka paraqitur këtë tabelë, mirëpo këtu janë cekur disa të dhëna parciale, sepse në këtë projektligj nuk paraqiten ndikimet e plota, të drejta transparente buxhetore, por është një tabelë ku është përcaktuar në kompensimet e anëtarëve të Komisionit Hetimor Parlamentar - mallra dhe shërbime.

Unë do të propozoja që kjo të ishte 50%-shi i komisioneve funksionale e të mos jetë 100%-shi, siç është paraqitur këtu në këtë tabelë. Është e rëndësishme që Komisioni më tej ta shqyrtojë këtë çështje dhe ta rregullojë në punën e mëtejme të komisionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete! Armend Zemaj e ka fjalë.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë, së pari dëshiroj që asnjëherë të mos kemi nevojë për përdorimin e këtij ligji. Mendoj që duhet edhe në të ardhmen dhe gjithmonë të kemi institucione të pastra dhe mos të kemi shumë probleme dhe nevojë për formimin e komisioneve hetimore parlamentare.

Është e vërtetë që edhe si grup punues kemi punuar përafërsisht për një vit, pa marrë parasysh që kemi trashëguar një material nga e kaluara, por këtu duhet të falënderojë veçanërisht NDI-në publikisht, sepse ka dhënë një kontribut shumë të madh së bashku me të gjithë anëtarët e tjerë të komisionit. Edhe në çështjen që për herë të parë, ndoshta, në këtë viti Kuvendi apo ne deputetët kemi bërë, po paraqesim një ligj dhe, e dyta, është që nga ne që kërkohet një monitorim më i madh ndaj institucioneve të Qeverisë nga komisionet parlamentare.

Te çështja e numrit të deputetëve, e tha kolegu Bajram Kosumi, se ndoshta këtu ka nevojë të shpjegohet edhe perceptimi. Nuk mundën më pak se 6 deputetë të nisin formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar dhe 1/3 është e harmonizuar, po ju them, me Kushtetutë. Këtu nuk ka nevojë të kemi dilema a duhet të jetë më shumë ose më pak, këto janë disa gjëra që nuk janë të shpikura nga komisioni dhe nuk është gjetur, nuk ka qenë konsensus që është dashur të bëhet, por janë thirr në Kushtetutë dhe, ajo çka është më e rëndësishmja, e tha dikush të dispozitat ndëshkimore, thirrja e dëshmitarëve. Ne e kemi Kodin e procedurës penale dhe në bazë të asaj strikt jemi munduar që t'i harmonizojmë. Kjo është sa për shpjegim. Te kostoja financiare, mendoj që për këso gjërash nuk mund të pyesim se sa është kostoja financiare dhe nuk kemi nevojë, sepse jemi deputetë dhe ato shumica janë edhe shpenzimet e përllogaritura edhe si mandat. Prandaj, edhe si komision funksional që do të kemi, mendoj që nuk do të kemi, nuk patëm ndonjë vërejtje konkrete, vetëm disa interpretime për të cilat i falënderojmë, edhe pse disa jo shumë të arsyeshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministria Nekibe Kelmendi e ka kërkuar fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMNEDI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Ndoshta do të jem e vetmja që do të kundërshtoj që të ekzistojë një ligj i tillë i veçantë për themelimin e komisionit parlamentar, por meqë çdo kush ka të drejtë të shpreh mendimin e vet, edhe unë shpreh mendimin tim dhe ky është mendimi im personal.

Mendoj se komisioni parlamentar duhet të përfshihet në Rregulloren për Punën e Kuvendit të Kosovës e jo me ligj të veçantë, siç është ky ligj, sepse të gjitha procedurat dhe i gjithë fushëveprimi dhe mandati e përgjegjësitë që i ka ky komision, sipas këtij projektligji, duhet të përfshihen në Rregulloren për Punën e Kuvendit të Kosovës. Fundja, Kuvendi i Kosovës punon në bazë të Kushtetutës dhe të Rregullores së Punës

së Kuvendit të Kosovës. Por, nëse ky mendim i imi do të mbetet i vetmuar, atëherë më lejoni që t'i bëjë disa vërejtje konkrete lidhur me disa nene që i ka ky draftligj.

Neni 2.3, fjalia e fundit, thotë: “Komisioni dhe përcaktimit të përgjegjësisë së atyre që kanë qenë të involvuar”. Së pari, për të caktuar përgjegjësinë e dikujt, janë organet gjegjëse që i përcaktojnë përgjegjësitë e personave që janë të involvuar në veprimet e ndryshme kundërligjore. Sado që këtu thjeshtësohet dhe thuhet: “probleme” komisioni me nenin 2.2 themelohet për t'i hetuar probleme, çështje ku janë drejtpërsëdrejti, jo problemeve dhe çështjeve. Ne kemi korrupsion, ne kemi edhe shkelje të ligjit edhe nga ana e deputetëve jashtë Kuvendit e tjera, e tjera. Prandaj, nuk duhet të thjeshtësohet dhe të quhet çështje, por të quhen me emër të vërtetë, pra të përcaktohet se cilat çështje mund të hetohen nga ky komision.

Komisioni më pastaj thotë: “përcakton përgjegjësinë”. A nuk është kjo cenim i pavarësisë së gjyqësorit, sepse përgjegjësinë e caktojnë vetëm organet gjyqësore, aq më tepër meqë ky neni 2.3 është në kundërshtim me nenin 2.6, sepse thotë: “Komisioni përgatit raportin përfundimtar lidhur me hetimet brenda afatit të caktuar nga Kuvendi dhe në pajtim me ligjin”, do me thënë, aty thotë - cakton përgjegjësitë, e nga ana tjetër thotë - harton, përgatit raportin përfundimtar.

Nga ana tjetër, ne kemi mjaft agjencione, edhe Agjencionin Antikorrupsion, agjencione të tjera të auditimit dhe të tjera që merren me hetimet edhe të qeveritarëve edhe të deputetëve, përkatësisht të organeve të Kuvendit të Kosovës e tjera, kështu që ma merr mendja se nëse ekziston një ligj i veçantë, mos po i duplikojmë edhe kompetencat e organeve edhe të agjencioneve të ndryshme dhe mos po interferojmë edhe në pavarësinë e tyre, mos po e cenojmë pavarësinë e tyre.

Më pastaj, unë propozoj që në nenin 8, në të cilin bëhet fjalë për përbërjen e komisionit, për përbërjen e komisionit të shtohet edhe një fjali, ku do të thuhet se: “kryetari i komisionit do të jetë nga radhët e opozitës”, ju lutem, sepse shpesh kryetari i komisionit ka të drejtën e votës së dyfishtë, përkatësisht vota e tij llogaritet si votë e dyfishtë.

Më pastaj, neni 13, pika (f) parasheh sjelljen me dhunë apo urdhëron sjelljen me dhunë të personave, sjelljen e detyrueshme të personave nga pika (a) dhe (b). Kush është ai organ tjetër, pos organeve gjyqësore, që mund të japë urdhrin për sjelljen me dhunë të ndonjë personi para komisionit parlamentar. Vetëm organet e ndjekjes mund të lëshojnë urdhra të këtilla e jo edhe komisionet parlamentare, kështu që janë përzier pak a shumë çështjet që bien në fushëveprimin dhe në kompetencat e gjyqësorit e të prokurorive me këtë draftligj. Kodi penal dhe Kodi i procedurës penale janë dy kode bazike, në bazë të të cilave punojnë organet e hetuesisë, do me thënë prokuroria, policia edhe gjyqësori dhe mos po kemi këtu përzierje tash në mes punës së prokurorive, gjyqësorit edhe të policisë dhe komisionit parlamentar. Komisioni, si i tillë, mund të përfshihet me Rregulloren për Punën e Kuvendit qoftë si komision ad-hoc, qoftë si komision i përhershëm. Kështu, siç është paraparë, ma merr mendja se nuk do të shpërbej shumë dhe do të keqpërdoret ndaj shumë individëve, ndaj të cilëve dikush ka apo nuk ka simpati. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Njomza Emini e ka fjalën.

NJOMZA EMINI: Ju faleminderit, Kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Së pari, desha të përgëzoj Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi për këtë projektligj që ka qenë më se i nevojshëm tani, duke e ditur që Kuvendi i Republikës së Kosovës punon në bazë të Rregullores së saj dhe kuptohet që për mbarëvajtjen dhe organizimin e punëve në Kuvend, nevojitet edhe Komisioni për Hetim Parlamentar. Duke e ditur që në çdo vend demokratik puna dhe efikasiteti varet edhe nga mbikëqyrja, unë nuk do ta quaj këtë komision hetimor, do të thotë të kontrollojë çdo deputetë se çka dhe so po vepron në kuadër të Kuvendit, por më së miri do të duhej që ata deputetët, të cilët nuk janë të përgjegjshëm dhe nuk janë efikas në punën e tyre, të ketë edhe masa ndëshkuese, por kuptohet që janë organet kompetente që merren me përfaqësues, por do të doja që mos të vijmë deri tek masat ndëshkuese, sepse çdo deputet e di rolin dhe përgjegjësitë që i ka marrë nga qytetarët e Kosovës.

Edhe një herë, ky projektligj është i rëndësishëm dhe, sa e lexova, ishte çdo gjë, do të thotë ashtu si do të duhej të ishte një projektligj për hetim parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, po shfrytëzoje racionalisht kohën.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Do të jem shumë i shkurtër. Unë u paraqita, pikërisht për dy çështje desha të diskutoj këtu. Zonja ministre, nuk je vetëm në mendimin që e shfaqët. Unë t'ju them të drejtën u befasova kur e pash ligjin që ka ardhur në procedim. Unë e ndaj mendimin se ky ligj duhet, pjesët e këtij ligji duhet të inkorporohen në Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe nuk ka nevojë të kemi një ligj të posaçëm. Mirëpo, pasi që po e shoh se disponimi i shumicës është që ligji të aprovohet, unë do të votoj për ligjin. Kjo është e para.

E dyta, u krijua përshtypja se ky ligj po bëhet për kontrollin e Qeverisë, mirëpo nuk duhet të harrojmë se si deputetë në Kuvendin e Kosovës kemi për detyrë vetëm të shikojmë ligjshmërinë e funksionimit të institucioneve të cilat i kemi themeluar. Kemi tri degë të pushtetit, kemi legjislativin dhe Qeverinë. Do të thotë, ne me këtë ligj kemi vetëm një detyrë që t'i shikojmë a respektohen ligjet, të gjitha ato ligje që ne i aprovojmë këtu. Kurrfarë detyre tjetër nuk kemi. Ne nuk mund të marrim këtu kurrfarë roli të hetimeve në kuptimin ato që i bënë gjyqësori. Do të thotë, ligji ka për qëllim të kontrollojë gjyqësorin, të kontrollojë Qeverinë, t'i kontrollojë agjencionet që i kemi krijuar dhe të gjitha ato organe që ushtrojnë pushtet në Kosovë, se këtu është krijuar përshtypja që Qeverinë, Qeverinë, Qeverinë. Kemi edhe gjyqësorin, kemi edhe agjencione të pavarura dhe kemi ndërmarrje publike e të gjitha këto me radhë. Mirëpo, mendoj se ky ligj duhet të inkorporohet në Rregulloren e Kuvendit, kurse vërejtjet këtu, në përgjithësi, 90% e vërejtjeve që i dhanë deputetët të gjithë me radhë, ishin shumë përmbajtjesore dhe ishin me vend.

Unë, megjithatë po ju them, disponimi qenka që të bëhet ky ligj, unë do të votoj, por e ndaj mendimin që më mirë do të ishte të inkorporohet në Rregulloren e Punës së Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ministri dhe deputeti Arsim Bajrami e ka kërkuar fjalën.

MINSITRI ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, i nderuari Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë,

Fillimisht dëshiroj të uroj komisionin për një punë shumë të mirë që e ka bërë dhe për faktin që po krijon bazë ligjore për funksionimin e një mekanizmit shumë të rëndësishëm, që është edhe mekanizëm kushtetues, sepse edhe Kushtetuta ka përcaktuar që përpos mjeteve të rregullta, ka edhe mjete të përkohshme apo ad-hoc. Mjeti më i fuqishëm i tillë është hetimi parlamentar. Hetimi parlamentar është një praktikë parlamentare e shumë parlamenteve, është kategori ligjore. Është jashtëzakonisht e rëndësishme për këtë parlament që kjo çështje të rregullohet me ligj, në mënyrë që t'i kemi rregulluar e qarta të ushtrimit dhe të realizimit të këtij funksioni shumë të rëndësishëm të parlamentit, sepse parlamenti, përpos funksionit zgjedhor legjislativ, e ka edhe mbikëqyrjen dhe mbikëqyrja nuk është vetëm mbikëqyrje ndaj ekzekutivit, por është një mbikëqyrje e plotë parlamentare që përfshin një spektër shumë më të gjerë të hetimit parlamentar se sa kontrolli parlamentar i Qeverisë dhe është shumë e rëndësishme që ne po marrim praktikën evropiane, sepse në shumicën e shteteve evropiane praktikën e hetimit parlamentar janë praktika shumë të zhvilluara, ndërkohë që ne në përvojën dhjetëvjeçare kemi pasur tri-katër raste të tilla dhe me siguri që miratimi i këtij projektligji do të afirmojë këtë instrument shumë të rëndësishëm të Parlamentit për të bërë hetime parlamentare.

Unë do t'i jap tri sugjerime parimore për komisionin, por më vonë do të jap edhe një kontribut personal në përgatitjen e disa amendamenteve. Ajo që është më e rëndësishme në hyrje të këtij ligji, është të definohet qartë çka është hetimi parlamentar. Duhet në mënyrë të qartë, ligji ta ketë të qartë se çka është hetimi parlamentar, në mënyrë që ky hetim mos të përzihet me hetime të tjera, siç e tha edhe kolegja Kelmendi, mos të përzihet me hetimet tjera që janë nën juridiksionin e pushtetit të tretë, pushtetit gjyqësor. Hetimi parlamentar është një aktivitet i rregullt i parlamentit për të hetuar një çështje që është brenda juridiksionit të parlamentit, jo për të ndërhyrë në punën e gjyqësorit, është çështje e organit tjetër pastaj, pas përfundimit të tij dhe të paraqitjes së raportit se a do të merret me atë hetim dhe a janë plotësuar konditat ligjore që ajo çështje të procedohet edhe në instancat tjera.

Unë po angazhohem për një çështje tjetër, çështjen e përcaktimit të qartë të objektit të hetimit parlamentar. Nuk është hetimi parlamentar vetëm i Qeverisë, është shumë më gjerë, është hetimi edhe i vet parlamentit. Mund të ketë edhe brenda Parlamentit ndonjë çështje kontestuese, e cila i delegohet këtij komisioni që ta shqyrtojë. Prandaj, Parlamenti emëron edhe shumë institucione tjera publike që kanë statusin e institucioneve të pavarura, por ato mund të hetohen nga një segment pa ndërhyrë në punën e tyre të rregullt, kështu që fillimisht kisha kërkuar prej komisionit që të bëjë përpjekje, edhe pse është bërë një punë e madhe, që të definojë në mënyrë më precize dhe më konkrete çka mund të jetë objekt i një hetimi parlamentar.

Unë e di se komisioni ka përdorur një formulë elastike dhe është ndoshta mirë që mos ta bëjë të ngurtë hetimin parlamentar, por për t'i shmangur ndoshta edhe paqartësitë, është mirë që të bëhet përpjekje që të definohen 5-6 çështje që mund të jenë objekt i hetimit parlamentar. Po e zëmë, një çështje që ka të bëjë me Qeverinë, një çështje që ka të bëjë me çështje tjera dhe ato të renditen dhe çështja e tretë është juridiksioni. Duhet të kemi shumë kujdesë të juridiksioni i këtij hetimi parlamentar. Ky juridiksion duhet të jetë vetëm në shërbim të përgatitjes së një raporti për një hetim të autorizuar nga vetë Parlamenti dhe assesi ky juridiksion mos të ketë pretendime më tepër. Për këtë arsye,

unë kisha kërkuar që të forcohen rregullat e punës së komisionit, është një parim i konfidencës. Komisioni do të komprometohet në qoftë se nuk e mbron konfidencën, në qoftë se për një hetim parlamentar jep vlerësime preliminare para se ato të përfshihen në raportin përfundimtar. Për ta mbrojtur këtë instrument dhe për ta bërë një instrument shumë të fuqishëm parlamentit, atëherë ne duhet të sigurohemi që ky komision do të respektojë rregullat, rregullat që kërkojnë për punën e paanshme, neutrale dhe punën e cila do ta mbrojë edhe nga depolitizimi i mundshëm. Nuk e kuptoj këtë si një mjet kryesisht opozitar. Ndoshta në demokracitë parlamentare që nuk kanë shumë përvojë, kjo merret si mjet opozitar. Unë e marr si një mjet të parlamentit, të kontrollit parlamentar për të hetuar çështjet për realizimin më efikas të funksionit kushtetues të parlamentit.

Nuk është në funksion kushtetues i parlamentit vetëm ligjvënja, por është edhe kontrolli parlamentar që është shumë më i gjerë se sa që është kontrolli parlamentar i Qeverisë. Unë po rezervohem me kaq, me premtimin që do të jap një kontribut personal në komision me disa propozime për amendamente. Ju faleminderit!

KRYETARI: Eqrem Kryeziu e ka kërkuar fjalën.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Më lejoni si zakonisht të përshëndes ministrat këtu të pranishëm, natyrisht edhe kolegët, koleget e dashura!

Unë do të shprehja opinionin tim të fuqishëm në favor të këtij projektligji. Në fakt, e konsideroj si mekanizmin më të madh për një demokraci në vend.

Në qoftë se do të hynte kjo në Rregulloren të Kuvendit, do të thotë do të minimizohej fuqia e këtij edhe nuk do të ishte ligj, prandaj edhe hetimet parlamentare do të ishin në një kuadër shumë më marginal.

Për ata që kanë skepsa në lidhje me rëndësinë jashtëzakonisht të madhe të Ligjit për hetimin parlamentar, dua t'ua përkujtoj periudhën e Makartit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk ka mundur të denoncohet ndryshe ajo tendencë totalitare në demokracinë më të madhe në botë, përpos në Parlamentin e vendit përkatës, kështu që, kushdo që kishte përgjegjësinë politike dhe morale dhe përfaqësuese të hetojë fenomenet shqetësuese të prokurorisë, për shembull ose të gjyqësisë, ose tjerave, vetëm, pra, në qoftë se shndërrohen në fenomene shqetësuese, atëherë vetëm Komisioni Parlamentar do të ishte në gjendje të flasë për ato fenomene. Në qoftë se ne bëhemi krejt, do të thotë, do objekte të dëgjueshme për procedurat e prokurorisë ose të gjyqësisë, mund të shkojmë në qorrsoak, në qoftë se nuk do të ishte një kërcënim pozitiv engjëllor, do të kisha thënë, i hetimit parlamentar. Kështu që e përshëndes fuqimisht dhe jam jashtëzakonisht i lumtur e do të shkoj shumë i lumtur në shtëpi në qoftë se jam shëndosh, në qoftë se e miraton këtë procedurë për miratimin e këtij ligji Parlamenti sot. Faleminderit shumë, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit shumë, deputet!

Kisha kërkuar që deputeti dhe sponsoruesi, përkatësisht kryetari i Komisionit sponsorues i Ligjit, Bahri Hyseni, të na kursej edhe në kohë edhe në fjalë.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, Kryetar i Kuvendit! Gjithsesi do t'ju kursej, sepse një pjesë të asaj që pata ta sqaroj e sqaroi shumë mirë ministri Arsim Bajrami, mirëpo rreth çështjes se a duhet apo nuk duhet të ekzistojë ligji unë mendoj të gjitha parlamentet më

demokratike në botë fuqinë kryesore në Parlament e bëjnë përmes komisioneve hetimore parlamentare, bile kemi hasur në vende të cilat vetëm brenda një mandati kanë ngritur diku mbi 60 komisione hetimore parlamentare.

Dhe, çështja tjetër që duhet kuptuar drejt, hetimi parlamentar nuk bëhet për ta nxjerrë dikë për përgjegjësi penale. Ta dallojmë, hetimi parlamentar ngritët për një interes të përgjithshëm publik, qoftë për një neglizhencë të institucioneve, për ndonjë keqpërdorim eventual, për ndonjë mos menaxhim, apo për ndonjë çështje të caktuar, prandaj, ta kuptojmë që nuk është çështja që Komisioni hetimor parlamentar ngritët dikë ta qesë para fajësisë për përgjegjësi penale, sepse nuk e ka atë autoritet.

Unë para se gjithash i falënderoj të gjitha grupet parlamentare dhe deputetët të cilët kanë ndihmuar dhe po e përkrahin Ligjin për hetim parlamentar dhe sidomos edhe zotin Ardian Gjini që e ka ngritur një çështje në nenin 7.5, ku ka të drejtë, ku kemi kërkuar konsensus nga Kryesia. Pra, është mirë që në të ardhmen ta amendamentojmë nenin përkatës, sepse është e pamundur ndoshta nganjëherë të kërkohej konsensus, kurse do t'i jap disa sqarime rreth asaj se kush e udhëheq. Nuk e di a është lexuar mirë projektligji, sepse në projektligj kemi përcaktuar që kryetari apo kryesuesi i Komisionit hetimor parlamentar do të jetë nga opozita.

Çështje tjetër me interes është ndoshta edhe çështja për çka duhet ngritur komisionet hetimore parlamentare. Këtu kemi pasur dëgjim publik, kemi ftuar edhe ekspertë që kanë ardhur nga parlamentet evropiane demokratike se kur duhet ta ngritin komisionin hetimor parlamentar dhe përcaktimi i përgjithshëm ka qenë që komisionet hetimore parlamentare të ngritën vetëm kur ka interes të veçantë publik, interes të përgjithshëm publik për një çështje të caktuar dhe të mos bëhet pre që Kuvendi i Kosovës për gjithçka të ngre komisione hetimore. Prandaj, këtu është e rëndësishme pse duhet të ekzistojë ligji dhe kur mund të ngritët një komision hetimor parlamentar.

Vlen të përmendet vetëm edhe një sqarim që e dha deputeti Armend Zemaj, sepse disa kërkonin që grupet parlamentare të jenë, vetvetiu 6 deputetë nënkupton grupin parlamentar, kurse 1/3 është e përcaktuar me Kushtetutë edhe kur nënshkruajnë 1/3 e deputetëve, atëherë Kuvendi domosdo duhet të marrë vendim për formimin e Komisionit hetimor parlamentar.

Duke u falënderuar për përkrahjen dhe për rekomandimet që dhanë të gjithë deputetët ne do të jemi të gatshëm që gjatë leximit të dytë, gjatë amendamentimit, t'i marrim të gjitha sugjerimet dhe i falënderojmë ata të cilët do të rekomandojnë edhe me amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Në sallë kemi 64 deputetë. Po hyjmë në proces të votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 62 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për hetimin parlamentar.

Në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional;
- Komisioni për Buxhet dhe Financa;

- Komisioni për Komunitete dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandimet.

Dhe, vazhdojmë me pikën e pestë:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet me rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve. Pasi të procedojmë për votim, votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni për raportuesin e Komisionit që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime, nëse e do fjalën.

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar në leximin e dytë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për konfliktin e interesit. Gjatë shqyrtimit me qëllim që Projektligjin ta finalizojmë dhe me qëllim të....

KRYETARI: Një moment, deputet! Kërkoj nga deputetët, që hymë menjëherë në procedurën e votimit dhe të kthehen në sallë. Vazhdo, deputet Hyseni.

BAHRI HYSENI: Me qëllim që nenet përkatëse të Projektligjit, meqë kemi të bëjmë me ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjit, të rregullojnë në mënyrë më decizive apo të normojnë disa çështje të caktuara, Komisioni ka intervenuar në nenet 1, 2, 7 dhe 9, pika 10.3 dhe 10.4 dhe nenin 6, Komisioni ka kërkuar me vendim unanim që të hiqen nga Projektligji, nga propozimi që ka ardhur nga sponsorizuesi dhe krejt qëllimi ka qenë i Komisionit që të dalë me një normim sa më të saktë për Projektligjin në fjalë. Qëllimi i projektligjit ka qenë me qëllim që deri më tash është konstatuar se projektligji në fjalë që ka ekzistuar në disa çështje të caktuara nuk e ka rregulluar mirë çështjen e konfliktit të interesit. Konsiderojmë që pas amendamenteve që janë bërë në Komisionin për Legjislacion dhe në komisionet e tjera, tani e kemi një situatë krejtësisht të qartë sa i përket konfliktit të interesit dhe kërkoj nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që sot t'i miratojnë amendamentet, sepse janë me interes dhe do të qartësojnë projektligjin në fjalë. Mirëpo, për deputetët dhe për komisionet parlamentare kërkoj që me rastin e amendamentimit në nenin 17 ka qenë një ndryshim teknik nga Zyra për Standardizim dhe ne nuk e kemi paraparë si komision që të hartojmë amendament, sepse ka qenë vetëm çështje teknike. Pra, kërkojmë nga deputetët që të mos bien në dilemë, sepse ka qenë një çështje teknike dhe nuk e kemi parë të arsyeshme të bëjmë amendament për çështje teknike dhe kemi lënë që Zyra për Standardizim ta rregullojë, domethënë, vetëm ta

rregullojë çështjen jo përmbajtjesore, por çështjen teknike të nenit 17, pika....
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hyjmë në procedurën e votimit.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Në sallë janë 66 deputetë.

Me 61 vota “për”, 5 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 1.

Në radhë është amendamenti 2.

Urdhëroni, kush e dëshiron fjalën? Urdhëro, Ibrahim Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, Kryetar!

Te pika 25 amendamenti 2, ku thuhet shtohet pika 25 me përmbajtje të gjithë anëtarët e bordeve të emëruara nga Kuvendi ose nga Qeveria, ndoshta do të duhej të ishin edhe të gjithë anëtarët e bordeve të emëruara edhe nga kuvendet komunale, sepse edhe ne... edhe komuna emëron borde dhe natyrisht edhe aty ka konflikt të interesit.

KRYETARI: Propozues, a jeni dakord me këtë propozim?

BAHRI HYSENI: Nuk prish punë të jenë edhe bordet komunale, mirëpo nuk e di se çfarë borde formon komuna? Tash me Ligjin e ri për vetëqeverisjen lokale nuk e di a do ta kenë mundësinë për t’i formuar këto borde, sepse nuk është ndonjë pengesë, mund të jetë.

KRYETARI: Po, për ndërmarrjen publike banesore komuna ka formuar bord dhe unë mendoj se duhet të jetë.

BAHRI HYSENI: Mirë, në rregull, mund të jetë.

KRYETARI: Do të thotë, amendamentin 2 e qesim me plotësimin që e dha deputeti Ibrahim Makolli. A jeni dakord? Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

(Ndërhyrje nga deputeti)

Urdhëroni! Deputeti Gani Koci, por kërkoje me kohë fjalën, burrë.

GANI KOCI: Meqë kam pasur punë shumë me borde dhe agjenci të pavarura, sinqerisht do të duhej pasur parasysh se kemi anëtarë të bordeve që në momentin e zgjedhjes së tyre ata krijojnë marrëdhënie pune dhe anëtarë bordi që me përzgjedhjen e tyre nuk krijojnë marrëdhënie pune. Dhe, po të futen këto dy kategori në një kategori, mendoj se është e padrejtë dhe do të duhej për t’u qartësuar mirë. Kemi borde që krijohet marrëdhënia e punës dhe borde që nuk krijon marrëdhënie pune.

KRYETARI: Fjalën e ka Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Duke marrë parasysh atë që e thotë zoti Koci, ato që krijojnë marrëdhënie pune hyjnë në kuadër të shërbyesve civilë dhe shkojnë me konkurs. Të jemi

të qartë, ndërsa, emërimet kur bëhen, qoftë nga kuvendi komunal, qoftë nga Kuvendi i Kosovës, janë si emërimet politike që në fakt është konflikt interesi në qoftë se marrim. Domethënë e përkrah plotësisht atë që e tha zoti Makolli, andaj nuk ka kurrfarë dileme, sepse disa ndërmarrje janë komunale, nuk janë publike, regjionale, komunale, andaj kuvendet komunale i çojnë anëtarët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Konstatohet se me 54 vota “për”, 6 abstenime Kuvendi miratoi edhe amendamentin numër 2, me vërejtjen e Ibrahim Makollit.

Amendamenti numër 3.
Urdhëro, Naim!

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit! Unë desha ta propozoj një ndryshim në Ligjin, meqenëse jemi te amendamentimet që të përfshihet edhe një nen, që është neni 13, që ndalon ushtrimin e veprimtarive tjera nga ato zyrtare. Duke pasur parasysh se edhe ju në Kryesi kur e keni shqyrtuar një kërkesë që unë e kam drejtuar te ju, kisha propozuar që të fshihet ky nen, meqenëse nuk respektohet pse të mbetet aty dhe të shkaktojë hezitim në komentim të ligjit, është shumë i qartë, por nuk po respektohet. Meqenëse s’po respektohet duhet fshirë, që mos ta qesë në siklet as Agjencinë Kosovare Antikorrupsion, të mos e qesim në siklet as zyrtarin, që të fshihet ky nen komplet. Me fjalë të tjera, propozoj që neni 13 – ushtrimi i veprimtarive tjera nga zyrtari, pika 2, që gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik zyrtari mund ta ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe të veprimtarisë humanitare. Ta heqim, e heqim edhe ashtu Kosova, gjendja e saj ekonomike e ka arritur pikën e punësimit të plotë dhe ne mund të aplikojmë në punë si të gjithë tjerët dhe qasje e barabartë për të gjithë të tjerët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ti për kërkesën që e ke bërë merr përgjigjen në pikën 10 të rendit të ditës. Vazhdojmë me votimin. Votojmë për amendamentin 3. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, Kuvendi miraton amendamentin 3.

Në radhë është amendamenti 4.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miraton amendamentin numër 4.

Në radhë është amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër” miratohet amendamenti 5.

Në radhë është amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime Kuvendi miratoi amendamentin 6.

Dhe, e votojmë Ligjin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Faleminderit!

Pikat tjera i vazhdojmë pas një pushimi, deri në orën 14:30 e bëjmë një pauzë për drekë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën. Në sallë janë 40 deputetë dhe mund ta fillojmë seancën.

Pika e radhës është:

- Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, në pajtim me Rregullën nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores për Shërbimin Civil, ia ka paraqitur Kuvendit raportin vjetor për vitin 2008.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008 dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008 dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, deputeti Hajredin Hyseni e ka fjalën.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media ka shqyrtuar raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe pas shqyrtimit të parë i ka kërkuar që të bëhen plotësimet e këtij raporti dhe Këshilli ka sjell raportin e plotësuar, ku Komisioni me 15 shtator 2009 ka shqyrtuar këtë raport dhe ka vlerësuar se raporti është një raport i mirë dhe i plotëson kriteret e nevojshme të një raporti. Ai shumë qartë na jep një pasqyrë të gjendjes së shërbyesve civilë në Kosovë dhe vështirësive dhe pengesave që kanë ata. Këshilli ka bërë një punë të madhe në bazë të kompetencave që ia jep ligji duke shqyrtuar ankesat, duke përcjell procedurat dhe respektimin e tyre të zgjedhjeve menaxheriale dhe mund të themi se puna e këtij Këshilli ka dhënë rezultate duke mbrojtur respektimin e rregullave dhe parimeve për shërbyesit civilë, andaj komisioni ka përkrahur raportin duke kërkuar që të miratohet ai në seancë plenare.

KRYETARI: Faleminderit! Është radha e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, a e do dikush fjalën?

Hydajet Hyseni e ka fjalën

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka mirëpritur raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për vitin 2008 dhe e konsideron këtë si një prurje të re e të rëndësishme në procesin e kompletimit institucional, të funksionalizimit dhe transformimit të administratës publike dhe Shërbimit Civil në Kosovë. Është kjo hera e parë që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës i raporton Kuvendit të Kosovës dhe ky fakt shpjegon edhe në një masë justifikon vonesën e paraqitjes dhe shqyrtimit të këtij raporti. Ka ndikuar në këtë vonesë edhe kërkesa e komisioneve përkatëse parlamentare për informacion plotësues, si në pjesën funksionale, ashtu edhe në atë buxhetore financiare të raportit, gjë që në mënyrën e vet edhe dëshmon përgjegjësinë e shtuar e dioptrinë e mprehur profesionale gjatë shqyrtimit në komisione që ka sjell si rezultat plotësim dhe përmirësim të raportit. Mendoj se kjo qasje dhe ky përkushtim i komisioneve duhet përshëndetur dhe duhet shfrytëzuar si shembull i mirë, si për funksionimin e komisioneve parlamentare, ashtu edhe për funksionimin e institucioneve të pavarura dhe ndërtimin e një marrëdhënie adekuate midis tyre dhe organet që i ka zgjedhur nga një anë dhe nga ana tjetër relacionin midis nevojës së funksionimit të organeve të pavarura në mënyrë të pavarur dhe pa përzjerje politike dhe domosdosë së respektimit të ligjshmërisë llogaridhënies dhe kontrollit shoqëror demokratike edhe nga institucionet e pavarura. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës po paraqet raportin e punës së tij në kohën kur po përfundon procesi i rizgjedhjes dhe kompletimit të tij, gjë që është konstatuar edhe në raportin e progresit si sukses dhe dëshmi e funksionalizimit të tij duke theksuar edhe faktin se Këshilli, citoj: Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës ka zgjidhur 166 ankesa, që, do të thotë, mbi 50% e numrit të përgjithshëm të ankesave të punonjësve të administratës krahas vlerësimeve tjera pozitive për, citoj: përfundimin e rishikimit funksional të detyrave dhe përgjegjësi brenda administratës publike si dhe, citoj prapë: implementimin e shumicës së rekomandimeve të bëra, për çka mendoj do përgëzuar Qeveria dhe Ministria e Administratës Publike.

Edhe përkundër këtij fakti gjithsesi trimërues raporti i prezantuar mëton të jetë real dhe objektiv, duke konstatuar krahas sukseseve dhe mangësitë, vështirësitë dhe sfidat me të cilat përballlet. Është mirë që theksohet fakti se gjysma e ankesave kanë mbetur të pashqyrtuara, por lypset të shkohet më tej dhe të gjenden mënyra që kjo dukuri të tejkalohet dhe të mos përsëritet në të ardhmen. Janë gjithsesi të rëndësishme edhe shifrat dhe përqindjet, por jo më pak e rëndësishme shfaqet cilësia e zgjidhjeve të rasteve. Duhet shqyrtuar dhe marrë seriozisht ankesat për fenomenin e zgjidhjeve të ndryshme dhe me kute të ndryshme edhe kur është fjala për raste të ngjashme. Bie në sy për të mirë fakti se në strukturën etnike të ankimesve numri i ankimesve të komuniteteve pakicë është më i vogël se përqindja në përbërjen e popullsisë, siç bie në sy për të keq fakti se numri i madh i ankesave u janë adresuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Legjislativi dhe Qeveria e Kosovës kanë proceduar draftimin dhe miratimin e legjislacionit të nevojshëm për funksionalizimin e mëtejshëm të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës në pajtim edhe me rekomandimet e raportit të progresit, por problem në vete, problem akut dhe i përhapur gjithandej mbetet moszbatimi i vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Është obligim i Kuvendit që në bashkëpunim me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe me partnerët e interesuar të shtojnë mbikëqyrjen parlamentare edhe karshi obligimeve për jetësimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, obligim ky që del edhe nga Raporti i progresit i Komisionit Evropian.

Duhet vlerësuar pozitivisht edhe bashkëngjitja e raportit të Këshillit të Pavarur edhe e raportit të shpenzimeve financiare nga i cili edhe mund të shihen vështirësitë me të cilat përballlet edhe ky institucion i pavarur, por bie në sy edhe fenomeni që haset shpesh në pasqyrat buxhetore gjithandej me shifra të rrumbullakuara edhe për shpenzimet të cilat zor se mund të kenë çmime aq të rrumbullakuara, siç janë fjala- shpenzimet kapitale 5.000 euro, shpenzimet për mobile zyrash 20.000 euro, kurse për furnizim në zyra 400, 500, 1.000 euro. Thonë nuk mjafton vetëm të mos bësh keq, por edhe të mos lësh vend që të kuptohesh keq. Marrë në përgjithësi raporti dëshmon progres dhe mundëson progres të mëtejshëm dhe si të tillë Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah dhe angazhohet për vazhdimin dhe pasurimin e komunikimit dhe bashkëpunimit adekuat institucional midis Kuvendit të Kosovës dhe trupave të tij me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe me institucionet tjera të pavarura në funksion të realizimit të synimeve të përbashkëta. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputetja Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Mendoj që është një raport i mirë, Raporti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në radhë të parë për faktin se gjatë asaj periudhe kohore ky këshill nuk ka qenë krejt i konsoliduar për shkak të procedurave të cilat është dashur të zhvillohen në Kuvendin e Kosovës pasi që tashmë ky Këshill edhe është një institucion i cili i përgjigjet dhe zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës. Unë mendoj që ky këshill është përballur me disa çështje jo të lehta për t'i zgjidhur dhe ndër to do të përmendja në radhë të parë ndërprerjen e kontratës që është numri më i madh pra i rasteve të paraqitura, është mos vazhdimi i kontratës dhe po ashtu punësimet pa konkurs që ka disa informata se janë bërë në institucionet e Kosovës punësime jo të vogla, numër jo i vogël pa paraqitje të konkursit. Unë mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë sqarim nga Qeveria e Kosovës, sepse ne e dimë që deklaratat të cilat i ka dhënë Qeveria thonë që Qeveria nuk ka larguar asnjë shërbyes civil, asnjë të punësuar në shërbimin civil nga puna. Dhe, dua të jap sqarim çka do të thotë ndërprerja e kontratës së punës, çka do të thotë mos vazhdimi i kontratave të punës të shërbyesve civilë, që krejt bëjnë 173 raste. Dhe, do të jap sqarim po ashtu a janë plotësuar këto vende të punës, për faktin se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka dhënë një arsyetim politik, i cili nuk i takon, sepse nuk është organ që bën vlerësime politike ku është shprehur se ndërprerja e këtyre kontratave ndoshta është bërë në mungesë të mjeteve buxhetore për realizimin e rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të cilët kanë qenë për zvogëlimin e numrit të punonjësve në Shërbimin Civil.

Një çështje e rëndësishme që duhet të potencohet këtu mendoj se është zbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, pasi që ky tashmë është një organ që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, unë mendoj që Kuvendi i Kosovës duhet t'i obligojë institucionet në zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës që të kemi një shërbim civil i cili funksionon mbi baza ligjore. Dhe, një tjetër që kam vërejtur në punën e këtij këshilli ka të bëjë me daljen jashtë kompetencave në disa raste dhe në veçanti dalja jashtë kompetencave e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës kur është fjala për sekretarë permanentë të ministrive, në rastin konkret sekretarin permanent të Ministrisë së Drejtësisë, për faktin se kompetencat e këtij Këshilli nuk lidhen dhe nuk kanë të bëjnë me nivelet e zyrtarëve më të lartë në shërbimin civil, siç janë sekretarët permanentë dhe

kryeshefat e agjencive. Prandaj, nuk është mirë që ky këshill në të ardhmen të merren me këto çështje të cilat nuk hyjnë në kuadër të kompetencave të tij.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah këtë raport, natyrisht me këto vërejtje të paraqitura. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ne i kemi disa vërejtje në raportin, jo si të tillë, mirëpo pika e parë është se po përsëritet çështja e kuantitativizimit, kur na jepen shifra për çështje të ndryshme, por nuk ka shpjegime reale, kualitative për atë që ka vërejtur Këshilli. Nëse ne marrim vetëm shifra për ankesa qysh i kemi marrë këtu dhe i shihni me shpjegime të shkurtra, mund të themi se nuk është, nuk po flasim për Këshill të Pavarur Mbikëqyrës, por Këshill të Pavarur që i mbledh ankesat e shërbyesve civilë, në këtë rast. Ne mendojmë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës nuk guxon që të shndërrohet në këshill i cili veç pret se kush po ankohet dhe jep kualifikim. Sido qoftë edhe vetëm ankesat nëse shqyrtohen, ne mund të shohim se ka elemente serioze, domethënë, të pakënaqësisë, ka elemente serioze edhe të shkeljeve. Si do qoftë, në bazë të këtij raporti që e kemi marrë ne nuk mund të konkludojmë shumë. Ne më tepër mund të konkludojmë prej elementeve të cilat i dimë para se ta marrim këtë raport se sa që na jep material raporti për të konkluduar. Dhe, përfundimisht mendojmë se Kuvendit të Kosovës nuk bën t'i serviren kësi dokumentesh në të cilat ne duhet bërë hulumtim për të marrë vesh se çka ka thënë një institucion të cilin ne e kemi themeluar vetë. Nëse cilido prej nesh këtu në Kuvendin e Kosovës dëshiron të dijë diçka për atë që është thënë në dokument duhet bërë hulumtim. Tani a mendojnë deputetët e Kuvendit të Kosovës se kështu duhet ne të veprojmë, kur një institucion që është themeluar në bazë të ligjit na sjell një dokument këtu, duhet të na sjell dokumentin e plotë që ne të mund ta lexojmë edhe të konkludojmë e jo të bëjmë hetime. Duke pasur parasysh se është hera e parë që po flasim në këtë aspekt për këtë dokument, ne nuk do të dalim kundër, por do të abstenojmë për shkak se mendojmë se kjo formë e shqyrtimit të dokumentit nuk i shërben qëllimit bazë për çka dokumenti sillet në Kuvend dhe për çka ekziston Këshilli si i tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Raporti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës është i vonuar, por megjithatë thuhet më mirë vonë se sa hiq. Ky raport dëshmon më së miri për gjendjen jo të mirë të shërbyesve civilë në Kosovë të cilët i nënshtrohen vullnetit të eprorëve të tyre dhe jo vullnetit të ligjit dhe fuqisë së ligjit. Sikurse dihet vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga organet punëdhënëse në Shërbimin civil të Kosovës duke pasur parasysh se ato janë vendime administrative të formës së prerë dhe ndaj tyre nuk lejohet ankesë. Megjithëse ligji e përcakton se mosekzekutimi i tyre nga zyrtarët përgjegjës është cenim i të drejtave nga marrëdhënia e punës, megjithatë në praktikë një numër i madh i vendimeve të këtij organi nuk janë ekzekutuar që paraqet shkelje të ligjeve në fuqi. Mosekzekutimi i vendimeve të KPMK-së e vë në pah edhe një herë pafuqinë e ligjit në raport me zyrtarët për të cilët vendimet e

tilla ja në të pavlerë. Shërbyesit civilë tash e sa kohë edhe përkundër vendimeve pozitive të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nuk po arrijnë të realizojnë të drejtën e tyre dhe prandaj e vë në dilemë edhe nevojën e ekzistimit të një organi të tillë për derisa vendimet e tij edhe pse të detyrueshme nuk ekzekutohen. Thjesht ky Këshill kësisoj do të shndërrohet në një këshill të vajtimit. Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione i janë drejtuar me dhjetëra shërbyes civilë të cilët edhe pse nga KPMK u është kthyer e drejta, ata nuk kanë arritur të realizojnë atë për shkak të refuzimit nga ana e zyrtarëve përgjegjës dhe të njëjtit nuk kanë arritur t'i realizojnë të drejtat e tyre. Kjo flet më së miri për gjendjen e përgjithshme të mosrespektimit të ligjeve në fuqi. Shërbyesit civilë e kanë humbur besimin në mundësinë që ka ky autoritet.

Grupi Parlamentar e përkrah raportin në fjalë i cili është shqetësues dhe kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të detyruar autoritetet që të ekzekutojnë vendimet e KPMK-s. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Në fakt për t'i mos përsëritur ato çka i thanë kolegët paraprak, është një fakt që duhet të potencohet edhe me këtë rast dhe shprehet, ndoshta duhet ta kuptojmë edhe si drojën e lartë të këtij Këshilli në pamundësinë për t'i reflektuar përgjegjësitë e veta që i adresohen, jo vetëm me dokumentin që e rregullon këtë organ, mirëpo edhe me aktin më të lartë juridik- Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pra, në bazë të nenit 101, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili përcakton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbyesit civilë dhe në fakt në bazë të pasqyrës së këtij raporti na del të kuptojmë se kemi të bëjmë me një organ, i cili ka pengesa serioze në implementimin apo ekzekutimin e vendimeve. Derisa si përqindje del se 26.8% të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk janë implementuar nga institucionet e vendit, atëherë jep një porosi jo të mirë për funksionimin e sistemit në Republikën e Kosovës. Kur flas kështu atëherë kemi të bëjmë me një organ i cili do të duhej që në asnjë mënyrë të mos neglizhohet apo në asnjë mënyrë të mos kuptohet ndryshe për vetë faktin se dokumentet që rregullojnë dhe vendimet që i merr ky organ janë të formës së prerë dhe ndaj këtyre vendimeve nuk parashihet asnjë lloj ankese. Prandaj kujtoj se në qoftë se vazhdohet me këtë ritëm çfarë dhe mos implementimin e këtyre vendimeve atëherë dalëngadalë do të shndërrohet në një institucion i cili më shumë do të jetë i natyrës thuajse si sot që ekziston Avokati i Popullit. Prandaj konsideroj që këtu duhet të merret si vërejtje serioze zbatimi i vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës që institucioni më i lartë i Republikës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës duhet ta ketë në konsideratë se cili do të jetë vendimi apo çka do të bëhet më tutje. Në përgjithësi konsideroj se kemi të bëjmë me një raport i cili në mënyrë reale pasqyron realitetin që ekziston dhe si i tillë, pavarësisht vërejtjeve që dikush mund t'i ketë mund të përkrahet në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar ” 7+” Shpresa Murati e ka fjalën.

ŠPRESA MURATI: Hvala Predsedniče!
Pozdrav svima!

Komisija za javne službe je nakon prvog razmatranja godišnjeg izveštaja Nezavisnog nadzornog odbora Kosova, na sednici na kojoj su bili pozvani i predstavnici ovog odbora, nakon sadržajne diskusije donela zaključak da od Nezavisnog nadzornog odbora zatraži dodatna objašnjenja koja treba ugraditi u taj izveštaj. Dodatna objašnjenja su se prvenstveno odnosila na slučajeve kršenja uslova konkursa ili primanja na posao bez konkursa. Nakon razmatranja izveštaja sa dopunama, Komisija je podržala ovaj izveštaj.

Osnovna funkcija ovog odbora je razmatranje prigovora, razmatranje prigovora odnosno žalbi javnih službenika da nadgleda izbor direktora ili rukovodioca departmana, kao i da nadlegda sprovođenje Zakona o javnoj službi po institucijama. Nezavisni nadzorni odbor obezbeđuje poštovanje pravila i principa koji regulišu javnu službu u cilju stvaranja jedne nepristrasne i profesionalne javne službe. Iz izveštaja se vidi da je najviše žalbi podnešeno protiv opština, zatim protiv ministarstava i izvršnih agencija. Žalbe su različite prirode od prekida ugovora o radu, osporavanju konkursa, neprodužavanje ugovora o radu, degradacija sa pozicije, suspenzije sa posla i tako dalje. Ono na šta treba obraditi pažnju jeste sprovođenje odluka Nezavisnog nadzornog odbora od strane institucija koja krše prava radnika i treba iznaći mehanizam za efikasnije sprovođenje odluka ovog odbora. U zakonodavnoj strategiji za 2009. godinu nalazi se nacrt zakona o Nezavisnom nadzornom odboru koji će biti od velikog značaja za efikasnije i bolje funkcionisanje ovog odbora.

Parlamentarna grupa „7+“ podržava ovaj prvi izveštaj jer smatramo da su tokom 2008. godilne odradili značajan posao i ako odbor nije bio u punom sastavu, jedno duže vreme je funkcinisao sa 3 člana a trebalo je da ih bude 7 i s obzirom na poteškoće i smetnje sa kojima su se suočavali u toku rada, kao što su nedostatak prostorija za rad, s jedne strane, i veliki broj žalbenih predmeta, sa druge strane. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, a e do dikush fjalën? Nuk ka. Tani është radha e deputetëve, por unë jam i obliguar të them se në kësi raste do të duhej të ishte gjithpërfshirëse dhe e pranueshme për grupin deklarata e shefave të grupeve parlamentare, megjithatë po fillojmë me deputetët. Deputetja Sanije Aliaj e ka fjalën.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Këshili i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës është njësi e mëvetësishme që i raporton drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës përmes raportit vjetor. Ky këshill veprimtarinë e vet e mbështet në nenin 101.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Rregulloren 2008/12, ka 3 funksione: shqyrtimin e ankesave, vendosjen dhe vlerësimin në pajtim me nenin 13 të Rregullores. Në vitin 2008 përmes Sekretariatit për vendosje në Këshillin Mbikëqyrës kanë arritur 387 ankesa të parashtruara nga shërbyesit civilë dhe aplikantët për shërbyes civilë. Në bazë të të dhënave të prezentuara në këtë raport numri i ankesave ka qenë i natyrave të ndryshme, por bengos fakti se prin masa më e rëndë ajo e ndërprerjes së kontratës së punës në 112 raste, kontestim i konkursit në 99 raste dhe zhdëmtim material në 43 raste. Këto ankesa në shikim të parë, lënë për të kuptuar një varg parregullsish që kanë të bëjnë drejtpërdret me korrupsionin, familjarizimin dhe punësimin me orientim partiak, por me këtë rast vlen për t'u theksuar se pse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e pasqyron në raport numrin e 81 vëzhgimeve të zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve dhe në nivele të tyre, por nuk e prezanton numrin e vizitave

të bëra- në ministri për ta vërtetuar sa ankesa kanë në bazë ligjore për shkeljen e të drejtës në punë, ashtu siç ka prezantuar pasqyrën e vizitave të bërë kuvendeve komunale. Në raport është paraqitur se Ministria e Drejtësisë është ministria kundër së cilës janë ushtruar më së shumti ankesa në Këshillin Mbikëqyrës të Kosovës, gjithsej 32 ankesa, por nuk përmendet fare fakti sa ankesa kanë bazë ligjore dhe se kjo ministri sa i ka zbatuar të gjitha vendimet që kanë arritur në Ministrinë e Drejtësisë nga ky organ? Përmes komisioneve të Këshillit janë zgjidhur 227 ankesa ose 58% të rasteve të arritura për vitin 2008. Por, me këtë rast vlen për t'u theksuar se pse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës nuk i ka zgjidhur ankesat në afatet ligjore dhe në hap me kohën, gjë që i mundëson edhe më tutje institucioneve qendrore dhe lokale të Kosovës të mos e respektojnë ligjin duke ua shkelur qytetarëve të drejtën e punës që njëkohësisht është edhe e drejtë për të jetuar denjësisht. Për qytetarët e Kosovës, por edhe për deputetët e Kuvendit publikisht është e ditur se autoritetet publike punëdhënëse paraprakisht e pranojnë kuadrin e konkursin e shpallur sa për sy e faqe sa për ta plotësuar kriterin ligjor. Me këtë rast do të potencoj se derisa Këshilli Mbikëqyrës është kompetent për t'i shqyrtuar ankesat cili mekanizëm do ta ndalë hovin e pranimeve paraprakisht pa konkurs në institucionet publike, pra këtu vjen në të ardhmen në shprehje zbatimi i Ligjit që pak më parë, pra Ligjit për hetim parlamentar. Në raport pasqyrohen të dhënat se në vitin 2007 janë zgjidhur 386 ankesa, kurse në vitin 2008- 227 ankesa, gjë që nuk jepet asnjë arsytim se pse ka rënë trendi i punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Nëse nuk ka mbështetje të duhur financiare kërkoj që Këshilli të mbështetet financiarisht, sepse konsideroj se evitohen shumë parregullsi në institucionet e Kosovës dhe rritin përgjegjësinë dhe transparencën nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës. Në raport paraqitet se vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë të obligueshme për t'u zbatuar nga institucionet, por të dhënat e prezantuara e dëshmojnë të kundërtën, se nga 93 vendime të rekomanduara janë zbatuar vetëm 25 ose në përqindje 26.8 të rasteve. Kjo lë për të kuptuar mosnjohjen ndërinstitucionale dhe mosrespektim të ligjit. Këtë raport e përkrah me një dëshirë që Këshilli në të ardhmen të jetë më funksional në zgjidhjen e rasteve të caktuara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është për deputetin Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Raporti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është një raport i mirë për shkakun se shumë ankesa të punëtorëve që punojnë në institucionet e Kosovës janë zgjidhur, kanë mbetur edhe disa, por shumica e tyre janë zgjidhur. Unë dua të ndalem në të dhënat e raportit dhe implementimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës në raport thotë se komuna e Gjilanit zë vendin e parë për nga ankesat të cilat i kanë bërë punëtorët e Kuvendit Komunal apo punëtorët që punojnë në Gjilan dhe numri i tyre arrin në 34. Mandej, vjen Prishtina dhe fill pas Prishtinës, me 24 ankesa vjen komuna e Skenderajt, një komunë e cila është e barabartë me ankesa me komunat e tjera që kanë shumëfish më shumë banorë se komuna e Skenderajt. Me këtë dua të them se raporti është i mirë dhe ka raportuar ashtu se si është gjendja në terren. Komunitat që udhëhiqen nga koalicioni qeveritar kanë numrin më të madh të ankesave se komunitat që nuk udhëhiqen nga koalicioni qeveritar. Ta zëmë është problem implementimi i vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, unë dua të përmend vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për kthimin në punë të punëtorëve në komunën e Vitisë, në vitin 2009 dhe përkundër vendimit që është marrë dhe nuk kanë drejtë ankese askush në atë vendim, kryetari i Komunës së Vitisë e thyen vendimin e Këshillit të Pavarur

Mbikëqyrës dhe nuk pranon në punë punëtorët që janë kthyer në punë, të cilët janë larguar pa të drejtë duke u shkelur ligji. Gjithashtu, punëtorët ankohen në gjykatë. Kur punëtorët ankohen në gjykatë, gjykata merr vendim në të mirë të punëtorëve dhe prapë kryetari i komunës së Vitisë nuk respekton vendimin e Gjykatës dhe nuk lejon kthimin në punë të punëtorëve në komunën e Vitisë. Dhe, prapë gjykata merr vendim për zbatimin e vendimit të vet me dhunë apo me forcë dhe me forcën e policisë kthen në punë në Viti punëtorët të cilët komuna e Vitisë i ka larguar nga puna pa të drejtë për shkak të implikimeve politike që ka pasur vetë kryetari. Dhe, në komunën e Vitisë është bërë një kaos në komunë ku s'është ditur se a është kryetari polic a polici është kryetar dhe kjo që ndodh me mos implementimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës jep për të kuptuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës nuk e ka forcën e implementimit apo kryetari i komunës, në njërën prej komunave cilëndo qoftë ajo mund të merr një vendim të ri tjetër dhe prapë ta thyej vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, që është në kundërshtim me ligjin. Ne duhet të ndryshojmë diçka në ligj që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës kur të marrë vendim për kthimin në punë të punëtorëve që u është cenuar e drejta e punës duhet të implementohet pa shkuar në gjykatë. Ka edhe shumë vendime tjera që presin në gjykatë, unë po flas prapë për komunën e Vitisë se kam informacione pak më shumë që disa lëndë nuk kanë dashur gjyqtarët t'i marrin në dorë para zgjedhjeve, sepse nuk kanë dashur të krijojnë kaos për implementimin e vendimeve. Prandaj, unë kërkoj nga Kuvendi i Kosovës që vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i raporton vetëm Kuvendit dhe askujt tjetër, duhet të jenë të bazuara dhe asnjë prej tyre mos ta cenojë të drejtën e punëtorëve që të kthehet në vendin e punës dhe baza ekonomike apo rroga e tyre t'u jepet nga koha kur ata janë larguar pa të drejtë nga puna.

Prandaj unë besoj dhe mendoj se qytetarët e Kosovës duhet të gjitha ankesat e tyre t'ua drejtojnë Këshillit të Pavarur mbikëqyrës, sepse është një Këshill i cili me të vërtetë duhet të ishte i pavarur dhe është deri diku i pavarur, që ankesa të tyre që kanë të bëjnë edhe me ministritë, do të thotë ministritë e koalicionit qeveritar, sepse për shkaqe politike një numër i madh i punëtorëve janë larguar nga puna dhe ne e dimë se diskriminimi për shkaqe politike nuk duhet të ndodhë në Kosovë. Në bazë të gjitha këtyre që thashë qytetarët e Kosovës në verdiktin e vet të datës 15 e kanë thënë fjalën e tyre se ata që nuk janë pajtuar me qeverisjen e Kosovës dhe kanë thënë se Qeveria e Kosovës mund të dridhet pas 15-it apo nuk e ka gjatë, kanë marrë vota më tepër, prandaj ne duhet ta shohim këtë verdikt të popullit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Raporti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës vërtet si raport i plotëson të gjitha konditat e parapara, edhe pse është mendim i disa kolegëve me të drejtë që aspekti cilësor i të raportuarit dhe adresimi i çështjeve që ky këshill në të ardhmen ta kryejë punën e vet konform ligjit dhe mandatit që e ka dhe besimin që e ka fituar nga ky Kuvend- qëndrojnë. Në përgjithësi, raporti pasqyron gjendjen jo të mirë në administratën publike të Kosovës, me implikimet politike, pastaj me ndërprerjen e kontratave të punës dhe jep statistika konkrete që trendi i politizimit të administratës publike, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror, thjesht është një trend i cili nuk po mund ta lirojë as qeverinë lokale po as qeverinë qendrore. Mirëpo, në kuptimin më pozitiv ne si Kuvend i Republikës së

Kosovës duhet t'u dalim në mbështetje anëtarëve të këtij Këshilli të cilët përkundër vonesave në marrjen e mandatit në kompletimin që ende nuk është i kompletuar ky Këshill, megjithatë duhet të inkurajojmë se e kanë bërë një punë të mirë dhe këtë e dëshmojnë edhe me statistika, andaj si fjala e fundit që e mbrojnë të drejtën e shërbyesit civilë, ky Këshill me vendimet e veta të cilat në mbase diku mbi 25% të rasteve nuk po merren parasysh, nuk po ekzekutohen, po injorohen dhe pasi nuk ka shkallë tjetër ankese, ne do të duhej si Kuvend të shikojmë në mënyrë cilësore, konkrete, praktike dhe pragmatike të amendojmë ligjin në fjalë në mënyrë që vendimet e këtij organi shumë të rëndësishëm të pavarur që në njëfarë forme përkujdeset për një administratë publike të paanshme profesionale dhe pa ndikime politike, të ekzekutohen dhe të respektohen nga vetë njerëzit e institucioneve. Rasti konkret, me disa kryetarë të komunave, nuk dua të lëshohem në disa statistika dhe në emërtime të tjera apo në ministri të caktuara, për shembull kemi rastet e ministrave që do të duhej të respektonin më së shumti ligjin dhe drejtësinë dhe ta vlerësonin rolin e këtij Këshilli të Pavarur Mbikëqyrës, kemi numrin më të madh të njerëzve që iu ka ndërprerë kontrata e punës. Zoti ministër i Administratës Publike, ky raport është një indikator i mirë, mbase edhe një udhërrëfyes që do t'ju ndihmonte juve tani në një reformë cilësore dhe të përgjithshme të administratës publike në Kosovë, që në njëfarë forme do ta ndihmonte edhe vendin edhe administratën në nivel lokal dhe në nivel qendror po edhe pjesëtarët e administratës në organet e pavarura dhe agjencitë e pavarura që i japin llogari këtij Kuvendi që vërtet në raportet e ardhshme të progresit të Komisionit Evropian të ketë një pasqyrë tjetër shumë më të mirë, shumë më të avancuar dhe shumë më moderne për administratën publike në Kosovë. Andaj, do të sugjeroja që si Kuvend vërtet ta marrim seriozisht dhe pa retorika politike dhe pa politizime të panevojshme ta gjejmë një modus të caktuar që ky Këshill i Pavarur Mbikëqyrës dhe ndryshimet apo plotësimet e mundshme në këtë ligj vërtet ta bëjnë një organ të pavarur dhe që do të respektohet nga të gjitha institucionet e vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është për deputeten Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, pra raporti i vitit 2008, ka një rëndësi të madhe duke marrë parasysh se është në fund të fundit edhe përgjegjësi kushtetuese, por edhe përgjegjësi e caktuar sipas ligjeve dhe rregulloreve për shërbimin civil. Pritjet e mia kanë qenë lidhur me këtë raport se do të ketë jo vetëm dhënie e informatave të caktuara, të cilat gjithashtu i konsideroj të rëndësishme, por sidomos edhe të konkluzioneve dhe rekomandimeve meqenëse edhe ligji e parasheh ashtu. Këshilli, pra sipas ligjit është një organ i pavarur i cili i raporton Kuvendit, por gjithashtu ky raport nga Kuvendi i drejtohet pastaj Kryeministrit, prandaj edhe konkluzionet dhe rekomandimet e këtij raporti janë shumë të rëndësishme për përmirësimin e efikasitetit dhe funksionimit të administratës shtetërore. Edhe pse Këshilli ka 3 funksione ligjore, është evidente nga të dhënat se kemi një numër të madh të shkeljeve, do të thotë, ankesat të cilat janë paraqitur para këshillit kryesisht kanë të bëjnë me ndërprerjen e kontratës së punës para kalimit, do të thotë, para skadimit të kontratës së punës, pastaj është kontestimi i konkursit, mos vazhdimi i kontratës së punës, kompensimi material, degradimi nga pozitat dhe suspendimi nga puna. Domethënë, sipas këtij raporti del se menjëherë merret masa më drastike sipas ligjit, domethënë, ndërprerja e kontratës së punës. Shkelja është evidente, për arsye se kjo ndërprerje e kontratës nuk është bazuar në ligj, sepse sikur të ishte bazuar

në ligj atëherë do të ishte bërë vetëm në rast se ka raste të masave disiplinore në qoftë se bëhet vlerësimi negativ në punë dhe gjatë punës provuese tremujore. Meqenëse, Këshilli nuk ka konstatuar asnjëherë nga këto primeza ligjore, atëherë del se ka pasur shkelje të ligjit. Ka edhe të dhëna tjera pothuaj se për të gjitha institucionet e Kosovës duke filluar nga ekzekutivi, komunat e deri te agjencitë e pavarura dhe institucionet tjera. Kështu për shembull, deri sa në Ministrinë e Drejtësisë janë 32 raste prej të cilave numri më i madh ka të bëjë me shkeljen ndërprerje e kontratës së punës, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka 18 ankesa dhe dominojnë rastet që kanë të bëjnë me kontestimin e konkursit dhe kështu me radhë. Kurse, sa i përket komunave, janë sidomos evidente shkeljet në Gjilan, pastaj Prishtinë, ku kryesisht dominojnë shkeljet si mos vazhdimi i kontratës, por dhe në komunat tjera, pastaj në QKUK dhe agjenci tjera.

Unë e thashë edhe më herët se esenca e këtij raporti duhej të ishin rekomandimet për përmirësime. Këtë e definojnë edhe ligji, gjegjësisht Rregullorja 2008/12 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36, në nenin 14, ku thotë se Këshilli i pavarur mbikëqyrës jep rekomandime për përmirësim. Prandaj, kjo dispozitë ligjore nuk është plotësuar dhe e konsideroj mangësi shumë të rëndësishme të këtij raporti.

Gjithashtu, del se numri i rasteve të cilat janë zgjidhur në vitin 2008, është më i vogël se numri i rasteve i vitit 2007, që është shqetësuese sepse flet për kapacitetin e kufizuar të këtij Këshilli për zgjidhjen e rasteve, për më tepër meqenëse, sipas ligjit, neni 11.2 e kufizon se përgjigja duhet t'u jepet me shkrim nga Këshilli atyre që ankohen brenda 90 ditëve. Do të thotë se në qoftë se i kanë zgjidhur vetëm 58% të rasteve, 42% të rasteve kanë ngelur pa u zgjidhur dhe nuk është përmbushur premisa ligjore që përgjigja të jepet brenda 90 ditëve. Kjo është gjithashtu një mangësi e madhe e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Raporti e ka edhe një mangësi tjetër, si për shembull, analiza e shkaqeve të ankesave. Në raport thuhet kështu: “Ndoshta shkak kryesor pse autoritetet punëdhënëse kanë ndërprerë kontratat për punë, ka qenë mungesa e mjeteve buxhetore”. Ne nuk mund të bazohemi në “ndoshta”, por duhet bazuar në të dhëna të sakta se pse ka ardhur deri te ndërprerja e kontratës së punës. Po ashtu, sa i përket raportit të parregullsisë të konkursit, sidomos në procesin e rekrutimit, gjë që e dimë se edhe ka ngjarë, raporti thotë se më tepër i referohet bindjeve të parashtruara të ankesave se sa respektimit të nenit 1.2 të Rregullores për Shërbimin Civil, që ka të bëjmë me shkeljen e parimit udhëheqës të meritës apo përbërjen jo të duhur të komisionit intervistues. Pra, nuk mundet Këshilli të bazohet në bindjen e cila fitohet, por duhet të bazohet në bazë të të dhënave dhe nga kjo të nxjerrë konkluzione, Prandaj edhe kjo është një mangësi tjetër. Dhe, në fund, meqenëse siç e thashë, të gjitha këto të dhëna dhe ky raport i dërgohet Kryeministrit, që duhet të jetë vërtet një mekanizëm për përmirësimin e gjendjes, unë kam dilemën se raporti është i plotë dhe se i plotëson të gjitha kërkesat e një raportimi.

Me këtë do të thotë se nuk kemi një rekomandim se cilat janë masat që të ndryshohet gjendja lidhur me këto shkeljet ligjore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Rita Hajzeraj e ka fjalën, le të përgatitet Gani Buçinca.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Nëse e shohim funksionimin e KPMK-së, atëherë duhet ta dimë që ky institucion është baras me Gjykatën Supreme për shërbyesit civil. Andaj, mua më shqetëson fakti sepse kemi shumë ankesa në këtë këshill dhe shumica prej tyre janë miratuar, ndërsa vendimet nuk janë marrë, se vendimet duhet t'i marrë Qeveria e Kosovës dhe institucionet gjegjëse të cilat ju japin punë shërbyesve civilë.

Shërbyes civil, kemi raste kur një qeveri ndërrohet dhe vjen qeveria tjetër, kemi raste kur shërbyesit civilë detyrohen të dalin nga punët, t'ju shkëputet kontrata e punës, andaj në këtë rast ne kemi dhe një kosto financiare, sepse Këshilli Mbikëqyrës i Kosovës merr vendim që këta punëtorë të kthehen prapë në punë, ndërsa në anën tjetër shpenzohet buxheti i Kosovës sepse duhet t'i paguaj edhe ata punëtorë të cilët kanë qenë më herët, edhe punëtorët e tjerë.

Unë mendoj se duhet të merren kritere edhe nga Parlamenti i Kosovës, gjegjësisht nga Kuvendi i Kosovës, i cili duhet të rekomandojë Qeverinë dhe institucionet për shërbyesit civilë që këto vendime t'i zbatojnë, sepse detyrë për të zbatuar këto vendime është e Qeverisë së Kosovës. Është shqetësuese që të gjitha këto ankesa të mos zbatohen nga Qeveria e Kosovës duke pasur parasysh që KPMK-ja ka një numër mjaft të madh të ankesave të qytetarëve të Kosovës, andaj unë kërkoj një vëmendje më të madhe tek Qeveria e Kosovës, tek institucionet të cilat i punësojnë shërbyesit civilë, që të marrin masa dhe mos ta shkelin ligjin kështu, siç janë duke shkuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Por, pasi janë disa kërkesa, unë mundem t'ju them që Kuvendi si institucion ligjdhënës e ka vetëm një rekomandim - të respektohet zbatimi i ligjit. Rekomandim tjetër Kuvendi nuk ka. Diskutuesi i fundit për këtë pikë të rendit të ditës është Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Padyshim se raporti i Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës është një raport që, siç u tha këtu, i plotëson standardet dhe është një raport i mirë. Më gëzon fakti që ky është raporti i parë nga ky institucion që vjen në Kuvendin e Kosovës gjatë qeverisjes aktuale, do të thotë. Unë u paraqita për diskutim vetëm për një fakt, se shumë nga diskutuesit këtu edhe në emër të politizimit të institucioneve tona, e politizuan edhe raportin të cilin e kemi përpara, duke i deformuar rezultatet dhe duke keq informuar opinionin në përgjithësi, përkatësisht duke bërë pak edhe propagandë politike, pak edhe nercionalizëm politik për ndonjë parti politike, gjë që unë e kuptoj se jemi në mes të dy fushatave parazgjedhore dhe t'ju them të drejtën, ishte në kufi të tolerancës edhe të një kulture politike dhe në frymë të fushatës dhe unë kam pritur që debati do të jetë pak më politizues dhe më i ashpër. Unë mund t'ju them se mua më habit fakti sa mirë funksionon administrata lokale dhe shtetërore, duke u bazuar në faktin sa është numri i të punësuarave në nivel lokal dhe qendror dhe sa janë ankesat të cilat i ka shqyrtuar komisioni për të cilin po bëjmë fjalë.

Në përgjithësi, për vitin 2008, ishin edhe disa të vitit 2007, janë 227 ankesa të shqyrtuara, do me thënë ka pasur vetëm 227, të themi kushtimisht, shkelje të të drejtave të punëtorëve në nivel vendi, duke përfshirë këtu edhe komunitat, agjencionet e

pavarura dhe ministritë e Republikës së Kosovës. Me përqindje, kjo është një përqindje mospërfillëse në krahasim me numrin e të punësuarve në Kosovë.

Unë mund t'ju them se komisioni për të cilin po bëjmë fjalë, 58 ankesa i ka aprovuar pjesërisht, i ka hedhur poshtë 47, kurse i ka refuzuar 79 ankesa. Këtu bëhet fjalë për 110 ankesa përafërsisht në nivel vendi dhe bëhet fjalë për 24-5 ankesa të pa implementuara nga institucionet e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë, si deputet i Kuvendit të Kosovës ju apeloj që mos ta bëni mizën buall, siç thotë populli, dhe të hidhni baltë mbi institucionet e Kosovës, se shumë nga diskutimet e juaja pastaj në Evropë merren si bazë për të diskredituar krejt qeverisjen në Kosovë. Të jeni pak më të përgjegjshëm. Unë, si deputet kërkoj që këto 26 ankesa të cilat kanë qenë të arsyeshme dhe komisioni i ka aprovuar në favor të të punësuarve, menjëherë të implementohen nga organet gjegjëse dhe të shkojnë përpara dhe urojmë që vitin që do të vijë do të ketë edhe më pak ankesa dhe kështu që të përmirësohet pozita e të punësuarve në Kosovë. Mirëpo, krejt në fund, dua të them se asnjë i punësuar në Kosovë nuk e ka tapinë për vendin e punës dhe nuk ka garanci se aty ku është punësuar, do të qëndrojë në punë derisa ai të vdes për arsye se në punë ka edhe përgjegjësi. Në rast se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e ka shikuar anën procedurale, juridike të të punësuarve, për shembull, rregullsinë, procedurat e punësimit dhe të largimit, në vend të punës ka edhe përgjegjësi morale dhe profesionale dhe shpeshherë vështirë e kanë institucionet që të dëshmojnë përgjegjësinë profesionale dhe morale dhe dështimet e të të punësuarve në vendin e punës dhe shpeshherë ne na duhet që edhe në këtë drejtim të jemi më fleksibil. Unë e mbështes qëndrimin e kolegut Ardian Gjini, i cili tha se do të duhej të kishim informacione më të detale për rastet konkrete, në mënyrë që të vijmë në përfundim se ku është fajtori, a është fajtori te punëdhënësi apo te i punësuari. Kështu që, po ju them sinqerisht, mua më vjen mirë që ky raport është një raport mjaft i arritur në rrethanat tona të caktuara dhe ju kisha lutur që herëve tjera të jemi pak më të përmbajtur në kritika të pa adresuara dhe në deformimin e fakteve dhe të rezultateve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Shyqyr, nuk kemi më diskutues. Në sallë janë 68 deputetë, kështu që po hyjmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008.

Pika e radhës:

- Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e datës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, dhe ia ka rekomanduar Kuvendit, për miratim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Administratës Publike, zotin Arsim Bajrami.

MINSITRI ARSIM BAJRAMI: I nderuari Kryetar i Parlamentit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar studentë, që po vëzhgoni punën e Parlamentit,

Kam kënaqësinë dhe nderin e veçantë që para jush ta arsyetoj Propozimin e Qeverisë për mbajtjen e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave. Padyshim që është një vendim i shumëpritur, një vendim që është kërkuar shumë më herët dhe më lejoni që ta arsyetoj këtë vendim dhe t'ju lus që ta mbështetni.

Regjistrimi i popullsisë është bërë një parakusht i domosdoshëm për një shtet të ri qysh është Republika e Kosovës dhe po paraqet jo vetëm një operacion demografik për konstatimin e saktë të gjendjes së popullsisë, po gjithnjë e më shumë po bëhet edhe një parakusht për planifikimin e zhvillimit ekonomik.

Të nderuar deputetë,

Të kujtojmë se ne kemi pasur regjistrim gati para 3 dekadave. Një regjistrim në vitin 1981 dhe që nga atëherë në Kosovë nuk kemi një regjistrim të saktë të numrit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave. Ndërkaq, zhvillimi ekonomik dhe zhvillimet demografike kanë qenë shumë të vrullshme, kurse pas pavarësisë është çështja ekzistenciale për një shtet të ri që të konstatojë këtë gjendje faktike për të mundur pastaj të bëjë edhe projeksionet e zhvillimit ekonomik.

Qeveria e Republikës së Kosovës që nga marrja e mandatit ka filluar përgatitjet për caktimin e datës dhe ka filluar negociatat me partnerët ndërkombëtarë, sepse ky projekt apo ky proces është edhe një proces që është parashikuar edhe me pakon e Ahtisarit, ku shprehimisht thuhet se 1 vit pas pavarësisë, përfaqësuesi i ICO-s, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës do ta caktojë datën e regjistrimit të popullsisë.

Ne gjatë këtyre dy viteve kemi zhvilluar të gjitha përgatitjet e nevojshme, kemi zhvilluar të gjitha testimet, pilot testimet, kemi prodhuar mostrat më të mira evropiane dhe kemi krijuar partneritet të ngushtë me Evrostatin, që është në Agjencionin e Komisionit Evropian i cili monitoron dhe mbikëqyrë regjistrimet e popullsisë. Tanimë kemi caktuar edhe hartën e veprimeve që duhet t'i ndërmarrim, një hartë e veprimeve konkrete. Të gjithë jemi të vetëdijshëm që operacioni i regjistrimit të popullsisë është mjaft i komplikuar, do të thosha i komplikuar sa është edhe po të mbash zgjedhje në një vend, sepse është një proces shumëdimensional.

Politikat e Qeverisë shkojnë nga ajo që ky proces të jetë gjithëpërfshirës, të përfshijë të gjithë banorët e Kosovës, qoftë ata që janë rezidentë në Kosovë, qoftë diasporën dhe ne po punojmë që regjistrimi të jetë gjithëpërfshirës edhe në aspektin etnik dhe të përfshijë të gjitha komunitetet pakicë. Jemi duke punuar anë programe konkrete senizibilizuese që pakicat ta kuptojnë regjistrimin e popullsisë si një shans të tyre, si një mundësi e integritetit brenda shoqërisë, jo si një proces politik, por si një proces ekzistencial për të mirën e tyre.

Tanimë i kemi përfunduar të gjitha konsultimet. Ne gjatë muajve të kaluar kemi pasur takime gati javore me Komisionin Evropian, me Eurostatin, me të gjitha agjencitë evropiane që do ta mbështesin këtë proces, sepse ky operacion ka një kosto të lartë

financiare. Rreth 70% e kostos do të mbulohet nga donacionet, 30% nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe kemi dakorduar një datë e cila parasheh që regjistrimi të mbahet në vitin 2011 prej 31 marsit deri me 15 prill. Më lejoni ta arsyetoj pse e kemi negociuar këtë datë.

Të nderuar kolegë,

Në bazë të Rregullores së Parlamentit Evropian, të datës 9 qershor 2008, të miratuar nga Parlamenti Evropian, obligohen të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetet pretendente për integritime evropiane, obligohen që një herë në fillim të dekadës të mbajnë regjistrimin e popullsisë. Në nivel evropian është vendosur një standard një herë në 10 vjet dhe në fillim të dekadës çdo shtet të mbajnë një regjistrim të popullsisë.

Qeveria ka qenë e përgatitur që sivjet ta zbatojë këtë proces. Ne kemi qenë të përgatitur edhe në aspektin teknik, edhe në aspektin profesional, edhe në aspektin buxhetor, por nuk dëshirojmë të improvizojmë me këtë proces dhe dëshirojmë që ky proces të marrë një mbështetje të lartë ndërkombëtare, një besueshmëri ndërkombëtare, sepse dëshirojmë që ne të bëhemi pjesë e euro-zonës dhe të dhënat tona statistikore të jenë të krahueshme, të qarkullueshme dhe të pranueshme plotësisht në aspektin ndërkombëtar. Për këtë arsye, ne kemi edhe 15 muaj përgatitje, të cilat përgatitje do të na mundësojnë që për këta 15 muaj të zhvillojmë të gjitha përgatitjet që ky regjistrim të jetë me standarde sa më të larta. Ju e dini që Qeveria ka proklamuar edhe një regjistrim digjital, që përkon edhe me krijimin e administratë elektronike. Jemi duke punuar që të dizajnojmë çdo gjë që ky regjistrim të jetë plotësisht elektronik, digjital dhe të jetë i qarkullueshëm në zonën evropiane. Në vitin 2011, përpos Shteteve të Bashkimit Evropian, regjistrimin e popullsisë do ta mbajnë edhe shtetet e rajonit dhe ne kemi parë një shans të mirë që ta zëmë këtë hap, këtë hap të një rrugëtimi evropian drejt regjistrimit të popullsisë dhe t'i bashkohemi kësaj përpjekjeje. Tanimë kemi ftuar vëzhguesit ndërkombëtar që të asistojnë, kemi ftuar edhe vëzhguesit e shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët kanë premtuar që do ta vëzhgojnë dhe do ta ndihmojnë procesin. Eurostat dhe Komisioni Evropian kanë premtuar donacion, ju tregova rreth 70% të kostos. Është vlerësuar që ky proces ka një kosto financiare në nivel të Bashkimit Evropian apo 3.5 euro për kokë banori dhe jemi në fund të finalizimit.

Këto ditë unë kam formuar edhe kolegjin e ekspertëve, ka qenë edhe kërkesë e mëhershme. Kam formuar kolegjin e ekspertëve që do ta monitorojnë tërë procesin dhe i kemi finalizuar mostrat më të mira, mostra këto që janë mostra evropiane të cilat kanë nga 200 pyetje, ku vetëm në një pyetje është përkatësia etnike, do me thënë, është një regjistrim civil, qytetar, ku të gjithëve u jap mundësi të barabarta.

Kemi bërë të gjitha përgatitjet për regjistrimin e diasporës dhe në muajt në vijim ne do të japim informacionet e bollshme dhe të nevojshme që diaspora t'i përgjigjet këtij procesi të regjistrimit.

Në fund, dëshiroj të theksoj se kemi marrë një mbështetje të fortë edhe të shteteve tjera, të shteteve konkrete. Janë disa shtete që po e mbështesin këtë proces dhe ky proces do të jetë jashtëzakonisht me rëndësi për një shtet të ri, siç është Kosova, në mënyrë që ne ta kemi një regjistrim plotësisht të saktë, objektiv, të paanshëm dhe profesional për të mundësuar pastaj planifikime jo vetëm ekonomike por, në fakt, të gjitha institucioneve të Kosovës do t'u hyjë në shërbim ky regjistrim për shkak se ne do të operojmë me të dhëna të sakta. Tani operojmë kryesisht me parashikime, me parashikime që i prodhon

Enti i Statistikës. Ky regjistrim do të mundësojë një pasqyrë faktike të gjendjes demografike në Republikën e Kosovës.

Procesi do të përfshijë një numër të madh të njerëzve, rreth 8000 njerëz do të rekrutohen. Gjatë vitit të ardhshëm do të trajnohen, do të përcjellin trajnime të ndryshme për të marrë përsipër procesin e regjistrimit të popullsisë, i cili përfshin regjistrimin e çdo vendbanimi, çdo fshati të Republikës së Kosovës. Të gjitha komisionet që i kemi formuar janë shumë etnike. Kemi një përgjigje pozitive të komuniteteve pakicë. Në testimin e fundit që kemi pasur, rreth 70% të komuniteti pakicë iu ka përgjigjur këtij procesi dhe jemi duke punuar që vërtet procesi të jetë gjithëpërfshirës dhe të krijojme një pasqyrë reale dhe faktike të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Duke ju thirrur që ta mbështesim këtë proces, ju siguroj se do të marrim të gjitha veprimet e nevojshme që ky proces, pas zgjedhjeve të suksesshme që kemi, ky proces do të jetë edhe një afirmim ndërkombëtar i shtetit të ri të Kosovës dhe një hap drejt integriteteve evropiane.

Unë e di se shumë nga ne kemi pasur shpresa që këtë proces ta mbajmë pak më shpejt apo menjëherë pas pavarësisë, sepse unë e pranoj që nuk ka qenë e mundur për pavarësisë, ka pasur në kontinuitet përpjekjesh, por ka qenë e pamundur për pavarësisë të mbahet regjistrimi i popullsisë, por në qoftë se do ta mbajmë në vitin e dytë apo tretë të pavarësisë, është njësoj i madh, është edhe një sfidë e madhe e verifikimit të kapaciteteve tona për të mbajtur një regjistrim me standarde më të larta evropiane. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtar i Kryesisë, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Si raportues i Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, deklaratën e vet to ta bëjë Hajredin Hyseni.

HAJRDDIN HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ministra të pranishëm,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media i kishte rekomanduar Kuvendit që regjistrimi i popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave të fillojë më 30 mars deri më 15 prill 2010. Mirëpo, pas udhëzimeve të Kryesisë së Kuvendit që ky komision të harmonizojë datën e mbajtjes së regjistrimit me Qeverinë, komisioni ka bërë konsultimet me Ministrinë e Administratës Publike dhe pas dëgjimit të fakteve që ka paraqitur ministria, komisioni në një mbledhje të veçantë është pajtuar me shumicën e deputetëve të komisionit që vendimi i Qeverisë të përkrahet, regjistrimi i popullsisë të jetë më 30 mars deri më 11 prill 2011. Komisioni ka qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e regjistrimit të popullsisë dhe të ekonomive familjare për nevojën sa më të shpejtë të këtij regjistrimi, por ky regjistrim duhet të ketë edhe mbështetjen e gjerë vendore dhe ndërkombëtare për të qenë i suksesshëm. Andaj, komisioni ka përkrahur vendimin e Qeverisë që ky regjistrim të bëhet në vitin 2011. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Kush deklarohet në emër të Grupit të Partisë Demokratike? Deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë të respektuar deputetë,

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje të veçantë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, sikurse edhe rekomandimin e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media dhe ka ardhur në përfundim që ta mbështesë vendimin që regjistrimi i popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave të bëhet në afatin dhe në kohën e propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Me këtë rast, unë do të dëshiroja ta falënderoja dhe ta përgëzoja Qeverinë e Republikës së Kosovës, gjegjësisht Ministrinë e Administratës Publike për përpjekje të vazhdueshme në drejtim të krijimit të kushteve sa më të favorshme për gjithëpërfshirjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës në këtë proces, sikurse edhe të diasporës.

Gjithashtu, ta përgëzoj dhe për partneritetin e ndërtuar me Eurostatin dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë, por veçanërisht është inkurajues fakti që do të duhet të shtyhet në dekadën e parë apo në vitin e parë të dekadës, sepse do të zihet hapi me të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, sikurse edhe me vendet e rajonit. Prandaj, ne e mbështesim dhe e inkurajojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës që të jetë inkluzive, do me thënë që të përfshijë të gjithë qytetarët e Kosovës në regjistrim, sikurse edhe diasporën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Avdiu!

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, grupin e saj parlamentar, zonjusha Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës e ka përkrahur dhe përkrah regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë.

Kosova ka 28 vjet dhe atëherë kur e ka paraparë Qeveria, do të bëhen 30 vjet pa regjistrim të popullsisë. Është shumë çudi se kur e ndien njeriu këtë Qeveri, mendon se ky shtet ekziston veç dy vjet. Do me thënë, sipas kësaj që paraqitet, vendi ynë, Kosova, ekziston veç dy vjet.

Në vitin 2007, po ky Kuvend i Kosovës e ka pranuar mbajtjen e regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave. Ky Kuvend, do me thënë i Kosovës, nuk ka lidhje kush kemi qenë, kush s'kemi qenë. Atë vendim ky Kuvend e ka marrë në bazë të përgatitjeve të cilat janë bërë, përgatitje të plota për mbajtjen e regjistrimit. Procedurat tjera pse nuk kanë vazhduar, mendoj se as nuk mund të shtrojmë pyetje, as nuk mund të na japë dikush përgjigje sot. Edhe atëbotë ka ekzistuar Eurostatin dhe po ky Eurostat ka pasur vlerësimet më të mira të mundshme që regjistrimi mund të mbahet. Prandaj, ajo ka dalë në Kuvend, prandaj është miratuar nga Kuvendi dhe ka vazhduar më tutje. Dhe, çfarë po ndodhë tash? Do me thënë, prej asaj kohe kanë kaluar edhe dy vite dhe Qeveria i parasheh edhe dy vite tjera, do me thënë 4 vite na jemi mbrapa nga koha kur i kemi bërë përgatitjet për regjistrim të popullsisë.

Propozimi i Qeverisë është mbështetur në dy-tre arsye. Disa i kanë thënë publikisht e disa nuk i kanë thënë. Arsyetimi për regjistrimin në vendet evropiane, se do ta bëjnë regjistrimin shumica e vendeve evropiane, mendoj që është e saktë që shumica do ta bëjnë në vitin 2011, mirëpo ka edhe shumë vende evropiane që regjistrimin do ta bëjnë në vitin 2010, madje disa nga to po e bëjnë edhe në vitin 2009. Unë e kam pasqyrën e plotë e të gjitha vendeve se kur e kanë paraparë mbajtjen e regjistrimit.

Një arsyetim tjetër që, fatkeqësisht, vazhdimisht jemi mësuar ta themi, është qoftë tash marrëveshja me ndërkombëtarët që e përkthyer shpeshherë në këtë gjuhën tonë politike, do të thotë pengesat nga ana e ndërkombëtarëve, që mendoj se nuk ekziston, sepse me marrëveshjen për statusin e Kosovës të presidentit Ahtisari është thënë shumë qartë se një vit pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, Kosova në këshillim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar do ta bëjë regjistrimin, ka thënë do ta bëjë regjistrimin e popullsisë, i cili do të kryhet në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe do t'i nënshtrohet vëzhgimit ndërkombëtar. Natyrisht, Qeveria jonë e ka tejkaluar edhe këtë marrëveshje, e cila edhe ashtu është shumë e pafavorshme në shumë pika, e në veçanti përfshirë edhe regjistrimin e popullsisë. Nuk e lexova edhe pjesën tjetër të marrëveshjen çfarë thotë për regjistrimin e qytetarëve serbë që jetojnë jashtë Kosovës dhe për mënyrën e regjistrimit të tyre. Po ashtu, një pikë tjetër që ka qenë mundësia e mos daljes se serbeve ose e mos përgjigjes së serbeve regjistrimit të popullsisë, që sigurisht edhe ajo është tejkaluar me faktin e daljes së tyre tani në zgjedhje, por edhe po të mos jenë, e kemi bërë shumë të qartë që Kosova nuk mundet të jetë përherë peng i instrumentalizimit të askujt, prandaj as të serbëve.

Kjo çështje, në radhë të parë shtrohet si çështje e kapacitetit qeverisës dhe vendimmarrës dhe dëshmon shumë qartë se këto kapacitete, fatkeqësisht, nuk janë të mjaftueshme për ta qeverisur një vend të pavarur dhe kjo është një fatkeqësi e madhe sepse do duhej të ishte krejtësisht ndryshe. Janë do informacione që disa zhvillime të cilat janë duke ndodhur rreth këtij procesi, madje ka rrezik që edhe në vitin 2011 mos të mbahet regjistrimi popullsisë dhe ato informacione unë i kam sepse është një pjesë e punës të cilën e kam kryer me shumë përkushtim dhe kam informacione, besoj, bukur të sigurta.

Një çështje tjetër që duhet ta shtroj, është se ky propozim edhe po të mos pranohet nga Kuvendi, Qeveria natyrisht nuk do ta përfillë, ashtu siç nuk i ka përfillur asnjë nga vendimet ose shumicën e vendimeve të Kuvendit. Ju e dini që ky Kuvend dy herë, në dy seanca ka marrë vendime që të mos rinovohet objekti i Rilindjes, Kuvendi i Kosovës, në dy seanca ka marrë vendim që të mos rinovohet objekti i Rilindjes për arsye të kontestit pronësor dhe kjo Qeveri, duke shkelur mbi krejt këto vendime të Parlamentit, e ka bërë renovimin. Edhe nuk është fort nder për neve, do të ishte shumë nder që më 2007 ose hajde më 2008 ta kishim bërë regjistrimin e popullsisë, nuk është hiq fort nder të themi dhe të dalim para deputetëve dhe të themi është në nderin tonë që do ta bëjmë regjistrimin në vitin 2011.

Dhe, kam një çështje që, mendoj, do të duhej t'i jepte përgjigje ministrit, sepse po krijohen shumë paqartësi dhe konfuzion tek qytetarët tanë, në veçanti tek qytetarët jashtë Kosovës, që jetojnë atje. Ministri tha se do të bëhet regjistrimi i diasporës. Shumë do të kisha dëshirë që kjo të jetë e vërtetë, por janë bërë keqkuptime të mëdha, sepse jo pak njerëz çështjen e regjistrimit e kanë ndërlidhur me çështje të shtetësisë apo të drejtës së nënshtetësisë, e që sipas atyre standardeve që unë i di, nëse nuk ka ndërrua, s'besoj që ka ndërruar, nuk është e njëjta gjë, sepse ata njerëz që i kemi jashtë, do të regjistrohen

atje ku jetojnë, nëse jetojnë më shumë se një vit dhe kjo është pjesë e standardit. Mos t'i mashtrojmë, nuk ka asnjë arsye që të mashtrohen njerëzit. Njerëzve duhet t'u thuhet qartë dhe e vërteta. Është shumë e vërtetë që me mund tepër të madh, sepse UNMIK-u nuk ka lejuar madje të kemi asnjë formular për pasqyrën e qytetarëve që i kemi jashtë, me mund jashtëzakonisht të madh e kemi siguruar këtë, pa e vetë hiq UNMIK-un, e kemi bërë dhe e kemi bërë atë formular. Prandaj, do të doja që të jetë një sqarim rreth kësaj dhe sa për deklaratën, që pas zgjedhjeve ky proces është hapi më i madh në Kosovë, ndoshta më lejohet edhe mua të them që pas këtyre e zgjedhjeve do të ketë edhe zgjedhje tjera, me sa po shihet, para se të bëhet regjistrimi i popullsisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Tërmkolli, cili është mendimi i LDK-së për..., objeksionet i dëgjuam, por a ka LDK-ja mendim, deklaratë rreth kësaj.

MELIHATE TERMKOLLI: Më fal, për ata që kanë dëgjuar, ishte fjalja e parë: LDK-ja e ka përkrahur dhe e përkrah regjistrimin e popullsisë së Kosovës.

KRYESUESI: Mirë, ju faleminderit!

Unë do ta jap fjalën, zoti ministër, megjithatë një herë t'i marrim deklaratat e grupeve, mandej do ta merrni fjalën. Unë besoj që për AAK-në do të flasë shefi i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne, do të thotë, si fjali e parë, nuk kemi se si të mos e mbështesim procesin e regjistrimit në Kosovë. Nuk do t'i përsëris disa vërejtje të cilat vetëm i tha një pjesë e opozitës, pozitës, ish-ministrja Tërmkolli, is-kolege e nderuar.

Ne i kemi disa dilema, fillimisht, pse është fillimi i dekadës të vitit 2011. Na e dimë që fillimi i dekadës ose fillimi edhe i mileniumit është debat edhe historik, edhe matematik, edhe filozofik, domethënë zero është një, dhe në bazë të çkafit ka vendosur Kosova se është një, do me thënë tjetër kund ka pak a shumë debat, se e dimë që diku tjetër edhe dhjetëshi është në rregull dhe nuk kemi ndonjë telashe. Tjetra është çështja e fillimit të regjistrimit në vendet e Unionit Evropian dhe në vendet që pretendojnë anëtarësimin në Union Evropian, po duket pak më shumë si justifikim dhe mendojmë se në Kosovë nuk ka problem të madh të hapen debatet ashtu siç janë dhe mos të kamuflohen me shumë çështje për shkak se ne i kuptojmë, e kuptojmë edhe ministrin, e dimë se çfarë pune ka bërë edhe ish-Ministria, edhe ish-ministri, do me thënë i kemi të qarta këto tema, kështu që nuk ka problem ndonjëherë edhe nëse hapet debati ashtu si është në Kuvendin e Kosovës për shkak se i dimë detajet, i dimë qysh janë. Këto janë temat e njëjta, e thashë edhe një herë, e përkrahim. Nuk e kemi shqyrtuar këtë radhë me vëmendje të veçantë, sepse e kemi pas shqyrtuar me vëmendje të veçantë shumë herë më përpara këtë propozim. Edhe ne shpresojmë që nuk do të ketë shtyrje edhe pas vitit 2011. Edhe ne shpresojmë, për shkak se edhe ne kemi informacione se mund të ndodhë që as në pranverë të vitit 2011 të mos mbahet regjistrimi i popullsisë, se ka ende dilema. Çështja e fundit është shumë teknike. Në dokumentet të cilat i kemi marrë ne deputetët e Kuvendit të Kosovës, komisioni thotë se regjistrimi do të mbahet në vitin 2010. Merrni dokumentet, i keni përpara. Ne e dimë se është gabim, mirëpo, ju lutem, edhe Sekretarisë, edhe komisioneve, me të vërtetë janë gabime shumë banale për të ndodhur, se dikush duhet ta kontrollojë dhe rikontrollojë atë dokument dhe mos të shtypet e të vijë pa e lexuar askush dy herë. Le të lexohen dy herë, të paktën, ato dokumente me kujdes para se t'iu vijnë deputetëve për seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Gjini! Për Aleancën Kosova e Re, besoj do të flasë anëtari i Kryesisë, Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje ministra prezentë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet Projektin regjistrimit të popullsisë në Kosovë. Natyrisht, këtu ndanë mendimin se është projekt i vonuar, por në njëfarë mënyre ka edhe konsideratën për rrethanat që kanë mbretëruar dhe mbretërojnë në Kosovë për t'u kryer me sukses ky projekt. Këtë e them në kuptimin e asaj se ky proces duhet të jetë, meqë ka një shtyrje kaq të gjatë, duhet të jetë gjithëpërfshirës. Kur them gjithëpërfshirës, duhet të shtrihet në gjithë territorin e Kosovës dhe të përfshijë të gjitha kategoritë edhe sociale, po mendoj edhe etnike, edhe profesionale, edhe pronësore që nënkuptojnë, do me thënë, që me një fjalë duhet të jetë në konformitet të plotë me standardet e regjistrimeve kudo në botë.

Ndoshta, meqë jemi kaq shumë të shtyrë, vitin 2011 është vit kur fillimi i dekadave është fillim, po mendoj standard i Evrostatit për regjistrimin e popullsisë dhe këtu nuk ka gjë të keqe, por unë kisha një pyetje për ministrin kur thotë se Qeveria ka qenë dhe është e përgatitur për këtë proces. Nuk e di se kujt i adresohen atëherë arsyet e vonësive kaq të mëdha, nëse Qeveria paska qenë gjithmonë e përgatitur dhe qenka e përgatitur. Çështja tjetër është se në njëfarë mënyre a ka ndonjë studim se sa konsekuenca ka prodhuar mos regjistrimi 30 vjeçar i popullsisë dhe mbi çfarë statistikash sot Kosova në njëfarë mënyre operon për sukseset, për dështimet e saj, përfshirë madje edhe procesin zgjedhor në të cilin jemi. Ne bëjmë disa zgjedhje në Kosovë pa pasur një regjistrim të popullsisë dhe, natyrisht, observojmë me shifra mbi pjesëmarrje, mospjesëmarrje, dalje mosdalje, që gjithmonë janë shumë relativë, pastaj për kategoritë e popullsisë që për arsye të ndryshe asnjëherë nuk janë në Kosovë dhe figurojnë në regjistra të popullsisë, regjistra që prapë janë shumë diskutabil në saktësinë e tyre.

Me një fjalë, grupi i AKR-së e mbështet dhe e përshëndet këtë projekt, por kërkon që në radhë të parë të mos ketë shtyrje të tjera dhe, ajo që është esenciale, të jetë gjithëpërfshirës dhe të krijohen parakushte edhe politike që ky projekt të shtrihet në gjithë territorin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Gashi!

Në emër të LDD-së, flet deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Sigurisht që regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe i banesave ka një rëndësi kruciale për shtetin tonë, për qytetarët tonë, por edhe parametra tjerë vital të organizimit të jetës dhe të aspektit institucional në Kosovë.

Pa këtë proces tejet të rëndësishëm, pa statistika të besueshme dhe pa të dhëna demografike konkrete, kemi parë që këto vitet e tranzicionit nuk kemi mundur të hartojmë as strategji sektoriale, as strategji zhvillimore nacionale për vendin tonë, as planifikim hapësinor të Kosovës, sepse nuk kemi pasur statistika të besueshme, mund

t'ia shtojmë kësaj edhe të njohura ndërkombëtarisht që ka pasur impakte direkte, qoftë në zhvillimin ekonomik, qoftë në parametrat e tjerë mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror të vendit tonë. Ka pasur edhe vendime më herët nga ana e legjislativit të Kosovës për organizimin, mbajtjen e regjistrimit të popullsisë së ekonomive familjare dhe të banesave, por e dimë në atë kohë statusin politik dhe juridik të vendit dhe problemet pse jo edhe politike që kanë ekzistuar. Ne jemi Kuvendi i Kosovës dhe gjërat duhet t'i diskutojmë shtruar dhe ashtu siç janë.

Natyrisht që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet vendimin e Qeverisë edhe pse i prolonguar që regjistrimi i popullsisë në Kosovë, i ekonomive familjare dhe i banesave të mbahet nga data 31 mars deri me datën 15 prill 2011, por si Kuvend, si organi më i lartë legjislativ i vendit tonë, si përfaqësues populli, a na garantohet, zoti ministër, që në këtë datë, në fillim të dekadës së dytë të mileniumit të tretë Qeveria e Kosovës do të zotohet dhe do ta jetësojë këtë projekt tejet të rëndësishëm për vendin dhe ardhmërinë tonë.

I dimë specifikat e Kosovës, i dimë problemet politike. Ne si Grup parlamentar kemi dilema në gjithë përfshirjen që do të ndikojë në legjitimitetin dhe në akceptimin ndërkombëtar të këtij procesi që, deshëm s'deshëm, është i rëndësishëm për Kosovën dhe te regjistrimi i njerëzve tanë që i kemi në mërgatë. Do të thotë, tani është çështje e ekzekutivit të vendit, konkretisht e Ministrisë së juaj, zoti ministër, që t'i merrni të gjitha masat e nevojshme që asnjë qytetarë i Kosovës të mos ngel jashtë këtij procesi.

Shpresojmë dhe duam të besojmë që kjo datë e propozuar nga ekzekutivi i vendit dhe me miratimin e organit më të lartë legjislativ të shtetit tonë, duam të besojmë se ky projekt do të jetësohet në këtë datë të paraparë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Rugova!
Tani Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar "7+".

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući!
Dozvolite da pozdravim ministre, kolege!
Ovo je jedna od tema sa kojom smo se suočavali mnogo puta u vremenu koje je iza nas. Oni koji se bave demografijom i populacijom znaju da nije nimalo jednostavna radnja popisati stanovništvo, imovinu, nekretnine. Prema tome, neki koji misle da je april 2011 veoma blizu, zavaravaju se jer je do njega samo još 16 meseci. Svu složenost obavljanja ovakve jedne radnje izneo je resorni ministar u svom izlaganju na početku ovog razgovora i mislim da ono što je rekao da je popis stanovništva teže nego sprovesti jedne izbore, ja bih rekao jeste to tačno i to ne samo kao lokalne, nego zajedno i centralni i ostalo.

Mi smo u više navrata govorili da treba ranije obaviti popis, uvažavajući sve razloge koje ima Kosovo s obzirom na to da je poslednji pravi popis bio 1981. godine. Međutim, zemlje koje su doživle ratove, zemlje koje su doživle promene imovine, pomeranja stanovništva, doživle su toliko složene promene da mi koji često govorimo o katastarskim knjigama, da možemo kao jednu zbirku pesama da je uzmemo i da je nosimo kući, mi nimalo ne razmišljamo šta to znači i koje su sve predradnje potrebne da bi se tačna evidencija imovine, stanova i svega ostalog obavila, ne samo stanovništva. Ne znamo Vlada i Ministarstvo dokle je stigla sa tim pripremama, ali je činjenica da su one veoma složene, treba veoma mnogo vremena za njih, treba veoma

mnogo prirpema, stručnjaka, eksperata i tako dalje i međunarodni faktor sigurno je uzimao u obzir ovo o čemu sada govorim ja, pa je uvek odlagao popis. Nije nemoguće da popis ne bude ni 2011. godine. Jedini razlog za to će biti koliko ćemo biti spremni da ga obavimo, kako ćemo dorpeti do svakog kosovara koji se nalazi u dijaspori, u raseljanju i tako dalje. Kako ćemo sa svim onim zamešateljstvom oko nekretnina stanova i kuća da sve to obavimo. Gospodo, ovo je veoma složena radnja. Mi ga u Parlamentarnoj grupi „7+“ podržavamo, ali smo skeptični dali sve može da se pripremi kako bi popis bio valjan, objektivan i priznat. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Murati!

Tani kemi edhe tre deputetë, sipas rendit: Gjylnaze Syla, Armend Zemaj dhe Riza Smaka, folës shumë të njohur për të gjitha problemet këtu në Parlament.

E ka fjalën Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit për kompliment, zoti kryesues!

Të nderuar ministra, deputetë, të nderuar,

Çështja e regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe banesave është domosdoshmëri për Kosovën, nuk është vetëm çështje thjesht e regjistrimit të popullatës, por edhe caktimit të parametrave për zhvillimin ekonomik si dhe të planifikimeve strategjike.

Tash unë, zoti ministër, ju dëgjova me shumë vëmendje dhe i mata argumentet të cilat i thatë për shtyrjen e këtij regjistrimit, gjegjësisht që regjistrimi të bëhet në vitin 2011. Unë kisha shtruar argumentet të cilat janë për regjistrimin më të shpejtë të popullatës. Dhe, po filloj që nga përgjegjësia ligjore e përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, por edhe vetë vendimit të Qeverisë. Unë e kam këtu një vendim të Qeverisë të datës 16 korrik 2008, ku thuhet se Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Kosovës që regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe i banesave të mbahet nga data 31 mars deri më 15 prill 2009. Pra, kjo është për vitin 2009.

Tani kemi një kërkesë tjetër, ose vendim tjetër të Qeverisë, që kërkon kjo të bëhet prej 30 marsit deri më 11 prill 2011. Argumenti tjetër ligjor i Qeverisë është edhe Pakoja e Ahtisarit, e cila kërkon që një vit pas shpalljes së pavarësisë ose hyrjes në fuqi të Pakos të fillojë regjistrimi i popullsisë.

Së fundi, u shtrua edhe një argumentet, siç e thatë, ju y. Ministër, është argument politik, që kërkon përfshirjen e gjithë popullatës së Kosovës. Por, çfarë ju siguron ose çfarë ndryshon prej vitit 2010 në vitin 2011 se ata të cilët sot refuzojnë sot do t'i nënshtrohen regjistrimit në vitin 2011?

Në fund, a mund të na siguron se Qeveria është në gjendje ta kryejë punën në bazë të gjitha standardeve, sidomos atyre evropiane, duke prodhuar statistika gjithashtu të standardit evropian në vitin 2011. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Për shkak të opinionit, unë megjithatë si deputet duhet t'i them disa çështje për çështjen e regjistrimit të popullsisë, të pronës dhe të banesave.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

Do të përpiqem të jem shumë konkret, për faktin se çështja e regjistrimit të popullsisë është një çështje, ndoshta nuk do të duhej të ishte politike, do të duhej të ishte krejt administrative, por e vërteta është se ky problem nga legjislatura e parë e Kuvendit të Kosovës ka qenë problem politik.

Kosova regjistrimin e popullsisë ka mund ta bëjë edhe në vitin 2003, edhe në vitin 2004, edhe vazhdimisht, do të thotë, është një problem administrativ.

Në fund të vitit 2004, Qeveria në takimin që i ka pasur në Bruksel me Komisionin Evropian, kam shtruar kërkesën – Pse sipas standardit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për çdo 10 vjet shtetet janë të obliguara ta bëjnë regjistrimin e popullsisë? Në Kosovë administron Organizata Ndërkombëtare dhe nuk po mbahen zgjedhjet, do të thotë, e ka shkelur një standard të vetin. Përgjigja ka qenë se ky problem në Kosovë është problem politik dhe nuk janë krijuar kushtet dhe rrethanat që të mbahen. Prandaj, ne të gjithë e dimë se pavarësinë e kemi pasur të drejtë ta kemi edhe në vitin 1920 edhe në vitin 1980, edhe në vitet 90-ta, por është bërë, është shpallur në këtë Kuvend, më 17 shkurt 2008. Do të thotë, të drejtë kemi pasur, por është dashur të vijë momenti që në koordinim edhe me faktorin ndërkombëtar ta shpallim dhe të na njohin pavarësinë. Dhe, ju po e shihni që edhe dy vjet pas shpalljes së pavarësisë kemi vështirësi për t'u njohur në nivel ndërkombëtar shteti i pavarur dhe sovran i Kosovës. Mendoj që në këtë rrafsh duhet ta shohim edhe këtë problemin e regjistrimit të popullsisë, s'kemi çka ta akuzojmë asnjë qeveri, as ato të mëhershmet as këtë që është sot. Është problem politik dhe për të bërë një regjistrim i popullsisë, jo vetëm që duhet ta bëjmë administrativisht dhe ta njohim ne vetë, por duhet të na njeh edhe Bashkimi Evropian, si standard. Prandaj, mos ta fajësojmë askënd në Kosovë pse ky regjistrim nuk është bërë?

Mandej edhe një çështje që dua t'ia sqaroj juve dhe opinionit, se edhe në debatin që u dëgjua këto ditë gjatë zgjedhjeve, thanë disa analistë se mungesa e pasjes së regjistrave të votimit është mungesë e regjistrimit të popullsisë. Dua të them që regjistrimi i popullsisë, i pronës dhe i banesave absolutisht s'lidhet as me regjistrim civil, nuk lidhet as me regjistrat e votuesve, është një çështje tjetër që ka të bëjë krejt me diçka tjetër. Këtu po mendohet që regjistrimi i popullsisë bëhet edhe në botën perëndimore. Ju lutem, sipas standardeve, të gjithë e dimë se regjistrimi i popullsisë bëhet për popullsinë rezidente. Dhe, nëse, bëhet një regjistrim jashtë Kosovës për qytetarët e Kosovës ta dini që është jashtë standardeve, dhe, si i tillë mendoj që për institucionet e Kosovës duhet të jetë jo i pranueshëm. Regjistrimi i popullsisë bëhet për ta ditur numrin e popullsisë rezidente, pronën dhe banesat, nuk ka qëllim tjetër, pastaj ky regjistrim hyn për çështje të statistikave të ndryshme që vërtet i duhen Kosovës.

Pra ne mund ta bëjmë edhe sivjet ndoshta regjistrimin e popullsisë, por nuk na njeh kush dhe s'na merr askush si valid. Prandaj mendoj që viti 2011 është koordinim, mendoj që ministri e ka thënë edhe me vendet e Bashkimit Evropian. Ju e dini se numri tek gjithnjë është vit i regjistrimit të popullsisë edhe në të kaluarën ka qenë tek ne, por edhe në vende tjera, prandaj nuk kemi nevojë ta politizojmë këtë problem, ne kemi nevojë vërtet ta kryejmë këtë problem, por ka qenë problem jo administrativ. Përsëri po e them, ka qenë problem politik dhe mendoj që duhet të presim edhe ne pak kohë që si institucione ta kryejmë këtë obligim, se është e vërtetë se Kosova në aspektin administrativ edhe pse

ka shumë nevojë t'i ndërtojë kapacitetet administrative, ka kapacitete administrative për ta bërë një regjistrim të popullsisë.

Prandaj ju lutur që vërtet këtij problemi t'i qasemi në të gjitha parametrat që i ka, është problem politik dhe natyrisht një regjistrim që bëhet duhet të jetë i pranueshëm edhe për Eurostatin, duhet që të kërkojmë që viti 2011 të jetë viti i fundit kur ky regjistrim duhet të bëhet. Mendoj që kjo duhet të jetë kërkesa jonë si Kuvend. Mendoj që ne si Kuvend mund ta obligojmë që Qeveria të përgatitet sa më mirë që në vitin 2011 ta kryejmë këtë obligim që ka një rëndësi të madhe për të gjitha zhvillimet që i kemi në Kosovë. Mendoj që nuk kemi nevojë tash të hedhim dyshimet te ky apo tek ai, është një proces që duhet të jetë në koordinim, siç e kemi kryer pavarësinë me faktorin ndërkombëtar, ta kryejmë edhe regjistrimin e popullsisë në koordinim me vendet e Bashkimit Evropian dhe me Eurostatin dhe nuk kemi nevojë vërtet ta hedhim faj këndej e aty.

Megjithatë ne duhet të kërkojmë nga Qeveria dhe po e përfundoj që viti 2011 të jetë viti i fundit kur institucionet e Kosovës e kryejnë këtë regjistrim që është i rëndësishëm për shumë çështje të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, të statistikave të ndryshme, të statistikave arsimore, të çështjeve të punësisë dhe të shumë statistikave që vërtet janë të nevojshme për Kosovën dhe për qytetarët e saj.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje ministrave, kolegëve deputetë,

Edhe studentëve, si e tha ministri atje lart,

Ky problem është shumë i madh. Ky problem për Kosovës ka qenë gjithmonë politik se këtu u tha disa herë mos ta politizojmë këndej e aty, do të politizohet edhe tash e tutje, qysh e kemi ne strukturën dhe qysh i kemi ne këto intencat tona këtu.

Unë mendoj se do të jetë një gabim shumë i madh në qoftë se ne nuk kërkojmë edhe prej faktorit ndërkombëtar që ta na i legalizojnë rezultatet e regjistrimit të popullsisë në vitin 2010. Tri dekada të kalojnë pa regjistrimin e popullsisë, kjo domethënë të mbesim në krejtësisht në mjegull. Regjistrimi i popullsisë implikohet në të gjitha ligjet për planifikimin e të gjitha veprimtarive në çdo shtet merret për bazë numri i popullsisë, struktura e popullsisë, struktura të ndryshme, kualifikime të ndryshme e tjera.

Kisha për ta theksuar edhe një gjë të tillë, në qoftë se ne e bëjmë kështu me një lehtësi heqim dorë nga regjistrimi i bashkatdhetarëve tonë në botën e jashtme, ne e bëjmë një gabim jashtëzakonisht të madh. Punëtorët në botën e jashtme e kanë një status zyrtar e kanë pasur deri sot, s'di si do të kenë nesër, se janë punëtorë të përkohshëm në botën e jashtme, të përkohshëm, ata i kanë familjet këtu, pse mos të regjistrohet ai që shkon atje një vit a dy, a pesë vjet për ta mbajtur familjen e vetë këtu në Kosovë dhe kthehet këtu, pra të mos ketë ai të drejtë të regjistrohet si është banor edhe qytetar ose shtetas i Kosovës. Ai është një gabim i madh edhe atë ne si Parlament kurrësi nuk ishte dashur ta pranojmë.

Mandej, kisha për të theksuar edhe një rrezik të madh, në qoftë se bëhet liberalizimi i vizave tashti më shpejt do ta kemi një eksod, do të thosha, të hatashëm në botën e jashtme, kështu që do të destabilizohet numri i banorëve të Kosovës. Unë them se duhet sa më parë, nëse mund edhe sivjet ta bëjmë, por sivjet është e pamundshme, kuptohet,

por me qenë se qenkan krejt në rregull përgatitjet qysh më parë, pa marrë parasysh cila Qeveri ka qenë në pushtet, atëherë më duket se nuk është ndonjë pengesë që ne mos ta bëjmë regjistrimin e popullsisë në vitin 2010. Faleminderit!

KRYETARI: Problemi është politik, por mendoni edhe ju në aspektin politik, është mirë që deputetët ta kenë parasysh.

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, zoti Kryetar!

Edhe unë i vazhdoj falënderimet për komplimentet, ashtu siç e tha edhe kolegja ime.

Natyrisht që e përkrahim, domethënë, Propozim-vendimin e Qeverisë. I dëgjuam edhe dy ish- ministrat e dëgjuam edhe ministrin, por mendoj që është dashur ta kemi një material përcjellës edhe ta kemi arsyeshmërinë dhe mos të bimë në konfuzitet tash edhe me këto data që dikush e përmendi edhe nga Komisioni funksional që i ka përzier, por edhe ta saktësoj edhe ministri datën e fillimit dhe të mbarimit të regjistrimit të popullsisë, sepse Komisioni funksional e dha 30 mars- 15 prill të vitit 2010. Po ashtu e ka edhe vendimi i Qeverisë, 30 mars, domethënë dhe 11 prill 2011, duhet ta dimë cilit vit- 30 mars cilit vit? 30 mars të vitit 2010 apo 30 mars 2011, prandaj kjo është ajo që unë duhet të them, sepse e patëm një konfuzitet?

E dyta, edhe një pyetje për ministrin, prapë për shkak të arsyeshmërisë së materialit- Sa është qëndrueshëm, zotëri ministër, premtimi nga donatorët për financimin e këtij projekti i cili është kushtueshëm e përmend që do të angazhohen më shumë se 8 mijë persona? Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar,

28 vjet kanë kaluar prej regjistrimit të fundit në Kosovë e prej asaj date të atij viti në vendin tonë ka ndodhur ndryshime sociale- ekonomike, arsimore, zhvillimore, demografike të thella. Sot ne elaborojmë me presupsione dhe me hipoteza se nuk kemi të dhëna as përafërsisht të sakta, prandaj kjo është një nevojë imediate edhe e kem përpara vendimin e Qeverisë për konfirmim, në vërtet për diskutim, po që në fillim do të isha angazhuar që ta suportojmë tërësisht me një kërkesë që Ministria për Administratën Publike të pajiset me të gjitha ingjerencat që të ketë, të jetë funksionale dhe të jetë efikase dhe nuk dyshoj fare që ky aktivitet tepër i rëndësishëm do të realizohet në afat, kjo është një.

Edhe sa i përket një aludimi një kolegu të mëparshëm se qenkan disa këtu që diskutojnë për të gjitha temat. Unë vlerësoj me bindje të padiskutueshme se është detyrë themelore e cildo delegat- deputet- deputete, që për temat që na ofrohen na qiten përpara të angazhohemi dhe të japim atë kontribut që mund ta japim, herë më shumë e herë më pakë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Sabri Hamiti, e ka fjalën, lë përgatitet deputeti Ali Lajçi.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Parlamentit,

Zotërinj ministra,
Kolegë deputetë,

Ju e dini shumë mirë që tema është e përsëritur, më së pakti e dy qeverive deri më tash, për të mos thënë tri. Nevoja është përsëritur edhe në këtë Parlament. Edhe kjo legjislaturë e ka pasur në rend dite këtë temë dhe e ka tërhequr me kërkesë të Qeverisë. Kjo është historia dhe në këtë kuptim besoj që sa ta zgjasim, do ta zgjasim duke përsëritur çështjet që i kemi thënë në këtë foltore disa herë në këtë legjislaturë ose në të tjerat.

U tha edhe këtu po duhet të thuhet edhe një herë të nënvizohet që çështja e regjistrimit të popullsisë dhe të pasurisë në Kosovë është dhe ka qenë problem edhe konstitucional, është dhe ka qenë problem politik, është dhe ka qenë problem social - demografik, është dhe do të jetë dhe ka qenë problem zhvillimor, sepse deri më sot në mungesë të fakteve në këta lëmenj ne kemi pasur hamendësime të natyrave edhe nacionale dhe sociale edhe politike, edhe demografike. Pra, çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë që gjithë neve këtu që jemi dhe ajo që ne kemi trashëguar në nivelin institucional dhe kuvendor e pushtetor qeverisë në Kosovë, është një trashëgimi që na sprovon a kemi marrë kapacitetet e vërteta konstitucionale, politike dhe zhvillimore për ta bërë një punë të tillë të rëndësishme së veçantë? Nëse ne i kemi këto kapacitete sot atëherë askush nuk mund të dalë përpara që të kryhet ky aksion i rëndësishëm së veçantë për Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran.

Prandaj normalisht që unë e përkrah si gjitha hera se kemi ne shqyr shënime kush çka ka thënë në gjitha kohërat në këtë foltore që regjistrimi të bëhet, natyrisht të bëhet sa më shpejtë që është e mundur, po kjo edhe një herë po ju them do të varet nga kapacitetet institucionale, konstitucionale, politike tonat, duke filluar nga Parlamenti i Kosovës.

Tash këtu ne kemi pasur një projeksion për një vit tjetër dhe tash kemi sot propozimin konkret për një projeksion të vitit tjetër. Natyrisht, ne përkrahim, unë për vete e përkrah që ky regjistrim të bëhet në kohën më të shpejtë. Tash është propozuar koha në 2011. Unë nuk dua të bëj reflektime politike, sepse është koha pak të bëhen reflektimet politike pak a shumë edhe në frymën e fazave shoqërore që lidhen me zgjedhjet ku jemi tash, po nga vullneti për të bërë politikë nganjëherë njerëzit bëjnë politikë edhe kundër vetvetes, se unë dëgjova këtu që iu drejtuan edhe ju lutën ministrit aktual që ky t' u garantojë që do ta bëjë këtë regjistrim në vitin 2011. Ajo i bie që ata ia garantojnë funksionin deri në vitin 2011, zotëri Bajrami. Unë nuk do të flisja ashtu pa marrë parasysh se s'besoj që mund t'i garantoj edhe po desha. Ky këtu po e lë pikë këtë problemin se sa është spekulativ problemi i diskutimit politik të momentit për një çështje që është përtej një momenti, përtej një partie, përtej një legjislature dhe përtej një ... qoftë përfaqësuese, qoftë qeverisëse.

Çështja u shtrua në dy çështje rreth problemit të regjistrimit të atyre që nuk janë rezidentë në Kosovë. Është pak më i ndjeshëm problemi, shumë më i ndjeshëm, unë nuk dua ta elaboroj këtu sot, s'e shoh të arsyeshme. Çka do të thotë nëse ne regjistrujmë pretendues të banorëve të Kosovës që s'janë sot në Kosovë, unë nuk do ta elaboroj - shifrat e pretenduara janë gjithfarëshe, të gjithave nacioneve dhe nacionaliteteve dhe unë këtu abstenoj, sepse edhe një herë të gjitha ato i quaj të hamedsime.

Ndërsa sa i përket regjistrimit të pasurisë dhe këtu duhet të kemi precizime se jemi tash më një shtet i hapur dhe nëse regjistrohen pasuri ne do të regjistrujmë pasuri dhe të

njerëzve që nuk janë rezident të Kosovës dhe këtu duhet të precizohet edhe me ligj saktë. S'kanë pasuri në Kosovë veç ata që janë rezident të Kosovës, kanë dhe të tjerët.

Pra, uroj që kapacitetet edhe një herë tona politike, konstitucionale dhe zhvillimore të jenë të fuqishme që këtë veprim të jashtëzakonshëm për Kosovën ta mbështesim dhe ta bëjmë sa më shpejt. Faleminderit! Nëse unë e thashë një fjali për kolegët e mi, ai ka qenë kompliment, por nëse s'e marrin si kompliment atëherë unë s'di çka them tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Diskutuesi i fundit është deputeti Ali Lajçi.

ALI LAJÇI: Faleminderit, Kryetar!

Deputet të nderuar,

Kjo tash për disa vite dihet u tha edhe u përsërit se kjo është një çështje mjaftë senzitive edhe sidomos mbase u prek dhe ekskluzivisht mund të thuhet se është një çështje tejet politike dhe mund të themi njëra prej prerogativave shtetërore, pra të ushtrimit të funksionit të një ministrie të nivelit të shtetit siç është Kosova. Me këtë rast, jo vetëm regjistrimi i popullsisë, por edhe disa nga aktet shumë të rëndësishme, mund të themi shumë vitale për Kosovën, sidomos në fushën e sigurisë, në fushën e sovranitetit, në fushat e tjera e sidomos edhe Ligji për pronësinë janë kategori, mund të themi apo bazike për një status siç është Kosova- status të shtetit. Në këtë rast, mund të themi se çështja e regjistrimit të popullsisë nuk ngërthente vetëm këtë problem shumë vital, por është me rëndësi të shumëfishtë me politikat tjera zhvillimore, siç është fjala në ndarjen e buxhetit në këtë mes me gjithë tjerat probleme që ngërthen kjo. Edhe 2 – 3 vjet Kosova do të ketë një disharmoni shumë të madhe në kuptim të ndarjes së buxhetit ndër komuna, sepse ne e shohim se si inkasojnë komunat dhe ne kemi atje kritere për ndarjen e buxheteve të parashikuara. Dhe, unë do të sugjeroja tash pa hyrë në pjesën tjetër politike që ka peshën mund të themi bazike të saj të rëndësishëm për statusin e Kosovës, çka mund të bëjnë në këtë mes Ministria e Ekonomisë dhe e Financave lidhur me planifikimin rreth ndarjes së buxhetit komunal, kur atje kemi një disproporcion, sepse kemi kritere buxhetore të cilat kanë hyrë dhe kanë mbetur më parashikime nga koha e UNMIK-ut e këtej. Këtu do të duhej që Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të krijojë një kornizë të re të kritereve për ndarjen e buxheteve dhe t'i harmonizojë ato apo të zbusë për këto dy vjet e sa do të jetë më tej çështja buxhetore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Nuk kemi të paraqitur për diskutim.

Ne i kemi dy dokumente përpara, kemi rekomandimin e Komisionit i cili thotë kështu: "Mbështetet propozim vendimi i Qeverisë së Kosovës për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave", ndërsa vendimi i Qeverisë është: "I propozohet Kuvendit të Kosovës që regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe i banesave të mbahet nga data 30 mars 2011 deri më 11 prill 2011". Nejse atë 2011 e thashë unë kështu për ta sqaruar se është fjala për marsin dhe prillin e vitit 2011. Tek unë në vendim është 2011, edhe rekomandimi i Komisionit e mbështet këtë, do të thotë këto dy gjëra ne kemi për t' i votuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Ju njoftoj se prezentë janë 71 deputetë. Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota "për", një "kundër" dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi propozim vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e datës për regjistrimin e

popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave, prej 30 marsit deri më 11 prill 2011. Është fjala për të njëjtin vit. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës

- **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të kursimeve pensionale**

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozim vendimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të kursimeve pensionale dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Ftoj kryetarin apo raportuesin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Kush është?

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, shumë zotëri Kryetar!

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-034 i ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/20 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe në bazë të rregullës 51.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2009 me përfaqësuesit, anëtarët e Bordit të Trustit Pensional ka shqyrtuar propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe njëkohësisht vlerëson se propozimi për uljen e taksës për qeverisjen e mjeteve të besuara të kursimit pensional më 0.8, nuk paraqet pengesë për funksionimin e Trustit, por krijon të hyra me të cilat sigurohet ruajtja e cilësisë së punës dhe shërbimet të cilat i ofron Trusti.

Me qëllim të operacionalizimit financiar të Trustit për uljen e taksës administrative nga 0.90 sa ka qenë në 0.80 nga shuma e mjeteve duke filluar nga 1 janari i vitit 2010. Komisioni rekomandon që të miratohet propozimi i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe njëkohësisht edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështesim këtë propozim dhe këtë rekomandim të Komisionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha e deklarimeve të shefave të grupeve parlamentare për këtë çështje dhe ju kisha lutur që deklaratimet t'i bëjnë shefat e grupeve parlamentare dhe shkojmë më tej.

Radha është e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetit Ramë buja.

RAMË BUJA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet për ministrat që janë këtu prezentë dhe kolegë deputetë,

Me që është kështu për t'u deklaruar shefat, sepse ne e kemi pas caktuar Stafetën që të deklarohet, atëherë në debatet që kemi zhvilluar në Grupin Parlamentar nuk kemi qenë shumë të kënaqur me këtë limit të përcaktuar, por qenka një rrjedhë normale e ... e kësaj gjëje, atëherë ne si Grup Parlamentar e mbështesim si të tillë çfarë është.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: E përkrahim propozimin dhe dokumentin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, më duket fjalën e ka kërkuar deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah propozimin edhe pse duke pasur parasysh bazën mbi të cilën ndërtohet 0.80-shi është pak e tepruar, ka mundur që të zbritet ndoshta deri në 0.70, por sido që të jetë ne e përkrahim.

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar qeveritarë, deputetë,

U mor vesh në këtë rast sipas autorizimit të Grupit kuvendor. Në parim e përkrahim rekomandimin e Komisionit për Buxhet, por kem rezerva, vlerësoj se janë serioze edhe konsideroj se do të duhej në një rast të përshtatshëm këto rezerva, me siguri edhe të tjera do të dilnin që të analizoheshin me një vlerësim kritik. Ju lutem, kjo është vetëm sa për sy e faqe, ishte po e zëmë 0.90, 0.80, pa kurrfarë analize. Tash në qoftë se e marrim bie fjala këtu që e kem një pasqyrë. Shikoni 440 mijë euro ishte shuma për pagat e 21 punonjësve, në Trust do të ishte shuma 350 mijë. Po i del përafërsisht 1388 euro paga një nëpunësi që ishte dashur të futeshin në kategorinë e nëpunësve civilë, ndërsa nëpunësitë civilë të Kuvendit të Republikës apo të Qeverisë në përgjithësi nuk e di ndoshta e kanë 200, 220, 230 ero mesataren, edhe madje nga paraaja e pensionistëve të absolutisht të nëpërkëmbur, që nuk është në rregull fare. Ose te bordi udhëheqës 209 mijë euro po e zëmë, a ka ... pozicion të veçantë për konsulentët një shumë jashtëzakonisht të lartë, a këta që janë kategoria më e paguar në Kosovë, 10 mijë e diçka euro paga mujore ju lutem, apelohej se janë ekspertë të shquar atëherë në qoftë se janë aq të shquar e aq të dalluar, e aq të veçantë pse të kenë avokatë, pse të kenë konsulentë të jashtëm e të brendshëm?

Përfundimisht e mbështesim në parim, mirëpo rezervat i potencuam edhe angazhohemi që këto në një seancë të përshtatshme, zotëri Kryetar të diskutohen. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe ne si Lidhje Demokratike e Dardanisë, në fakt e mbështesim në parim këtë uljen e tarifës menaxhuese për Bordin e Trustit të Kursimeve Pensionale nga 0.90, në 0.80, mirëpo vlerësojmë, duke pas parasysh vetëm një analizë të shkurtër të buxhetit të cilën e kanë planifikuar për vitin 2010 ky bord menaxhues mendoj se ka pasur mundësi për ulje edhe mëtutjeshme të kësaj tarife menaxhuese. Dhe, gjithsesi ka pasur kushte dhe mundësi që kjo tarifë të shkojë ndoshta edhe diku 0.6 apo edhe 0.5, sepse u thanë disa parametra nga parafolësi që në mënyrë të detajuar i kemi bërë edhe ne si Lidhje Demokratike e Dardanisë dhe unë do ta paraqes vetëm për anëtarët e Bordit të Trustit ku paga mujore e tyre vjen diku 3500 euro. Prandaj mendoj është jashtëzakonisht e lartë, e të mos të flasim për shpenzime tjera. Prandaj, mendoj, në një të ardhme të shpejtë kjo temë të jetë çështje debutuese në këtë Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Sadik Idriz.

SADIK IZDRIZ: Hvala, predsedvniče!

I Parlamentarna grupa „7+“ podržava ovo smanjenje tarifa. Međutim, smatramo da se zaista ovaj trust nije proslavio do sad, u mnogim stvarima nije se proslavio i ovo što je govorio poslanik Riza Smaka, mislim da je potpuno u pravu, ali to nije predmet današnje rasprave i zbog toga mi podržavamo predlog za zmanjenje tarifa. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk ka. Po i ftoj deputetët që nuk janë prezentë momentalisht në sallë të kthehen në sallë.

Prezentë janë 64 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi propozim vendimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të kursimeve pensionale.

A jeni dakord të vazhdojmë, a po marrim 15 minuta pauzë. Është një defekt në gjeneratorë- 15 minuta pauzë.

Vazhdon seanca pas pauze

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i kërkesës së ministrit për Ekonomi dhe Financa për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ka kërkuar nga Kuvendi ndarje shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e saj në seancë plenare.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa zotin Gani Koci, si raportues i Komisionit ose raportuesja e cila e merr detyrën- Safete Hadergjonaaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2009 shqyrtoi kërkesën e Zyrës së Auditorit Gjeneral si dhe kërkesën e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për rritjen e numrit të auditorëve dhe ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm dhe i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës që ta miratojë kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për rritjen e numrit të auditorëve në 16 dhe ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore prej 93 mijë e 541 euro për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm sipas kërkesës e cila na është adresuar.

Po ashtu nga Komisioni është kërkuar që Ministria e Ekonomisë dhe Financave të bëjë njëkohësisht harmonizimin e kësaj kërkeje brenda tabelave buxhetore të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, dhe ne i kemi rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë kërkesë, sepse Komisioni e ka konsideruar si kërkesë të drejtë.

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e shefave të grupeve. Besoj që edhe në emër të Grupit e kreve. Mirë, faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj, e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, shumë Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar kërkesën. Është një kërkesë e cila konsiston në arsyeshmëri të plotë dhe si institucion i pavarur, si kategori kushtetuese. Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet këtë rritje të numrit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës, konsideron se duhet t'i krijohen kushtet materiale dhe kushtet kadrovike, Zyrës së Auditorit Gjeneral për të kryer funksionin të cilën e ka të përcaktuar me ligj. Prandaj, kërkesën e Zyrës së Auditorit ne e përkrahim si të arsyeshme dhe e mbështesim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të AKR-së, shefi i Grupit Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i AKR-së, nuk e përkrah kërkesën në fjalë, jo pse jemi kundër tyre, kundër Zyrës së Auditorit Gjeneral, por pse ka nevojë edhe për ngritje edhe të kuadrove edhe të pagave edhe të shërbyesve të tjerë. Po përmend vetëm disa, 16 pozita të reja, ngritje të pagave për disa nga stafi ekzistues në shumën totale prej kaq. Ju e dini që ka nevojë për ngritje të pagave edhe të tjerëve edhe jo vetëm të këtij autoriteti. Mëditje për 20 punonjës ekzistues që thuhet këtu nga 50 euro në muaj për mirënjohje, për rreziqet që paraqiten në punën e auditorit dhe ne kemi autoritete në Kosovë të cilat punojnë në rrezikshmëri të lartë. Keni parasysh gjyqtarët, policët e të tjerët, do të thotë edhe ata kanë nevojë për t'i shpërblyer së paku, vetëm po të implementohej ligji për ta nuk do të kishte nevojë për shpërblime tjera.

Nënë katër, thotë shërbimet shtesë nga puna shtesë e auditorëve duke përfshirë edhe auditimin nëpër komuna me një kosto prej 40 mijë eurove. Pra, në këtë vend, përpos këtyre ka edhe shumë punonjës të tjerë që bëjnë punë shtesë, në veçanti Policia e Kosovës tash e cila për punën shtesë nuk marrin mëditje shtesë, por marrin ditë pune me pushim e nuk marrin paga shtesë. Për ata që nuk e kanë ditur po ju them që nuk marrin po marrin ditë të lira dhe ka shumë të tjerë të cilët kanë nevojë.

Si Grup Parlamentar nuk e mbështesim këtë kërkesë as të ministrit dhe as rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja, Synavere Rysha, e ka fjalën.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, e përkrah kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, për rritjen apo për pagën shtesë për auditorët e përgjithshëm, gjithashtu e përkrah edhe rritjen e numrit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz, e ka fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniče!

Parlamentarna grupa „7+“ podržava zahtev Ministarstva za finansije za povećanje sredstava za Kancelariju generalnog revizora, s tim da i u ovoj kanceliriji treba da budu zaposleni i pripadnici iz manjinskih zajednica. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

E kemi vetëm një deputet për diskutim, deputetja Vezira Emrush, e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reć. Ovako, mi imamo danas pred sobom zahtev za povećanje Službe generalnog revizora za 16 radnika i ovo za dodatnu platu, znači zahtev za dodatnu platu. Ja smatram da ne treba da podržimo ovaj zahtev zato što je to profesija kao i svaka i znamo da imamo zapošljene revizore, znamo da u svakom segmentu ima deficit kada je u pitanju kosovska plata i mislim da je ovo mač sa dve oštrice ako dobro platimo revizore sa dnevnicom od 50 evra i da će biti mnogo poslušnih. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në sallë janë 64 deputetë. Shkojmë në procedurën e votimit. Votojmë tash:

Regjia, përgatitu për votim, votojmë tash.

Konstatohet se me 52 vota “për”, 7 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi kërkesën e ministrit për Ekonomi dhe Financa për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Faleminderit!

Pika e dhjetë e rendit të ditës dhe e fundit për sot:

- **Njoftim me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e deputetit Naim Rrustemi, për respektimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik**

Në pajtim me nenin 67, pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 3 nëntor 2009, me kërkesë të deputetit Naim Rrustemi vendosi që të kërkohet nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët ushtrojnë ndonjë funksion shtesë, përkatësisht që mbajnë ndonjë pozitë ekzekutive në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike e që është në kundërshtim me nenin 72 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 13 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin funksionit publik, si dhe të nenit 26, pika 1 dhe 27 të Ligjit kundër korrupsionit, të japin dorëheqje nga ato pozita.

Do të thotë dje kam marrë një informatë nga Agjencia Antikorrupsion që thotë se pozita që e mban deputeti Gani Koci në KEK nuk bie ndesh me këtë çështje. Të njëjtën

përgjigje i kam dhënë edhe deputetit Gani Buçinca por njofton se në procedurë hetimore për të verifikuar se a ka ndeshje tjera janë edhe 19 deputetë por për të cilët ne nuk dimë cilët janë dhe s'e dimë deri ku kanë arritur.

Kjo është gjendja që e kemi deri më sot dhe me këtë pikë të rendit të ditës e mbyllim këtë seancë. Mirë u pafshim në seancën e radhës që është nesër.

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale